

RAPORTI I
HULUMTIMIT

PARANDALIMI I DHUNËS ME BAZË GJINORE NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA



Natasha Dimitrovska
Elena Koçoska

RAPORTI I
HULUMTIMIT

**PARANDALIMI I
DHUNËS ME BAZË
GJINORE
NDAJ GRAVE
DHE VAJZAVE
ME AFTËSI TË
KUFIZUARA**

Shkup, 2022

Natasha **Dimitrovska**
Elena **Koçoska**



Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

Përmbajtja

LISTA E SHKURTESAVE	5
HYRJE	6
REZYME EKZEKUTIVE	9
KORNIZA JURIDIKE	11
KORNIZA NDËRKOMBËTARE JURIDIKE	11
KORNIZA NACIONALE JURIDIKE	22
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	29
MBLEDHJA E TË DHËNAVE DHE EKZEMPLARI	29
ANALIZA E TË DHËNAVE	33
KUFIZIMET NË HULUMTIM	33
KONSTATIMET E HULUMTIMIT	35
TË KUPTUARIT DHE NJOHJA E DISKRIMINIMIT DHE DHUNËS NGA GRATË DHE VAJZAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA	36
PERCEPTIMET E GRAVE DHE VAJZAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA PËR DHUNËN DHE ROLET GJINORE	36
PËRVOJAT ME DISKRIMINIMIN DHE DHUNËN NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA	38
Përvojat me diskriminimin në jetën e përditshme	38
Përvojat me dhunën dhe keqtrajtimin	39
Pasojat e dhunës dhe keqtrajtimit	42
PËRGJIGJE INSTITUCIONALE NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA	42
Evidenca e viktimave dhe autorëve të dhunës familjare me aftësi të kufizuara	42
Evidenca dhe dhuna në institucionet, shtëpitë në grupe dhe format e organizuara të mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara	45
Përvojat me paraqitjen e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara që kanë pësuar dhunë dhe / ose maltretim	47
Serviset e ndihmës dhe mbështetjes së grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara që janë viktimat e dhunës	48
QASJA E INSTITUCIONEVE DHE ORGANIZATAVE	49
GATISHMËRIA E PERSONAVE QË PUNOJNË NË FUSHËN E TË DREJTAVE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA APO DHUNËS NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE	55
PENGESAT DHE VËSHTIRËSITË MË TË MËDHA PËR GRATË DHE VAJZAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA QË JANË VIKTIMA TË DHUNËS	58
NDIKIMI I KOVID-19 NË JETËN E GRAVE DHE VAJZAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE SHFAQJA E DHUNËS	61
MASAT URGJENTE PËR PËRMIRËSIMIN E SITUATËS SË GRAVE DHE VAJZAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA QË JANË VIKTIMA TË DHUNËS	63
KONKLuzionET	66
REKOMANDIMET	70
LITERATURA E SHFRYTËZUAR	73
ANEKSI 1	77
ANEKSI 2	81
ANEKSI 3	86
ANEKSI 4	89
ANEKSI 5	94
ANEKSI 6	100
ANEKSI 7	105

Lista e shkurtesave

KDPAK	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
KAT	Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
KB	Kombet e Bashkuara
UNICEF	Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
KI	Konventa e Stambollit (Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin e Luftës kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje)
KEGJFDG	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
DHBGJ	Dhuna me bazë gjinore
DHF	Dhuna familjare
QPS	Qendra e Punës Sociale
IPQNPS	Institucioni Publik Qendra Ndërkomunale e Punës Sociale
ISHP	Institucioni Shëndetësor Publik
IPES	Institucioni Publik Enti Special
PP	Prokuroria Publike
PPTH	Prokuroria Publike Themelore
AV	Avokati i Popullit
SP	Stacioni i Policisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
OC	Organizatrat Civile
SHMJR	Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj
NJVL	Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale
LMS	Ligji për Mbrojtje Sociale
OPAK	Organizata e Personave me Aftësi të Kufizuara
KPT	Komiteti për Parandalimin e Torturës
KDF	Konventa për të drejtat e fëmijës
NJF	Ndihmë juridike falas

HYRJE

Dhuna me bazë gjinore, në të gjitha format e saj, është përditshmëri në jetën e grave në vend dhe në botë. Në Maqedoninë e Veriut, pothuajse gjysma (45%) e grave kanë përjetuar njëfarë forme të dhunës nga partneri intim (dhunë fizike dhe/ose psikologjike) nga moshë 15 vjeçare, derisa pothuajse çdo e treta grua (30%) kanë përjetuar ngacmim seksual¹. Të dhënat tregojnë se mbi 80% të viktimave të dhunës familjare janë gra. Përhapja e dhunës ndaj grave në vend është dukshëm më e ulët se në vendet e BE-së, gjë që tregon ekzistimin e frikës dhe turpit nga denoncimi dhe mosbesimi ndaj institucioneve². Gjithashtu, brengos fakti që tre herë më shumë gra konsiderojnë se dhuna në shtëpi është punë private që duhet të mbetet në familje, në krahasim me gratë në mbarë BE-në, ndërsa numër i konsiderueshëm i grave konsiderojnë se ndonjë dhunë “më e vogël” është sjellje normale³.

Seksizmi dhe sjellja seksiste janë të lidhura me dhunën ndaj grave dhe vajzave, me ç’rast veprat e seksizmit “të përditshëm” janë pjesë e kontinuitetit të dhunës duke krijuar atmosferë të frikësimit, frikës, diskriminimit, përjashtimit dhe pasigurisë me çka kufizohen mundësitë dhe liria e grave dhe vajzave. Stereotipat dhe paragjykimet gjinore i formojnë normat, sjelljen dhe pritjet e burrave dhe djemve, që shpie në akte seksiste. Më shumë analiza dhe hulumtime vitet e fundit treguan se në vendin ende dominojnë besimet stereotipe tradicionale për vendin dhe rolin e grave dhe burrave në shtëpinë dhe shoqërinë, që paraqesin pengesë për progresin e grave në pothuajse të gjitha sferat nga jeta private dhe publike⁴.

Burrat ende konsiderohen dominues në shtëpinë dhe në jetën publike, ndërsa nga gratë pritet t’i lënë nevojat dhe ambiciet në fushën personale dhe profesionale në vend të dytë dhe t’u përkushtohen para së gjithash amvisërive⁵. Ende ka numër të konsiderueshëm të grave (37%) që konsiderojnë se gruaja duhet t’i nënshtrohet bashkëshortit, bile edhe nëse ajo nuk pajtohet, ndërsa numër të ngjashëm (32%) konsiderojnë se është me rëndësi që burri t’i tregojë partneres së vet kush është kryesor⁶. Gjithashtu, çdo grua e tretë tregon dyshim në dëshmitë e grave tjera që kanë denoncuar maltretim ose dhunë⁷. Gjithashtu, 14,5% e grave nga mjediset rurale në moshë prej 15-49 vjeçare arsyetojnë që burri ta rrahë gruan nëse ajo i neglizhon fëmijët (kundrejt 4,5% në mjediset urbane), 7,3 e grave në mjediset rurale konsiderojnë se është e arsyetuar që burri ta rrahë gruan nëse ajo grindet me të (kundrejt 2% në mjediset urbane) dhe 6,7% e grave në mjediset rurale arsyetojnë që burri ta rrahë gruan nëse ajo del pa i treguar (kundrejt 1,5% në mjediset urbane)⁸.

1 OSBE (2019) *Hulumtim i realizuar nga OSBE-ja për dhunën ndaj grave në Maqedoninë e Veriut, Mirëqenien dhe sigurinë e grave, Maqedonia e Veriut: Raport nga rezultatet, fq. 21*

2 Ibid., fq. 13.

3 Ibid.

4 Këshilli i Evropës, Rekomandimi i MV/Rec (2019) 1 “Parandalimi dhe lufta kundër seksizmit”, i miratuar nga Komiteti Ministror i Këshillit të Evropës, 27 mars 2019.

5 UN Women (2018) *Public Perceptions of Gender Equality and Violence against Women, Infosheet, pg. 5.*

6 Ibid., fq. 14.

7 Ibid., fq. 16.

8 State Statistical Office and UNICEF (2020) *2018-2019 North Macedonia Multiple Indicator Cluster Survey and 2018-2019 North Macedonia Roma Settlements Multiple Indicator Cluster Survey, Survey Findings Report, fq. 251.*

Gjatë historisë njerëzore, bile edhe në shekullin 21, personat me aftësi të kufizuara ende janë të etiketuar si persona të padobishëm dhe të varur, të fshehur dhe të përjashtuar nga shoqëria, ose në shtëpitë e tyre ose në institucionet. Kjo histori e izolimit ndryshohet gradualisht, por në mënyrë shumë të ngadalshme, duke dhënë një fije të re në shoqërinë dhe duke ndikuar mbi vlerat e vendosura shoqërore për pamjen e përkryer dhe superiore të genies njerëzore. Ky proces kërkon dhe imponon përfshirje aktive të personave me aftësi të kufizuara në të gjitha aspektet e shoqërisë.

Dhuna e bazuar në aftësinë e kufizuar është e lidhur me stigmën sociale dhe disbalancën e fuqisë ndërmjet personave me dhe pa aftësi të kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara mund të jenë të poshtëruar ose të ngushëlluar, por në tërësi nuk konsiderohen si bartës të të drejtave, për persona që duhet t’i gëzojnë të drejtat e tyre në bazë të barabartë me të tjerët. Që në moshë më të hershme, fëmijët me aftësi të kufizuara që janë përfshirë në mësimdhënien e rregullt në shkollat ballafaqohen me diskriminim nga bashkënxënës dhe prindër që konsiderojnë se nuk e kanë vendin në mësimdhënien e rregullt⁹.

Për shkak të interseksionalitetit të diskriminimit të tyre, përkatësisht ekzistimit të më shumë bazave për diskriminim, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara ende më shumë ballafaqohen me barriera dhe pengesa, si dhe stigmatizim dhe izolim në shoqërinë dhe mjedisin. Sipas raportit të Parlamentit Evropian¹⁰, gratë me aftësi të kufizuara 4 herë më shumë janë të ekspozuar ndaj dhunës seksuale në lidhje me gratë pa aftësi të kufizuara. Gjithashtu, 80% e personave të vendosur në institucionet janë të ekspozuar ndaj dhunës nga njerëzit që i rrethojnë, qoftë vetë prindërit, kujdestarët, punëtorët shëndetësorë, punëtorët socialë, etj. Sipas studimit rajonal të USAID-it¹¹, gratë me aftësi të kufizuara janë veçanërisht të privuar nga e drejta në disa sfera, duke përfshirë edhe të drejtat e seksualitetit, martesës, amësisë, integritetit social dhe punësimit. Gjithashtu, shpeshherë ajo që maskohet si “qëllime të mira” janë në fakt vepra të ableizmit¹², diskriminimit dhe dhunës, siç janë për shembull, trajtime pa pëlqim të informuar, sterilizim të detyrueshëm dhe aborti, vepra që janë të bazuara në paragjykimet, lajthitje, si dhe norma dhe vlera të përcaktuara shoqërore lidhur me aftësinë e kufizuar¹³.

Sipas hulumtimit të OSBE-së për dhunë ndaj grave¹⁴, në rajonin pothuajse dy e treta grave me aftësi të kufizuara (63%) që kanë pasur partner kanë thënë se kanë përjetuar dhunë psikologjike nga partneri intim nga moshë 15 vjeçare. Gjithashtu, gratë me aftësi të kufizuara ka më shumë gjasa të përjetojnë formë më serioze të dhunës fizike (10% e grave me aftësi të kufizuara kanë thënë se janë rrahur nga ana e partnerit intim, krahasuar me 6% të grave në përgjithësi)¹⁵. Pas përvojës me dhunë, gjithashtu, për gratë me aftësi të kufizuara ka më shumë gjasa të kenë nevojë për ndihmë financiare (24% kundrejt 14% gra në përgjithësi), ndihmë mjekësore (23% kundrejt 16%) dhe ndihmë për denoncim në polici (14% kundrejt 9%)¹⁶.

9 UNICEF and The European Union (2018) *Inclusion of Children and Youth with Disabilities in Mainstream Secondary Education, fq. 24.*

10 European Parliament (2004) Report on the situation of women from minority groups in the European Union (2003/2109(INI)), fq. 13. Disponueshëm në <https://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//NONSGML+REPORT+A5-2004-0102+0+DOC+PDF+VO//EN>

11 USAID (2012) *Women with Disabilities in the Europe & Eurasia Region: Final Report.* Disponueshëm në <https://www.usaid.gov/sites/default/files/Women-with-Disabilities-EE-Region-FINAL-2012.pdf>

12 Ableizmi është paragjykim social ndaj personave dhe/ose njerëzve për të cilat mendohet se kanë aftësi të kufizuara, duke karakterizuar personat me aftësi të kufizuara si inferiorë në lidhje me personat pa aftësi të kufizuara.

13 International Network of Women with Disabilities (2010) Document on Violence against Women with Disabilities.

14 OSCE (2019) Well-being and safety of women, OSCE-led survey on violence against women - Experiences of disadvantaged women: Thematic Report. Disponueshëm në: <https://www.osce.org/files/f/documents/b/1/430007.pdf>

15 Ibid., fq. 32.

16 Ibid., fq. 80.

Kryesisht të përfshirë në kujdesin afatgjatë të personave me aftësi të kufizuara janë gjithashu tu gratë. Shërbimet e kujdesit afatgjatë mund të jenë pjesë e kujdesit formal – të dhënë nga punëtorët dhe punëtorët profesional, ose kujdesi joformal – atë që e japin prindërit, fafiset dhe miqtë e personave me aftësi të kufizuara. Me punën e tyre të papaguar, kujdestarët dhe kujdestaret e mirëmbajnë sistemin për kujdes afatgjatë, ndërsa dhënia e kujdesit është element kryesor i identitetit të tyre personal, burim i pabarazisë, stigmës dhe përjashtimit shoqëror. Në mungesë të shërbimeve dhe masave për kujdes dhe ndihmë, të gjitha nevojat e tyre, planet dhe dëshirat janë të lidhura me personat për të cilën kujdesen¹⁷.

Gjatë krizës me pandeminë me Kovid -19, gjendja me dhunën në familje u përkeqësua dukshëm për shkak të masave që kanë imponuar prezencë të vazhdueshme në shtëpi. Në prill dhe maj 2020 kur shteti kishte vendosur masat më të rrepta-ndalimqarkullim, në afat prej dy javësh u vranë 2 gra. Në periudhën prill-maj 2020 denoncimet për dhunë familjare u rritën pothuajse për 45% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak¹⁸. Deri në shtator 2020 kishte 3 femicide (vrasje të grave) autorë të cilave ishte partnerët e viktimave. Masat që u sollën nga fillimi i pandemisë nuk i morën parasysh nevojat e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, e me atë nuk arritën të sigurojnë mbrojtje dhe siguri adekuate dhe të plotë¹⁹. Gjithashtu, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, gjatë pandemisë, ballafaqohen me sfida dhe pengesa tjera, siç janë mbajtja e detyrueshme e maskave që nuk janë inkluzivë, gjë që e vështirëson komunikimin për personat me shikim të dëmtuar, ose mbajtja e dorezave gjë që e vështirëson qarkullimin dhe kryerjen e rutinave të përditshme për personat me shikim të dëmtuar²⁰.

Duke pasur parasysh atë që në përdorim më të gjerë ka më shumë nocione për këtë problematikë, për qëllimet e këtij raporti e përdorim nocionin “gra dhe vajza me aftësi të kufizuara”, ku nocioni “aftësi të kufizuara” ka të bëjë me marginalizimin e grupit të njerëzve në shoqërinë për shkak të qëndrimeve sociale dhe kulturore, si dhe barrierave fizike në mjedisin. Së këndejmi, sfidat dhe rreziqet me të cilat ballafaqohen gratë me aftësi të kufizuara janë pasojë e drejtpërdrejtë e stigmatizimit në shoqëri, gjë që krijon barrë të dyfishtë të diskriminimit mbi këto gra.

Ky është hulumtimi i parë i orientuar ndaj shqyrtimit dhe prezantimit të gjendjes me dhunën ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në vend, një tematikë e cila është e ndjeshme dhe në masë të madhe konsiderohet si tabu, duke mbetur e fshehur dhe injoruar. Qëllimi i hulumtimit është që të nxjerrë në pah problemet me të cilat ballafaqohen gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, në aspekt të dhunës dhe diskriminimit, duke dhënë rekomandime konkrete për tejkalimin e atyre problemeve, pengesave dhe barrierave.

17 Kotevska, B., Ançevska E., Kacarska, S (2016) *Arti i mbijetesës: Pabarazi interseksionale në mbrojtjen sociale në Maqedoni – Rezultate nga hulumtimi empirik, EPI Shkup.*

18 <https://www.pravdiko.mk/chulev-prijavite-za-semejno-nasilstvo-za-april-maj-zgolemeni-44-6-otsto-za-razlika-od-lani/>

19 Jovanovska, B., Petkovska, N. (2021) *Ndikimi i krizës Kovid-19 ndaj personave me aftësi të kufizuara në Maqedoninë e Veriut, Fondacioni për demokraci Vestministër, Maqedonia e Veriut, fq. 28*

20 Risteska, M. (2020) *Analiza e ndikimit nga Kovid-SARS-19 në gjininë dhe diversitetet, Misioni i OSBE-së në Shkup. Disponueshëm në: <https://www.osce.org/files/f/documents/1/9/480413.pdf>*

REZYME EKZEKUTIVE

Diskriminimi, keqtrajtimi dhe dhuna janë një përditshmëri e jetës së shumë grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në Maqedoninë e Veriut. Përvojat e tyre me diskriminimin më së shpeshti fillojnë në moshën më të hershme, në familje, e më pas vazhdojnë në të gjitha sferat e pjesëmarrjes së tyre në shoqëri. Rreth gjysma e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara që kanë marrë pjesë në këtë hulumtim (44%) u shprehën se kishin përjetuar drejtpërdrejt ndonjë lloj të dhunës, ndërsa çdo e treta (35%) kishte qenë dëshmitare e dhunës dhe/ose keqtrajtimit. Në anën tjetër, organizatat civile që punojnë me gra dhe vajza viktime të dhunës, kanë evidentuar 1-3 raste të dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, në nivel vjetor, ndërsa qendrat e punës sociale kanë evidentuar 1-2 raste në nivel vjetor. Gratë me aftësi të kufizuara të cilat kishin qenë viktime të dhunës fizike kanë pasoja afatgjata psikologjike dhe emocionale në formë të traumave, frikës dhe mbylljes në vete, ndërsa te ato gjithashtu mbizotëron edhe mosbesimi ndaj institucioneve dhe ndjenja e pafuqisë.

Përkrahja kryesore në jetë për gratë dhe femrat me aftësi të kufizuara është nëna e tyre, ndërsa në rastet e dhunës, pika e parë për reagim është policia (36 prej 75 grave fillimisht e kanë kërkuar policinë). Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara kryesisht nuk kanë njohuri për shërbimet dhe serviset që mundësohen nga organizatat civile, ndërsa vetëm disa OC krijojnë materiale në formate të disponueshme, më së shpeshti nëse aktiviteti drejtpërdrejt ka të bëjë me personat me pengesa dhe nëse për atë janë paraparë mjete buxhetore.

Përgjigja institucionale e dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara është në nivel shumë të ulët. Profesionistët të cilët punojnë në institucione janë mirë të njoftuar me nocionin e dhunës me bazë gjinore, por pothuajse askush prej tyre nuk ka ndjekur ndonjë trajnim për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara. Nëpër institucione, as inkluziviteti nuk është në nivelin e duhur, me një numër shumë të ulët të punonjësve me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, problem i madh është edhe mosmbajtja e evidencës së të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe atyre me aftësi të kufizuara, nga ana e institucioneve.

Te gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, kryesisht ende mbizotërojnë pasqyrimet tradicionale ndaj familjes dhe roleve gjinore, edhe pse te gjeneratat më të reja mund të vërehen pasqyrimet progresive në aspekt të njohjes së stereotipave dhe normave patriarkale, theksimit të lirisë së shprehjes dhe dëshirës për pavarësi. Megjithatë, ende kryesisht mbizotëron mendimi se arsyeja e dhunës dhe/ose keqtrajtimit është te viktime - më tepër se gjysma e grave dhe vajzave që kanë marrë pjesë në hulumtim (40 nga 75) konsiderojnë se shpeshherë vetë gratë janë fajtoresh për dhunën e përjetuar.

Pengesat më të mëdha për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara në aspekt të diskriminimit dhe dhunës është fakti që nuk forcohen që nga mosha më e re, trajtohen si të paafta, masat e pamjaftueshme për integrimin e tyre në shoqëri, që kontribuon për varësinë tyre ekonomike nga prindërit ose partnerët, stigmatizimi dhe izolimi i madh, si dhe mospërshtatja e ambientit sipas nevojave të tyre. Gjithashtu, pengesë e madhe është edhe mosgatishmëria e institucioneve që të përgjigjen dhe të parandalojnë dhunën ndaj grave dhe vajzave me aftësi

të kufizuara, për shkak të pamundësive të tyre, mungesës së edukimit dhe mosnjohjes së problematikës së të punësuarve, injorimit dhe mosnjohjes së kompleksitetit dhe interseksionalitetit të problemit, si dhe kulturës së pranuar për mosndëshkim.

Kriza me KOVID-19, me masat për kufizimin e lëvizjes, kontribuoi për rritjen e rasteve të dhunës me bazë gjinore, si dhe për izolimin ende më të madh të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara dhe dobësinë e tyre ende më të madhe ndaj dhunës dhe keqtrajtimit. Masat për lehtësimin e pasojave të pandemisë, si dhe atyre për mbrojtjen e popullatës, nuk i morën parasysh nevojat e posaçme të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara dhe nuk ishte miratuar asnjë masë e dedikuar direkt për mbrojtjen dhe përkrahjen e kësaj kategorie të cenuar.

KORNIZA JURIDIKE

KORNIZA NDËRKOMBËTARE JURIDIKE

Konventa e OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (KDKPAK)²¹ me Protokollin Fakultativ të saj është akti i parë i detyrueshëm juridik dhe instrumenti themelor ndërkombëtar në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.²² Një prej parimeve të KDKPAK është “*respektimi i dinjitetit të formësuar, autonomisë individuale përfshirë edhe lirinë e vendimmarrjes personale, dhe pavarësisë*”,²³ me çka personat me aftësi të kufizuara shihen si bartës të së drejtave, duke marrë parasysh situatën e tyre specifike. KDKPAK në nenin 6 thotë se “*gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë pre e diskriminimeve të shumëfishta*” dhe urdhëron që vendet nënshkruese duhet të “*ndërmarrin masa për të siguruar plotësimin e plotë dhe të barabartë të të drejtave njerëzore dhe lirive themelore*”. Neni 6 nga KDKPAK ka zbatim horizontal dhe është e ndërlidhur me dispozitat e tjera, veçanërisht me dispozitat që kanë të bëjnë me dhunën ndaj grave me aftësi të kufizuara (neni 16) dhe me shëndetin dhe të drejtat seksuale dhe riprodiktive, përfshirë edhe respektimin e shtëpisë dhe familjes (nenet 23 dhe 25) dhe sferat e diskriminimit ndaj grave me aftësi të kufizuara sipas neneve të tjera relevante.²⁴ Perspektiva gjinore dhe mospërshtatja interseksionale janë një përpunim shtesë nga ana e Komitetit për të drejtat e personave në **Komentin e përgjithshëm nr.3** (2016) për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara.²⁵ Komiteti jo vetëm që thekson se “*gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara ka më shumë mundësi që të jenë të diskriminuara se sa burrat dhe djemtë me aftësi të kufizuara dhe gratë dhe vajzat që nuk kanë aftësi të kufizuara*”, gjithashtu shpreh brengosjen për “*mungesën e inkuadrimit të perspektivës gjinore në politikat për aftësitë e kufizuara*” dhe “*mungesën e perspektivës për të drejtat e aftësive të kufizuara në politikat që e promovojnë barazinë gjinore*”. Plotësimi i të drejtave të grave me aftësi të kufizuara për lirinë nga eksploatimi, dhuna dhe keqpërdorimi, mund të pengohet nga stereotipat dhe praktikat e dëmshme të cilat arsyetohen duke u thirrur në vlerat dhe zakonet socio kulturore dhe fetare, me çka rritet rreziku i dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, duke krijuar pengesa për t’i realizuar të drejtat e tyre të përcaktuara me nenin 16. Në Komentin e përgjithshëm numër 3, Komiteti jep shembuj të shumtë për eksploatimin, dhunën dhe keqpërdorimin e grave me aftësi të kufizuara që konsiderohen si të ashpra, çnjerëzore ose poshtëruese dhe me këtë e shkelin nenin 15 dhe nenin 16. Mes tjerash janë edhe: shtatzënia

²¹ http://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/uncrpd_mk_prevod_rcclip-poraka.pdf

²² Popovska, Zh. (2018) *Interpretues i Konventës ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara të Organizatës së Kombeve të Bashkuara*, Polio plus – Shkup, fq. 14. Disponueshëm në: https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/tolkuvac-un_konvencija.pdf

²³ KDKPAK neni 3 (a).

²⁴ Kočovska, E., Tërpevska, M. (2020) *Udhëzues për përshtatje adekuate*, Shkup: OSBE, fq. 21. Disponueshëm në: <https://www.osce.org/files/f/documents/d/6/446743.pdf>

²⁵ Koment i përgjithshëm nr.3 (2016) për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Disponueshëm në: <https://undocs.org/CRPD/C/GC/3>

ose sterilizimi i detyruar me mënyra tjera; çdo procedurë ose intervenim mjekësor që bëhet pa pëlqim të lirë dhe të informuar, përfshirë edhe ato në lidhje me kontraceptivin dhe abortin; praktikat invazive dhe të pakthyeshme kirurgjike, përfshirë psikoterapinë, gjymtimin e organeve gjentiale femërore dhe ndërhyrjet që bëhen ndaj fëmijëve interseksual pa pëlqimin e tyre të informuar; terapinë me elektroshok dhe çmobilizimin dhe izolimin kimik, fizik ose mekanik²⁶.

Siç thekson Komiteti, gratë me aftësi të kufizuara ballafaqohen me barriera në qasjen në drejtësi, për shkak të “stereotipave të dëmshme, diskriminimit dhe mungesës së adaptimeve procedurale dhe përkatëse, që mund të çojë deri te dyshimet në kredibilitetin e tyre dhe refuzimi i padive të tyre”²⁷. Qëndrimet negative gjatë zbatimit të procedurave, hapave të komplikuar ose nënçmues për paraqitje, udhëzim të viktimave për t’u drejtuar shërbimeve sociale, e jo për shfrytëzimin e mjeteve juridike, pasivitetin dhe/ose refuzimin e supozimeve nga ana e policisë ose organeve tjera gjyqësore, mund t’i frikësojnë viktimat ose t’i dekurajojnë për të kërkuar drejtësinë. Kjo mund të shpie në mosdënimin dhe mos dukjen e çështjes, që mund të rezultojë me dhunë e cila zgjat një periudhë më të gjatë kohore²⁸.

KDPAK e potencon obligimin e shtetit për t’i mbrojtur personat me aftësi të kufizuara “nga të gjitha format e eksploatimit, dhunës dhe keqpërdorimit”, duke marrë parasysh dimensionin gjinor dhe atë të moshës (neni 16, paragrafi 1). Gjithashtu, nga shtetet kërkohet që të sigurojnë programe për promovimin e forcimit, rehabilitimit dhe riintegritimit social për personat që kanë qenë objekt i keqpërdorimit dhe dhunës (neni 15 paragrafi 4). Lidhur me format e dhunës, krahas formave themelore të dhunës, Komiteti për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në veçanti e thekson dhunën institucionale dhe/ose strukturale (paragrafi 29), që përfshin “çdo formë të pabarazisë strukturore ose diskriminimit institucional që e mban gruan në një pozitë të nënçmuar, qoftë fizikisht ose ideologjikisht, krahasuar me personat tjerë të familjes, amvisërisë ose komunitetit të saj.” Komenti i përgjithshëm numër 3 i Komitetit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara jep shumë shembuj të eksploatimit, dhunës dhe keqpërdorimit të grave me aftësi të kufizuara, me çka shkelet neni 16. Gjithashtu, në këtë koment theksohet se “disa gra me aftësi të kufizuara, sidomos gratë shurdhe dhe shurdhemece dhe gratë me aftësi të kufizuara intelektuale, janë të ekspozuara ndaj rrezikut më të madh të dhunës dhe keqpërdorimit për shkak të izolimit të tyre, varësisë ose shtypjes” (paragrafi 33).

Shtetet kanë obligim që të kërkojnë nga të gjithë profesionistët shëndetësorë dhe mjekësorë, përfshirë edhe psikiatrit, që të marrin pëlqim të lirë dhe të informuar nga personat me aftësi të kufizuara, para çfarëdo trajtimi mjekësor. Ndalea absolute për privimin nga liria duhet të mbikëqyret sipas nenit 13 të KDPAK. Heqja e aftësisë së punës për personat me aftësi të kufizuara dhe mbajtja e tyre nëpër institucione, kundër vullnetit të tyre, pa pëlqimin e tyre ose me pëlqim të kujdestarit të tyre paraqet një privim arbitrar nga liria dhe paraqet shkelje të nenit 12, por edhe të nenit 14 nga KDPAK. Për këtë arsye, shtetet patjetër duhet të përmbahen nga praktikat e këtilla, duke vendosur mekanizma për shqyrtimin e rasteve ku personat me aftësi të kufizuara institucionalizohen pa pëlqimin e tyre të posaçëm²⁹.

Në mënyrë plotësuese, shkeljet në lidhje me privimin nga liria, në mënyrë disproporcionale ndikojnë te gratë me aftësi të kufizuara intelektuale ose psikosociale dhe atyre që gjenden nëpër institucione të kujdesit. Ato të cilat janë të privuar nga liria nëpër institucione psikiatrike, në bazë të aftësive të kufizuara reale ose të supozuara, janë objekt i veprimeve dhe

26 Koment i përgjithshëm nr. 3, paragrafi 32.

27 Koment i përgjithshëm nr. 3, paragrafi 52.

28 Ibid.

29 General Comment No. 1: Article 12: Equal recognition before the law, Committee on the Rights of of Persons with Disabilities, Eleventh session, CRPD/C/GC/1, 19 May 2014, paragrafi 40.

dënimeve dhe janë të segreguara dhe ekspozuara ndaj rrezikut të dhunës seksuale dhe tregtisë me njerëz në kuadër të institucioneve të kujdesit dhe institucioneve të posaçme arsimore³⁰.

Sipas KDPAK, qasja rritet në nivel të parimit themelor, duke paraparë se shtetet do të ndër-marrin masa adekuate për t’i identifikuar dhe eliminuar të gjitha pengesat, duke siguruar qasje të barabartë për personat me aftësi të kufizuara në mjedisin fizik, transport, informata dhe komunikime, përfshirë edhe teknologjitë dhe sistemet informatike dhe komunikuese, si dhe në kapacitetet e tjera dhe shërbimet e hapura dhe të siguruara për publikun në mjediset urbane dhe rurale (neni 9)³¹. Gjithashtu, KDPAK (neni 33) parasheh inkuadrimit aktiv të shoqërisë civile, personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese në procesin e ndjekjes së implementimit të Konventës.

Republika e Maqedonisë së Veriut e ka ratifikuar KDPAK dhe Protokollin Fakultativ në vitin 2011. Në pajtim me nenin 118 të Kushtetutës, konventat e ratifikuara ndërkombëtare janë pjesë e legjislacionit kombëtar dhe nuk mund të ndryshohen me ligj, respektivisht janë drejtpërdrejt të zbatueshme³². Në vitin 2018 u formua Trupi Koordinues Kombëtar për implementimin e Konventës së OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, e përbërë nga 14 anëtarë dhe zëvendës të tyre, përfaqësues të Zyrës së Kryetarit të Qeverisë, ministrive dhe organizatave të personave me aftësi të kufizuara³³.

Konventa kundër torturës dhe sjelljes ose ndëshkimit tjetër të ashpër, çnjerëzor ose poshtëruar (KAT)³⁴ në nenin 1 përcakton katër elemente të nevojshme për arritjen e pragut të torturës: sëmundja dhe vuajtja serioze, qoftë fizike ose shpirtërore; qëllimi; caku; dhe përfshirja e shtetit, respektivisht aktet ose lëshimet e organeve shtetërore. Atje ku praktika nuk i plotëson këto katër elemente të torturës, e njëjta paraqet keqtrajtim. (nacioni që përfshin “veprimin ose ndëshkimin e ashpër, çnjerëzor ose poshtëruar”) që është e ndaluar sipas nenit 16 të KAT. Mbrojtja nga tortura dhe keqtrajtimi është në linjë me nenin 15 të KDPAK. Këto mbrojtje janë absolute dhe nuk lejojnë përjashtime dhe të njëjtat nuk mund të suspendohen, madje edhe gjatë luftës, dhe stabilizimit politik ose gjendjes së jashtëzakonshme. Ky nivel i mbrojtjes ka rëndësi kryesore për personat me aftësi të kufizuar në secilin vend, meqë shteti mund ta theksojë mungesën e resurseve ose shërbimeve si arsye për të arsyetuar torturën ose keqtrajtimin³⁵. Për personat me aftësi të kufizuara, në kontekst të shërbimeve mjekësore ose sociale, gjuha kritike në KAT është se dhimbja nuk mund të shkaktohet me detyrim ose për qëllim të diskriminimit në çfarëdo baze, përfshirë edhe aftësitë e kufizuara³⁶. Kjo në veçanti është relevante në kontekst të “trajtimin ndaj personave me aftësi të kufizuara, ku shkeljet serioze dhe diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuara mund të maskohen si “qëllime të mira” nga ana e punonjësve shëndetësorë³⁷. Neni 4 i KAT kërkon nga shtetet që “të gjitha aktet e torturës të cilësohen si vepra penale sipas të drejtës penale.” Siç

30 Koment i përgjithshëm nr 3, paragrafi 53.

31 Jovanovska, B., Petkovska, N. (2021) *Ndikimi i krizës Covid-19 ndaj personave me aftësi të kufizuar në Maqedoninë e Veriut*, Fondacioni për demokraci Vestiministër, Maqedonia e Veriut, fq. 27.

32 Poposka, Zh. (2018) *Interpretues i Konventës ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar të Organizatës së Kombeve të Bashkuara*, Polio Plus – Shkup, fq. 15.

33 <https://vlada.mk/KoordinativnoTelo/PravaNaLicaSoPoprechenost>

34 <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/cat.aspx>

35 Report of the Special Rapporteur on torture and other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment, Juan E. Méndez, A/HRC/22/53, paragraf 83, Disponueshëm në: <https://bit.ly/2ZZprek>

36 Interim report of the Special Rapporteur on torture and other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment, A/63/175, fq 48. Disponueshëm në: <https://www.un.org/disabilities/images/A.63.175.doc>

37 *Interim report of the Special Rapporteur on torture and other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment*, A/63/175, paragrafi 49. Disponueshëm në: <https://www.un.org/disabilities/images/A.63.175.doc>

është potencuar nga ana e Komitetit kundër torturës³⁸, ndalimi për torturim patjetër duhet të zbatohet në të gjitha institucionet (publike dhe private) dhe “shtetet duhet të tregojnë një vëmendje të posaçme për të parandaluar, hetuar, përndjekur dhe dënuar nëpunësit shtetëror ose aktorët privatë.” Kështu, në rastin *Mr. X v. United Republic of Tanzania*³⁹, Komiteti qartë kishte deklaruar se shteti ka obligim pozitiv për të parandaluar dhe dënuar aktet e keqtrajtimit ose veprimit dhe ndëshkimit të ashpër, çnjerëzor ose poshtëruës, të kryera nga ana e aktorëve shtetëror dhe të tjerëve (jo shtetëror), në pajtim me Komentin e përgjithshëm numër 20 të Komitetit për të drejtat e njeriut⁴⁰. Në mënyrë plotësuese, Komiteti thekson se ekspeditiviteti dhe efikasiteti kanë rëndësi të posaçme në vendimmarrjen gjyqësore për këto raste. Në rastin konkret, ku aplikuesi që është person me albinizëm, i është prerë dora e majtë nën bërthmë nga ana e dy personave të panjohur, Komiteti konsideron se vuajtja që i është shkaktuar aplikuesit për shkak të mungesës së veprimeve shtetërore, që duhet të mundësojnë përndjekjen efektive të kryerësve të dyshimtë të veprës penale, është arsye për ri viktimizim dhe paraqet një mundim psikologjik dhe/ose keqtrajtim, kështu duke konstatuar shkele të nenit 15 të KDPAK⁴¹.

Shikuar nga aspekti i nenit 14 paragrafi 2 nga KDPAK, shtetet kanë për obligim që të sigurojnë se personat e privuar nga liria të kenë të drejtë për “sigurimin e aftësisë përkatëse”⁴². Në këtë linjë edhe Raportuesi i posaçëm për torturë⁴³ potencon se: “mohimi ose mungesa e akomodimit të arsyeshëm të personave me aftësi të kufizuara mund të krijojë kushte të jetesës që janë të njëjta me keqtrajtimin dhe torturën”. Raportuesi i posaçëm për torturë dhe forma tjera të trajtimit ose dënimit të ashpër, çnjerëzor ose poshtëruës⁴⁴ nga ana tjetër potencon se abortet e detyrueshme dhe sterilizimet e grave me aftësi të kufizuara si rezultat i procesit ligjor përmes të cilit miratohen vendime nga ana e kujdestarëve të tyre ligjorë, kundër vullnetit të tyre, paraqesin torturë ose keqtrajtim.

Raportuesi i posaçëm për torturë dhe veprime ose ndëshkime tjera të ashpra, çnjerëzore ose poshtëruëse, potencon se personat me aftësi të kufizuara shpeshherë janë të segreguar në shoqëri, të privuar nga liria një periudhë më të gjatë kohore, përfshirë edhe atë që nënkupton përvojë e përjetshme, ose kundër vullnetit të tyre, ose edhe pa pëlqimin e tyre të lirë dhe të informuar.

Krahas torturës dhe dhunës institucionale, Raportuesi i posaçëm për torturë dhe veprime ose ndëshkime tjera të ashpra, çnjerëzore ose , e potencon edhe dhunën dhe torturën ndaj personave me aftësi të kufizuara në sferën private, me ç’rast “personat me aftësi të kufizuara, burra dhe gra, kanë tre herë më shumë mundësi që të jenë viktimat të keqpërdorimit fizik dhe keqpërdorimit seksual dhe përdhunimit, si prej duarve të anëtarëve të familjes, ashtu edhe nga kujdestarët e tyre. Gratë dhe vajzat përjetojnë shkallë të lartë të dhunës,

38 *General Comment No. 2: Implementation of Article 2 by States Parties*, 24 January 2008, CAT/C/GC/2, paragrafi 18. Disponueshëm në: <https://www.refworld.org/docid/47ac78ce2.html>

39 <https://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/CRPD/CRPD-C-18-DR-22-2014.pdf>

40 *General Comment No. 20: Prohibition of torture or other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment (article 7)*, Human Rights Committee, Forty-fourth Session, A/44/40, 10 March 1992, paragrafi 13. <https://www.refworld.org/docid/453883fb0.html>

41 Poposka, Zh. (2018) *Interpretuese e Konventës ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*, Polio Plus. Disponueshëm në: https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/tolkuvac-un_konvencija.pdf

42 *Interim report of the Special Rapporteur on torture and other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment*, A/63/175, paragrafi 54. Disponueshëm në: <https://www.un.org/disabilities/images/A.63.175.doc>

43 *Ibid.*

44 Report of the Special Rapporteur on torture and other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment, Manfred Nowak A/HR/7/3, 15 Januarz 2008, f 38 i Disponueshëm në: <https://www.refworld.org/pdfid/47c2c5452.pdf>

përfshirë edhe dhunën nga partneri intim, si rezultat i diskriminimit të dyfishtë në bazë të gjinisë dhe aftësisë të kufizuara”⁴⁵.

Qëllimi kryesor i **Konventës për të drejtat e fëmijës (KPD)**⁴⁶ është që të pranojë të gjitha të drejtat qytetare, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore për të gjithë fëmijët, duke marrë parasysh gjendjen specifike të fëmijëve në shoqëri, duke krijuar obligime konkrete për mbrojtjen e fëmijëve nga shkeljet e mundshme të këtyre të drejtave, në veçanti atyre shkeljeve që ka më shumë rrezik (dhunë, pengmarrje, shitje ose tregti me njerëz, eksploatimi ekonomik, keqpërdorimi seksual etj.) Qasja e vetme ndaj perspektivës gjinore dhe aftësisë të kufizuara gjendet në nenin 2 nga KPD, që mes tjerash, ndalon diskriminimin sipas gjinisë dhe aftësisë të kufizuara dhe në të cilën theksohet se “shtetet duhet t’i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që të sigurohet mbrojtja e fëmijës nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimeve në bazë të statusit, aktiviteteve, mendimit të shprehur ose bindjeve të prindërve, kujdestarëve ligjorë ose anëtarëve të familjes së fëmijës” (neni 2 (2)). Në nenin 19 paragrafi (1) KPD potencon se “shtetet duhet t’i ndërmarrin të gjitha masat përkatëse ligjvënëse, administrative, sociale dhe arsimore për mbrojtjen e fëmijës nga të gjitha format e dhunës fizike ose mendore, lëndimeve ose keqpërdorimeve, anashkalimeve ose mospërfilljes, keqtrajtimeve, ose eksploatimeve, përfshirë edhe keqpërdorimin seksual”, si dhe të miratojnë masa preventive siç janë programet sociale për përkrahjen e fëmijëve dhe kujdestarëve të tyre, masa për identifikimin, paraqitjen, udhëzimin, hulumtimin, shërbimin dhe ndjekjen e keqtrajtimeve të fëmijëve, si dhe masa për inkuadrimitin e gjyqësorit (neni 19 (2)). KPD gjithashtu i fton shtetet që të ndërmarrin “masa përkatëse për promovimin e forcimit fizik dhe psikik, dhe riintegrimin social të fëmijëve viktimat të çfarëdo forme të anashkalimit, eksploatimit, ose keqpërdorimit; torturës ose formave tjera të veprimit ose ndëshkimit të ashpër, çnjerëzor ose poshtëruës” (neni 39). Në Komentin e përgjithshëm numër 9 (2006)⁴⁷ për fëmijët me aftësi të kufizuara, Komiteti i KPD në paragrafin 10 udhëzon për diskriminimin gjinor, duke potencuar se vajzat me aftësi të kufizuara janë shpesh më të cenuara nga diskriminimi dhe kërkohet nga shtetet që të kushtojnë vëmendje të posaçme për vajzat me aftësi të kufizuara, duke ndërmarrë masat e domosdoshme, përfshirë edhe masat plotësuese, me qëllim që të sigurohet se ato kanë mbrojtje të mirë, kanë qasje në shërbimet dhe janë tërësisht të inkuadruar në shoqëri.

Komenti i përgjithshëm nr.13⁴⁸ për të drejtën e fëmijës për lirinë nga të gjitha format e dhunës, që miraton një perspektivë më të qartë gjinore dhe e përfshinë çështjen e aftësisë të kufizuara. Në këtë koment, Komiteti i KDF potencon se shtetet duhet t’i ndërmarrin “të gjitha masat përkatëse ligjvënëse, administrative, sociale dhe arsimore për mbrojtjen e fëmijës nga të gjitha format e dhunës fizike ose mendore, nga lëndimi ose keqpërdorimi, anashkalimi ose veprimi i pavetëdijshëm, keqtrajtimi ose eksploatimi, përfshirë edhe keqpërdorimin seksual, derisa është në përkujdesje të prindërit(ve), kujdestarit(ëve) ligjor, ose cilitdo person tjetër që kujdeset për fëmijën”, si dhe të ndërmerrin “procedura efektive për krijimin e programeve sociale për të siguruar përkrahjen e nevojshme për fëmijët dhe për ata që kujdesen për fëmijën, si dhe forma tjera të parandalimit, si dhe për identifikimin, raportimin, udhëzimin, hetimin, trajtimin dhe përcjelljen e rasteve të keqtrajtimit të fëmijëve siç janë

45 *Interim report of the Special Rapporteur on torture and other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment*, A/63/175, paragraf 68. Disponueshëm në: <https://www.un.org/disabilities/images/A.63.175.doc>

46 <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx>

47 Koment i përgjithshëm numër 9 (2010) për fëmijë me aftësi të kufizuara. Disponueshëm në <https://www.refworld.org/docid/461b93f72.html>

48 Koment i përgjithshëm numër 13, Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, CRC/C/GC/13, Disponueshëm në: <https://www.refworld.org/docid/4e6da4922.html>

përshkruar deri më tani, si dhe siç është adekuate, për involvimin gjyqësor”. KDF gjithashtu kërkon pjesëmarrje aktive të fëmijëve me aftësi të kufizuara në kuadër të komunitetit (neni 23 (1)) dhe konkretisht ka të bëjë edhe me lirinë e shprehjes, si dhe me mendimin dhe qasjen në informatat (neni 13 dhe 17) të cilat kanë rëndësi vitale për t'i mundësuar fëmijës që të mësojë se çfarë është dhuna dhe ku mund të drejtohet për ndihmë.

Konventa e OKB për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW) (1979)⁴⁹ me **Protokollin Fakultativ të Konventës** është një prej dokumenteve kyçe për të drejtat e grave. CEDAW kërkon nga vendet që ta eliminojnë diskriminimin ndaj grave në sferën publike dhe private, përfshirë edhe familjen, duke pranuar se rolet dhe stereotipat tradicionale gjinore patjetër duhet të eliminohen me qëllim për t'u dhënë fund të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave. CEDAW potencon se shtetet duhet të sigurojnë qasje të barabartë, mundësi të barabarta dhe rezultate të barabarta për gratë dhe vajzat. Edhe përkundër kornizës gjithëpërfshirëse, prapë se prapë CEDAW nuk ka referencë eksplicite në lidhje me çështjen e aftësive të kufizuara. Zbrazëtira e këtyllë është e plotësuar nga ana e Komitetit për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave përmes dy rekomandimeve të përgjithshme. Përmes rekomandimit të përgjithshëm 18⁵⁰, Komiteti i fton shtetet që përmes raportit të bëjnë referencë për gjendjen dhe statusin e grave me aftësi të kufizuara, veçanërisht në aspekt të punësimit, arsimimit dhe sigurisë sociale, si dhe pjesëmarrjes së tyre në jetën shoqërore dhe kulturore. Rekomandimi i përgjithshëm 24⁵¹ ka të bëjë me gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara dhe shëndetin e tyre, ku kërkohet nga ana e shteteve koment dhe analizë për gjendjen shëndetësore të grave me aftësi të kufizuara. Koncepti i dhunës si formë e diskriminimit dhe shkeljes së të drejtave të njeriut njihet me rekomandimin e përgjithshëm nr. 19⁵² (1992) ku Komiteti potencon se “*dhuna gjinore është formë e diskriminimit ndaj grave*”.

Komiteti në vitin 2017 e miratoi Rekomandimin e përgjithshëm nr.35⁵³ me të cilën azhurnohet Rekomandimi i përgjithshëm 19 dhe jepen udhëzime të qarta për shtetet se cilat masa duhet t'i ndërmarrin për t'u ballafaquar me të gjitha format e dhunës me bazë gjinore. Në këtë Rekomandim, rekomandohet që të hiqen “*dispozitat që lejojnë, tolerojnë ose miratojnë format e dhunës me bazë gjinore ndaj grave, [...] dispozitat që mundësojnë që të kryhen procedura mjekësore te femrat me aftësi të kufizuara, pa pëlqimin e tyre të informuar, si dhe dispozitat me të cilat kriminalizohet aborti...*” (par. 29 t.s.a.i.). Në këtë Rekomandim shihet edhe barriera komunikuese për viktimat me aftësi të kufizuara (par. 31, t. a, a. ii) si dhe domosdoshmëria për sigurimin e informatave në dispozicion (par. 31, t.d)

Në vitin 2018, Komiteti për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe Komiteti i KDPAK, në aspekt të shëndetit seksual dhe riprodhues dhe të drejtave të grave, veçanërisht të grave me aftësi të kufizuara, i fton shtetet që “*ta dekriminalizojnë abortin në të gjitha rrethanat dhe ta legalizojnë në atë mënyrë që tërësisht do të respektohet autonomia e grave, përfshirë edhe gratë me aftësi të kufizuara. Gjatë të gjitha përpjekjeve për zbatimin e obligimeve të tyre në lidhje me shëndetin seksual dhe riprodhues dhe të drejtat, përfshirë edhe qasjen për abort të sigurt dhe legal, Komitetet i ftojnë shtetet që të marrin qasje bazuar në të drejtat e njeriut, me të cilin do të mbrohet përzgjedhja dhe autonomia*

49 <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/cedaw.aspx>

50 <https://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/recommendations/>

51 <https://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/recommendations/>

52 [https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared Documents/1_Global/INT_CEDAW_GEC_3731_E.pdf](https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/1_Global/INT_CEDAW_GEC_3731_E.pdf)

53 Committee on the Elimination of Discrimination against Women (2017) General Recommendation No. 35 on gender based violence against women, updating general recommendation No. 19, U.N.Doc. C/GC/25.

riprodhuese e të gjitha grave, përfshirë edhe gratë me aftësi të kufizuara”⁵⁴.

Republika e Maqedonisë së Veriut e parashtroi raportin e gjashtë periodik në vitin 2017⁵⁵, ndërsa Komiteti i publikoi konkluzionet dhe rekomandimet e veta në vitin 2018, ku mes tjerash, në veçanti rekomandon implementimin e masave të posaçme ndaj grave që u janë nënshtruar formave interseksionale të diskriminimit, në mesin e të cilave janë edhe gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara (20(c)), si dhe miratimi i strategjisë gjithëpërfshirëse për parandalimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore, në veçanti duke u fokusuar ndaj situatave me rrezik të lartë për gratë me aftësi të kufizuara(24(d))⁵⁶.

Republika e Maqedonisë së Veriut është nënshkruese e **Deklaratës së Pekinit dhe Plat-formës për aksion (1995)**⁵⁷ me të cilën obligohet për përmirësimin e statusit të grave dhe forcimit të tyre në jetën publike dhe private. Njëra prej sferave të përfshira me Deklaratën e Pekinit është dhuna ndaj grave, ku gratë me aftësi të kufizuara janë të ndarë si një grup me rrezik të veçantë ndaj dhunës, ndërsa shtetet ftohen që të krijojnë sisteme adekuate për mbrojtjen dhe përkrahjen e tyre. Në vitin 2020 u nënshkrua **Korniza e bashkëpunimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Kombeve të Bashkuara 2021-2025**⁵⁸ me të cilën orientohet puna e agjencive të KB në vend, në 5 vitet e ardhshme. Në Kornizë është theksuar se megjithëse Maqedonia e Veriut i ka ratifikuar marrëveshjet kryesore e të drejtave të njeriut, “*rezultatet tregojnë se të drejtat e grave dhe vajzave, fëmijëve, komuniteteve etnike (në veçanti romëve), personave me aftësi të kufizuara dhe refugjatëve, prapë se prapë janë të cenuara. Këto grupe janë gjithnjë e më shpesh viktime të paragjyqimeve shoqërore dhe stereotipave negative, që ndikojnë në kohezionin e pambrojtueshëm në shoqëri*” (paragrafi 3).

Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit)⁵⁹ është dokumenti më gjithëpërfshirës në sferën e dhunës ndaj grave, i cili jep një kornizë të gjerë të veprimit për parandalimin, mbrojtjen dhe përkrahjen e viktimave dhe ndëshkimin e dhunuesve. Gratë me aftësi të kufizuara mund të nënshtrohen ndaj të njëjtave lloje të dhunës sikurse edhe gratë pa aftësi të kufizuara. Megjithatë, jeta me aftësi të kufizuara shpie në arsye, forma dhe pasoja shtesë nga dhuna dhe në këtë mënyrë kërkon një vëmendje më gjithëpërfshirëse. Kjo është e shënuar edhe në Konventën e Stambollit, në të cilën theksohet se te “*vepra penale [e cila] është kryer ndaj një personi i cili ka qenë i rrezikuar për shkak të rrethanave të caktuara*” patjetër duhet të merren parasysh si rrethana rënduese (neni 46 pika 1v). Stereotipizimi dhe seksizmi janë të lidhura ngushtë me dhunën me bazë gjinore dhe diskriminimin në të gjitha sferat e jetës. Marrja e masave për “*promovimin e ndryshimeve në shabllonët shoqërore dhe kulturore të sjelljes së grave dhe burrave, me qëllim të çrrënjësjes së paragjyqimeve, zakoneve, traditave dhe të gjitha praktikave tjera që bazohen në idenë e inferioritetit të grave ose ndaj roleve paragjyquese për gratë dhe burrat*” është theksuar gjithashtu në nenin 12 pika 1 nga KS. Në obligimet e përcaktuara nga KS është edhe nevoja që secili vend nënshkrues të ndërmarrë ndryshime normative të kornizës juridike dhe përmbajtjes nga ndërmarrja e çfarëdo akti të

54 Deklaratë e përbashkët e Komitetit për eliminim të të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe Komitetit të KDPAK për shëndetin seksual dhe reprodutiv dhe të drejtat e grave, veçanërisht për grat me aftësi të kufizuara. Disponueshëm në <https://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/CRPD/Statements/GuaranteeingSexualReproductiveHealth.DOCX>

55 <https://www.mtsp.gov.mk/content/word/dokumenti/dokumenti%202017/CEDAW%202017%20final.doc>

56 <https://bit.ly/3ppuEn8>

57 https://beijing20.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/csw/pfa_e_final_web.pdf

58 <https://northmacedonia.un.org/mk/100160-ramka-za-sorabotka-za-odrzhliv-razvoj-megu-republika-severna-makedonija-i-obedinetite-nacii>

59 <https://rm.coe.int/168046253a>

dhunës ndaj grave (neni 5), si dhe se do të ndërmerren masa për promovimin dhe zbatimin e politikave të barazisë ndërmjet grave dhe burrave dhe për forcimin e grave (neni 6). Me rëndësi për këtë segment është vendosja e një qasje më të gjerë, me ç'rast masat speciale që janë të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna me bazë gjinore, nuk konsiderohen si diskriminim në aspekt të kësaj Konvente. Me këtë hapet një mundësi që të ndërmerren masa afirmative për mbrojtjen nga dhuna të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, në pajtim me nenin 16 nga KDPAK. Edhe krahas faktit se në nenin 11 nga KS gjatë mbledhjes së të dhënave nuk referohen në veçanti ndaj aftësive të kufizuara, prapë se prapë duke u thirrur në preambulën dhe obligimet e KDPAK, është fakt pozitiv që ekziston një obligim për vendet nënshkruese që të mbledhin të dhëna të shpërndara statistikore për rastet e të gjitha formave të dhunës ndaj grave, të cilat janë të përfshira me KS, si dhe të realizojnë anketa në mesin e popullsisë për të vlerësuar prevalencën dhe trendët e dhunës ndaj grave (neni 11 pika 2). Në pajtim me këtë rekomandim, Enti Shtetëror i Statistikës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për herë të parë do të realizojë një anketë për dhunën me bazë gjinore, në të cilën të dhënat do të ndahen edhe sipas aftësive të kufizuara.

Në nenin 36 të KS - dhuna seksuale, përfshirë edhe përdhunimin, potencohet se *“pëlqimi patjetër duhet të jetë dhënë vullnetarisht si rezultat i vullnetit të lirë të personit, vlerësuar në kontekst të rrethanave të ambientit”* (pika 2), si dhe se gjatë abortit të detyrueshëm dhe sterilizimit të detyrueshëm (neni 39) vendet nënshkruese do të ndërmerren *“masat e nevojshme ligjvënësedhe masa tjera, për të siguruar se bëhet inkriminim [...] kryerja e abortit ndaj një gruaje pa pëlqimin e saj paraprak të informuar (a.) dhe kryerjes së operacioneve ndaj gruas pa pëlqimin e saj paraprak të informuar, respektivisht kuptimin e procedurës që ka si qëllim ose pasojë ndërprerjen e aftësisë së saj për riprodhim natyror (b.)”*. Këto nene janë të lidhura ngushtë me nenin 12 dhe 16, në një linjë me nenin 5, 6 dhe 19 nga KDPAK.

Krahas parandalimit, KS potencon edhe nevojën për mbrojtjen e viktimave të dhunës, krijimin e një përkrahje adekuate juridike dhe mjekësore, si dhe procedura për akuzimin dhe përndjekjen e kryerësve. Kjo përkrahje kërkon ndryshime në sistemet arsimore për edukimin e të rinjve, sigurimin e shërbimeve telefonike 24/7, strehimoreve, këshillimit juridik dhe psikologjik, mbledhjen e të dhënave për veprat penale gjinore dhe zbatimin të shpejtë të hetimeve efikase të atyre krimeve. KS gjithashtu kërkon nga shtetet nënshkruese që t'i forcojnë kapacitetet institucionale dhe administrative dhe të krijojnë strehimore përkatëse për viktimat dhe të sigurojnë kuadër të trajnuar dhe specializuar. Në këtë drejtim kërkohet që të formohen qendra, si dhe adaptimi i strehimoreve për nevojat e grupeve të ndryshme të rrezikuara, në mesin e të cilave janë edhe gratë me aftësi të kufizuara.

Republika e Maqedonisë së Veriut e ka ratifikuar Konventën e Stambollit në vitin 2017, ndërsa ka hyrë në fuqi në vitin 2018, me çka edhe e filloi procesin e implementimit dhe harmonizimit të kornizës juridike nacionale me rekomandimet e KS. Në vitin 2018 u miratua edhe Plani i veprimit për zbatimin e Konventës 2018-2023⁶⁰ në të cilin konkretisht janë theksuar detyrat dhe obligimet e institucioneve që janë të prekura me problemin e dhunës me bazë gjinore.

Në **Rezolutën e Parlamentit Evropian nga viti 2018 në lidhje me gjendjen e grave me aftësi të kufizuara**⁶¹ potencohet se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara kanë pasur më shumë gjasa për të qenë viktimat të dhunës me bazë gjinore, veçanërisht dhunës në familje dhe eksploatimit seksual. Theksohet se kjo ka të bëjë edhe me sterilizimin me dhunë dhe

60 https://mtsp.gov.mk/pocetna-ns_article-nacionalniot-plan-za-sproveduvanje-na-konvencijata-za-sprecuvanje-i-borba-protiv-nasilstvoto-vrz-zen.nspj

61 Rezoluta e Parlamentit Evropian nga viti 2018 për gjendjen e grave me aftësi të kufizuara (2018/2685(RSP). Disponueshëm në: https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-8-2018-0484_EN.html

abortin e detyrueshëm, ku vendet anëtare ftohen që të marrin masa adekuate dhe të sigurojnë shërbime të kualitetit të lartë, të qasshme dhe të përshtatura me qëllim që t'i vihet fund dhunës ndaj grave dhe fëmijëve, duke i përkrahur viktimat e dhunës përmes personelit të trajnuar për këshilla të specializuara, si dhe përkrahje dhe mbrojtje përkatëse juridike. Në mënyrë shtesë, inkurajohen vendet anëtare që t'u sigurojnë të gjithë profesionistëve të tyre shëndetësor dhe arsimor trajnime adekuate për parandalimin e diskriminimit dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara.

Në mendimin e vet, Komiteti për të drejtat ekonomike dhe sociale⁶² thirret në shqyrtimet e konkluzionit të Komitetit të KDPAK për BE, duke potencuar se në nivel të BE-së mungon një kornizë e fuqishme e mbrojtjes juridike, promovimin dhe sigurimin e të gjitha të drejtave të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara dhe njëherë e fton BE-në dhe vendet e saja anëtare që të kyçin aftësitë e kufizuara gjatë strategjive, politikave dhe programeve të ardhshme të barazisë gjinore. Paralelisht, Komiteti potencon se BE dhe legjislacioni kombëtar për parandalimin e eksploatimit, dhunës dhe keqpërdorimit, shpeshherë nuk është i fokusuar ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara dhe në këtë drejtim BE duhet t'i ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për inkuadrimit të aftësive të kufizuara në të gjitha ligjet, politikat dhe strategjitë, që dhuna të kriminalizohet, si dhe të ndërmerren të gjitha masat e domosdoshme ligjvënëse, administrative, sociale dhe arsimore, për të mbrojtur gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, brenda dhe jashtë shtetësisë së tyre, nga të gjitha format e eksploatimit, dhunës dhe keqpërdorimit, në mënyrë që të lehtësohet qasja e tyre në drejtësi duke siguruar një mbrojtje adekuate⁶³.

Karta sociale evropiane (e reviduar)⁶⁴ e përfshin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara, pa marrë parasysh moshën e tyre, natyrën dhe prejardhjen e aftësive të kufizuara të tyre, pavarësinë, integritetin social dhe pjesëmarrjen në jetën e komunitetit (neni 15) dhe të drejtën e fëmijës që të mbrohet nga keqtrajtimi, dhuna dhe eksploatimi (neni 17).

Rekomandimi (CM/Rec(2012)6) i Komitetit të Ministrave për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara⁶⁵ nga viti 2012, i thërret vendet anëtare që të miratojnë masat adekuate ligjore për të zbatuar edhe veprime tjera pozitive për të nxitur gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara që të marrin pjesë në të gjitha sferat e jetës si qytetare me të drejta dhe obligime të barabarta.

Gjithashtu, në Rekomandim i kushtohet vëmendje e veçantë edhe dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara dhe, mes tjerash, inkurajohen vendet anëtare që t'i mësojnë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara që të dinë dhe respektojnë integritetin personal fizik dhe psikologjik, të dallojnë dhunën dhe keqpërdorimin, të dinë se si të mbrohen dhe t'i paraqesin rastet e dhunës dhe keqpërdorimit. Komiteti i ministrave të Këshillit të Evropës miratoi edhe disa rekomandime që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke mbuluar çështjet e dhunës ndaj fëmijëve dhe të rriturve që kanë aftësi të kufizuara, të drejtat e fëmijëve që jetojnë në institucione, dhe institucionalizimin e shërbimeve sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe kështu me radhë. Edhe krahas faktit që këto rekomandime nuk janë obliguese, prapë se prapë të njëjtat mund të jenë udhëzime të mira për zhvillimin e mëtejshëm të politikave dhe mbrojtjes juridike të fëmijëve dhe të moshuarve që kanë aftësi të kufizuara, duke marrë parasysh qasjen e tyre interseksionale.

62 European Economic and Social Committee, The situation of women with disabilities [Exploratory opinion requested by the European Parliament], SOC/579. Disponueshëm në: <https://bit.ly/3o9S8wO>

63 Ibid., paragrafi 5.1-5.3.

64 https://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/European%20social%20charter%20_revised_%20MKD%20translation.pdf

65 https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805caaf7

Në kuadër të Këshillit të Evropës është miratuar edhe **Konventa për mbrojtjen e fëmijëve nga eksploatimi seksual dhe keqpërdorimi seksual** (2007)⁶⁶ me të cilën janë përcaktuar format e ndryshme të keqpërdorimit seksual të fëmijëve si vepra penale, përfshirë edhe keqpërdorimin e kryer në shtëpi ose familje, duke përdorur forcën, detyrimin ose kërcënimet. Në bazat e diskriminimit, aftësitë e kufizuara shihen si bazë diskriminimit (neni 2). Neni 18 kërkon që shtetet anëtare ta kriminalizojnë keqpërdorimin seksual që është kryer, mes tjerash, ndaj fëmijëve me “aftësi të kufizuara mendore ose fizike ose në situatë të varshmërisë”, ndërsa neni 28 i obligon shtetet anëtare që t’i ndërmarrin masat e domosdoshme që të sigurohen se veprat e kryera posaçërisht ndaj viktimave të cenushme “*të merren parasysh si rrethana vështirësuese gjatë përcaktimit të sanksioneve*”.

Komisioni Evropian e miratoi **Strategjinë për barazi gjinore 2020-2025**⁶⁷ qëllimet dhe prioritetet e të cilave përfshijnë lirinë nga dhuna dhe stereotipat, avancimin e ekonomisë së barabartë gjinore, udhëheqjen me barazi në tërë shoqërinë, integrimin e politikave gjinore dhe perspektivë interseksionale të politikave, financimin e aktiviteteve për avancimin e barazisë gjinore dhe forcimin e grave në botë. Në Strategji theksohet se “*gratë që kanë probleme shëndetësore ose aftësi të kufizuara kanë më shumë gjasa që të përjetojnë forma të ndryshme të dhunës*” dhe në veçanti theksohet nevoja për një qasje interseksionale⁶⁸ në ballafaqimin me diskriminimin dhe dhunën ndaj grave.

Në **Strategjinë e BE-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (2021-2030)**⁶⁹ potencohet se personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë për mbrojtje nga çfarëdo forme e diskriminimit dhe dhunës, mundësi të barabarta dhe qasje në drejtësi, arsim, kulturë, banim, rekreacion, kohë të lirë, sport dhe turizëm dhe qasje të barabartë në të gjitha shërbimet shëndetësore (paragrafi 5). Në aspekt të qasjes në drejtësi dhedhunë, në Strategji është potencuar se Komisioni Evropian do të fokusohet në trajnimin e trupave juridike, gjyqësorit. Në Strategji është potencuar se Komisioni do të sigurojë përfshirjen e aspekteve të dhunës dhe keqpërdorimit për shkak të aftësive të kufizuara, në politikat e ardhshme relevante të BE-së, që do të përfshijnë monitorimin e institucioneve dhe identifikimin sistematik dhe hetimin e rasteve të dhunës, krimit ose keqpërdorimit.

Konventa Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut (KEDNJ) paraqet një dokument të detyrueshëm juridik për të gjitha vendet evropiane që e kanë ratifikuar dhe janë pajtuar për të krijuar kushte për realizimin e të drejtave themelore të njeriut në kuadër të sistemeve të tyre nacionale, si dhe të sigurojnë mbrojtje juridike për secilin individ në nivel nacional. Efektet e aktgjykimeve të **Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ)** kanë efekt *inter partes*, por edhe *erga omnes*. Për dallim nga instrumentet e tjera ndërkombëtare, KDPAK në pajtim me nenin 44 lejon, që krahas organizatave shtetërore dhe rajonale siç është Bashkimi Evropian, të bëhen palë kontraktuese të KDPAK, të cilën tanimë e bën BE-ja⁷⁰. Me të drejtën ndërkombëtare, BE-ja dhe anëtalet e saja janë të obliguara që bashkërisht të promovojnë, mbrojnë dhe sigurojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, në pajtim me KDPAK, përfshirë edhe ato të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara.

66 <https://rm.coe.int/1680084822>

67 European Commission, 5.3.2020, A Union of Equality: Gender Equality Strategy 2020-2025, COM(2020) 152 final. Disponueshëm në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020DC0152&from=EN>

68 Sipas Institutit Evropian për Barazin Gjinore (EIGE), interseksionaliteti është një mjet analitik për të studiuar, kuptuar dhe përgjigjur mënyrave në të cilat gjinia dhe seksi kryqëzohen me karakteristika/identitete tjera dhe se si këto interseksione kontribuojnë në përvoja unike të diskriminimit. (<https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1263?lang=mk>)

69 <https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=738&langId=en&pubId=8376&furtherPubs=yes>

70 Për Bashkimin Evropian, Konventa hyri në fuqi në janar 2011. Shih: Council Decision 2010/48/EC of 26 November 2009 concerning the conclusion, by the European Community, of the United Nations Convention on the Rights of Persons with Disabilities, OJ L 23, 27.1.2010. Disponueshëm në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32010D0048>

KEDNJ nuk përmban referencë konkrete për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, e as që ka të drejtë konkrete lidhur me dhunën. Edhe përkundër kësaj, e njëjta përmban të drejta që janë relevante në kontekst të aftësive të kufizuara dhe dhunës, siç janë e drejta e jetës (neni 2), e drejta e mbrojtjes nga tortura dhe veprimet ose ndëshkimet çnjerëzore ose poshtëruese (neni 3), e drejta e lirisë dhe sigurisë (neni 5), e drejta e gjyqimit të drejtë (neni 6) dhe e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare (neni 8). Ndalimi për diskriminim në mënyrë të prerë është paraparë në nenin 14 të KEDNJ. Protokollin nr. 12 ndaj KEDNJ në mënyrë plotësuese e definon diskriminimin, por aftësitë e kufizuara nuk janë përmendur në mënyrë eksplicite si bazë për diskriminim⁷¹.

Para miratimit të KDPAK, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) nuk kishte qëndrim në lidhje me arsyetimet e iniciuara nga ana e aktorëve të ndryshme dhe vetë shteteve në aspekt të trajtimeve mjekësore dhe regjimeve të ndryshme të kujdestarive që imponohen ndaj personave me aftësi ndryshme të kufizuara, me theks të statusit të tyre të punës, si dhe dhunës dhe keqpërdorimit të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara. Në kontekst të dhunës ndaj grave me aftësi të kufizuara, praktika gjyqësore është tejet modeste. Ekzistimi i obligimeve të palëve të kontraktuara për mbrojtjen e personave/grave me aftësi të kufizuara në institucione mund të shihet përmes rastit *X and Y v. The Netherlands* od 1985⁷², ndërsa ka lidhje me përdhunimin e “*një vajze me të meta mendore*” të moshës 16 vjeçare në një shtëpi për fëmijë me aftësi të kufizuara mendore. Në këtë rast GJEDNJ e potencon obligimin se shtetet patjetër duhet të krijojnë procedura për t’u mundësuar fëmijëve me aftësi të kufizuara, që të paraqesin dhunën.

Rastet më të reja të GJEDNJ zbulojnë se kushtet e këqija të akomodimit të personave me aftësi të kufizuara paraqesin trajtim jonjerëzor dhe nënçmues. Kështu, në rastin *Stanev v. Bulgaria*⁷³ nga viti 2012, GJEDNJ kishte konstatuar se z. Stanev ishte mbajtur padrejtësisht shtatë vite në një objekt ku nuk ka pasur ushqim adekuat, ujë, qasje në tualete, privatësi ose thujtje çfarëdo forme të aktiviteteve të rëndësishme. Sipas GJEDNJ, këto kushte paraqesin një veprim “nënçmues” - por jo edhe torturë.

Në praktikën gjyqësore të GJEDNJ mund të hasen disa raste në të cilat është konstatuar se shteti është përgjegjës për faktin që jo mjaftueshëm ka mbrojtur të drejtën e jetës së individit nga ana e sulmeve të paligjshme nga persona të tjerë. Në rastin *Z. and Others v. the United Kingdom*⁷⁴, si dhe në rastin *A. v. the United Kingdom*, GJEDNJ potencon ndaj obligimit që shtete duhet të ndërmarrin masa për mbrojtjen e individëve e veçanërisht fëmijëve dhe kategorive të tjera të cenushme nga veprimet e këqija, si dhe të ndërmarrin hapa për të parandaluar keqtrajtimin për të cilin autoritetet me gjasë kanë njohuri.

Në aspekt të çështjes për adaptimin përkatës, megjithëse e njëjta nuk përmendet në mënyrë të prerë në nenin 14 në bazat e mbrojtjes nga diskriminimi, prapë se prapë, ajo është paraqitur në disa raste të shqyrtuara nga ana e GJEDNJ, veçanërisht me nenet 3, 6 dhe 8 nga KEDNJ. Për shembull, për nenin 3, në rastin *Price v. United Kingdom*⁷⁵, parashihet se obligimi i shteteve për të vepruar më ndryshe me të burgosurit me aftësi të kufizuara, për dallim me veprimin që e marrin të burgosurit e tjerë, veçanërisht ata që janë në kuadër të sistemit të burgjeve, kjo me qëllim që të mos ju shkaktohen dëme më të mëdha.

71 https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_MKD.pdf

72 X and Y v. the Netherlands, 26 March 1985, § 23, Series A no. 91. Disponueshëm në: <https://bit.ly/2ZVmlaG>

73 Stanev v. Bulgaria case, Application No.36760/06, nga 17 janar 2012.

74 https://www.legislationline.org/download/id/3520/file/Case_of_Z_and_Others_v_UK_2001_en.pdf

75 <https://www.globalhealthrights.org/wp-content/uploads/2013/02/ECTHR-2001-Price-v-United-Kingdom.pdf>

Edhe pse KDPAK është ratifikuar nga ana e BE-së dhe vendet e saja anëtare, Komiteti për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, në konstatimet e saj konkluduese ka potencuar dhunën fizike, psikike dhe seksuale dhe keqpërdorimin e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht grave me aftësi të kufizuara në kuadër të familjes dhe kushtet institucionale, si dhe realizimin e ndërhyrjeve mjekësore, përfshirë edhe abortin dhe sterilizimin e detyrueshëm⁷⁶.

Edhe krahas juridiksionit modest në lidhje me çështjen e dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, për t'i realizuar dhe përkrahur vlerat themelore të shoqërive demokratike, shoqëria patjetër duhet t'u bëhet ballë sfidave rreth çështjes së plotësimin të të drejtave të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, që duhet të mbrohen dhe garantohen njësoj si kurse edhe për të tjerët.

KORNIZA NACIONALE JURIDIKE

Në legjislacionin tonë, me rreziqe sociale nënkuptojmë: rreziqet ndaj shëndetit (sëmundjet, lëndimet, aftësitë e kufizuara), rreziqet e pleqërisë dhe plakjes, rreziqet e familjeve me një prind, rreziqet nga papunësia, humbja e të ardhurave të jetesës në bazë të punës dhe të ngjashme, rreziqet nga varfëria dhe rreziqet nga llojet tjera të përjashtimit social⁷⁷. Në bazë të vlerësimit të pabarazive më të theksuara dhe faktorëve kryesorë të diskriminimit, siç janë identiteti (mosha, gjinia, identiteti gjinor, përkatësia etnike, religjioni, aftësitë e kufizuara), vendi gjeografik, rreziku nga traumat, efektet e pavolitshme të sundimit dhe statusi konkret socio ekonomik (ballafaqimi me varfërinë dhe pabarazinë shumëdimensionale), grupet më të rrezikuara në Maqedoninë e Veriut janë: të rinjtë që nuk janë të inkuadruar në arsim, punë ose trajnime (NEET)⁷⁸, gratë dhe vajzat, romët, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, refugjatët/emigrantët/kërkuesit e azilit/personat e shpërngulur brenda vendit/personat pa nënshtetësi, personat LGBTI, njerëzit që jetojnë në rajonet rurale dhe personat e moshuar⁷⁹.

Në vitin 2021 u miratua **Ligji i ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna të grave dhe dhuna në familje**⁸⁰, i cili pasoi pas Ligjit për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje⁸¹, ligji i parë sistematik i asaj sferë. Ligji i ri ka për qëllim zgjerimin e sistemit të parandalimit dhe mbrojtjes nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, në pajtim me rekomandimet e KS, respektivisht *“parandalimi dhe pengimi i dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës në familje, mbrojtja efektive e viktimave nga çfarëdo forme e dhunës me bazë gjinore ndaj grave si dhe viktimave të dhunës në familje, duke respektuar liritë themelore të njeriut dhe të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe marrëveshjet ndërkombëtare”*. Ligji e përfshinë edhe parimin e mos diskriminimit, sipas të cilit masat, aktivitetet dhe shërbimet për parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna me bazë gjinore dhe viktimat e dhunës në familje, zbatohen pa diskriminim në bazë të aftësive të kufizuara (neni 5, pika 3). Gratë me aftësi të kufizuara janë të ndara në kategori të rrezikuara të grave (neni 7), kurse në nenin 8 theksohet se *“masat, aktivitetet dhe shërbimet për viktimat e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës në*

familje, duhet të përshtaten në mënyrë adekuate sipas nevojave specifike të grave me aftësi të kufizuara”. Ajo që ka rëndësi esenciale për krijimin e masave të përgjithshme dhe/ose të posaçme për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna, është gjithsesi obligimi për mbledhjen e të dhënave (nenet 28-32). Pozitive në këtë drejtim është gjithsesi se baza e aftësive të kufizuara është e paraparë si një obligim, gjatë mbajtjes së evidencës së lëndëve të DHBGJ ndaj grave dhe viktimave të dhunës në familje.

Edhe përkundër faktit që në Ligj janë të cekura të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, nuk janë përfshirë edhe përkufizimet për dhunën institucionale dhe strukturore ndaj grave me aftësi të kufizuara, që më së shpeshti reflektohet në forma të fshehura ose të hapura të sjelljes institucionale diskriminuese, traditave kulturore diskriminuese dhe normave dhe/ose rregullave shoqërore diskriminuese⁸². Teksti i Ligjit parasheh inkuadrimin e një numri të madh të aktorëve në sigurimin e parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna, por i njëjti nuk parasheh masa përmes të cilave aktorët e ndryshëm do të ndikojnë drejtpërdrejt te gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, si dhe masa me të cilat do të garantohet se mendimet e tyre janë marrë parasysh tërësisht dhe se ato nuk do të jenë të ekspozuara ndaj presioneve për shkak se shprehin qëndrimet dhe problemet e tyre, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe të drejtat seksuale dhe riprodhuese, si dhe DHBGJ, përfshirë edhe dhunën seksuale. Shteti patjetër duhet të promovojë pjesëmarrjen e organizatave reprezentative të grave me aftësi të kufizuara në procesin e përgjithshëm, e jo vetëm në trupat dhe mekanizmat konsultative që kanë lidhje me aftësitë e kufizuara⁸³. Gjithashtu, Komiteti i KDPAK-së në konstatimet e tij konkluduese për shtetin, potencon se *“shteti duhet të zbatojë hetim për të gjitha supozimet për dhunë dhe keqpërdorim të personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht atyre me aftësi të kufizuara psikosociale dhe/ose aftësi të kufizuara intelektuale, si dhe arsyet e dyshimta për vdekjen e shfrytëzuesve të institucioneve.”*

Me qëllim të implementimit më efektiv të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, janë miratuar disa akte nënligjore dhe procedura standarde operative. Në vitin 2015, Qeveria miratoi Protokollin e bashkëpunimit të ndërsjellë të institucioneve kompetente dhe shoqatave për mbrojtjen dhe parandalimin e dhunës në familje⁸⁴, përmes të cilit rregullohet bashkëpunimi i institucioneve kompetente dhe shoqatave për mbrojtjen, ndihmën dhe përkrahjen e viktimave të dhunës në familje, si dhe sigurimin e një trajtimi për autorët e dhunës në familje. Në Rregulloren për mënyrën e realizimit të vlerësimit të rrezikut ndaj jetës dhe integritetit fizik dhe psikik të viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj dhe të rrezikut për përsëritjen e dhunës, menaxhimi përkatës me rrezikun, zbatimin dhe ndjekjen e masave për mbrojtjen e grave viktime të dhunës me bazë gjinore dhe viktimat e dhunës në familje, që janë marrë nga qendrat për punë sociale dhe formularët e nevojshëm⁸⁵, personat profesional i marrin parasysh edhe rrethanat specifike për secilin rast në veçanti (neni 8), ndërsa pengesa është përfshirë edhe vetëm si një prej rrethanave që mund ta rrisë rrezikun e dhunës së ardhshme ndaj viktimës dhe viktimizimin e saj plotësisht (neni 9).

Me Standardet dhe procedurat për punë të qendrës për personat viktime të dhunës në familje (strehimore) ⁸⁶, si një prej indikatorëve është theksuar se qendra duhet të jetë e qasshme

76 European Disability Forum (2021) Violence against women and girls with disabilities in the European Union – Position Paper. Disponueshëm në: <https://bit.ly/3wpuYWY>

77 Spasovska, S., Bornarova, S., Bogoevska, N., Ivanoski, B., Dauti, I., Georgievska, S. (2013) *Doracak për zhvillimin e shërbimeve sociale për grupet vulnerabël në bashkësitë lokale, MPPS.*

78 Shkurtesa: Not in Education, Employment, or Training.

79 DNP 2020, fq. 15. Disponueshëm në: <https://bit.ly/3kqimwO>

80 „Gazeta zyrtare e RMV-së “ nr. 24 nga 29.01.2021

81 „Gazeta zyrtare e RM-së“ nr. 138 nga 17.09.2014

82 Koment i përgjithshëm nr.3 (2016) për gra dhe vajza me aftësi të kufizuara, Komiteti për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, paragrafi 17 (d). Disponueshëm në <https://www.refworld.org/docid/57c977344.html>

83 Raport të referuesit special për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara A/HRC/31/62, paragrafi 70. Disponueshëm <https://undocs.org/en/A/HRC/31/62>

84 <https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/pravilnicisocialna/protokol.pdf>

85 „Gazeta zyrtare e RMV-s “ nr. 240/21. Disponueshëm në: https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/pravilnicisocialna/rizik_pravilnik_240_21.pdf

86 <https://www.mtsp.gov.mk/content/word/dokumenti/dokumenti%202018/standardi/zasolniste.pdf>

për personat me aftësi të kufizuara trupore dhe për lëvizje, me çka kjo nënkupton vetëm personat me aftësi të kufizuara fizike. Standardet e definuar në këtë mënyrë nuk janë në pajtim me standardin për qasje në pajtim me nenin 2, 9 dhe 21 të KDKPAK dhe të njëjtat shpijnë drejt diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara në pajtim me nenin 5 të KDKPAK.

Me miratimin e Planit Nacional të Veprimit për implementimin e KS⁸⁷ në vitin 2018, Qeveria i obligoi të gjitha institucionet dhe organet kompetente për të përpunuar plane operative me të cilat do të parashihen realizimi i aktiviteteve që duhet të shpallen publikisht në ueb faqet e tyre. Prapë se prapë, një pjesë e institucioneve nuk e plotësojnë këtë obligim⁸⁸. Në Planin Operativ për vitin 2020 të Ministrisë së Punëve të Brendshme⁸⁹, një prej aktiviteteve është dhe “*pajisja dhe aftësimi i dhomave të këndshme për shmangien e viktimizimit sekondar të viktimave të dhunës me bazë gjinore, të qasshme edhe për personat me aftësi të kufizuara*”. Në aspekt të trajnimeve, në planin operativ janë theksuar edhe trajnimet e përgjithshme, pa u marrë parasysh ngritja e kapaciteteve të nëpunësve dhe profesionistëve policorë, për të siguruar shërbime, në pajtim me nenin 16 nga KDKPAK.

Në vitin 2020 ishte miratuar një **Ligji i ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi**⁹⁰, i cili e vendos kornizën juridike për mbrojtje nga diskriminimi në baza të ndryshme, me çka, sipas Ligjit, “*ndalohet çdo diskriminim në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes dhe përkatësisë kombëtare ose etnike, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, përkatësisë së një grupi të marginalizuar, gjuhës, nënshtetësisë, prejardhjes sociale, arsimimit, religjionit ose bindjes fetare, bindjes politike, bindjeve tjera, aftësive të kufizuara, moshës, gjendjes familjare ose martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, cilësive personale dhe statusit social ose në çfarëdo baze tjetër (në tekstin e mëtejshëm: bazë diskriminuese)*”. Ligji paraqet një instrument të rëndësishëm për ballafaqimin me diskriminimin e shumfishtë me të cilin ballafaqohen gratë si rezultat i interseksionit të gjinisë me identitetet tjera. Diskriminimi interseksional është theksuar në nenin 13 të ligjit në pjesën e “*formave më të rënda të diskriminimit*”. Në Ligj, aftësitë e kufizuara janë theksuar si një prej bazave të diskriminimit (neni 5), përfshirë edhe përkufizimin e personave me aftësi të kufizuara (neni 4) që është i harmonizuar me nenin 1 nga KDKPAK. Ligji i ndalon të gjitha format e diskriminimit, përfshirë edhe diskriminimin sipas asociacionit, si dhe pamundësimin e një adaptimi adekuat. Mirëpo, është i dukshëm edhe problemi që paraqitet në lidhje me kuptimin dhe zbatimin e parimit të përshtatjes adekuate, për të cilën tregohet se nuk është mjaftë e qartë dhe është interpretuar ndryshe.

Në vitin 2019, është miratuar **Ligji i ri për mbrojtje sociale**⁹¹ që paraqet një hap të madh në avancimin e mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Qëllimi i ligjit është reforma e sistemit të përgjithshëm të mbrojtjes sociale për plotësimin më efektiv të nevojave të qytetarëve, ku mes tjerash, vend të rëndësishëm kanë edhe gratë dhe vajzat e kategorive të rrezikuara. Ligji i ri për mbrojtje sociale e promovon parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit, përfshirë edhe aftësitë e kufizuara si bazë për diskriminim. Edhe krahas barazisë formale, barazia esenciale dhe inkluzive nuk janë siguruar me ligj. Jeta e pavarur, kryesisht varet nga rrjetet joformale për përkrahje. Shërbimet e nevojshme nuk janë zhvilluar

87 https://mtsp.gov.mk/pocetna-ns_article-nacionalniot-plan-za-sproveduvanje-na-konvencijata-za-sprecuvanje-i-borba-protiv-nasilstvoto-vrz-zen.nspix

88 Balshiqevska, M. dhe Avramovska Nushkova, A. (2020) Raporti i Progresit për R. e Maqedonisë së Veriut për zbatimin e Plan veprimit kombëtar për implementimin e Konventës së Stambollit, Rrjeti Kombëtar kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje. Disponueshëm në: <http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2021/02/NAP-finalen.pdf>

89 Plani operativ për 2020 të MPB-së. Disponueshëm në <https://bit.ly/3bOpb48>

90 „Gazetar zyrtare e RMV-së “ nr. 258/2020 nga 30.10.2020

91 „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut “ nr. 104/19, 146/19, 275/19, 302/20 dhe 311/20.

dhe kryesisht janë pjesë e qendrave ditore publike për fëmijë, si dhe OPAK dhe OC. Deinstitutionalizimi është gjerësisht i kuptuar si dislokim i personave me aftësi të kufizuara në shtëpi të vogla në grupe dhe ndryshime në natyrën dhe kujdesin institucional⁹². Palët e interesuara, OPAK dhe OC, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara dhe prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, nuk e kuptojnë nocionin e konceptit të jetës së pavarur⁹³. Gjegjësisht, siç është theksuar në Komentin e Përgjithshëm numër 5 të Komitetit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara⁹⁴, të jetuarit në mënyrë të pavarur dhe përfshirja në komunitet, nënkupton realizimin e lirisë së zgjedhjes dhe kontrollit të vendimeve që ndikojnë në jetën e njeriut me nivel maksimal të vetëvendosjes dhe ndërvarësisë brenda shoqërisë. Kjo e drejtë e përfshinë edhe parimin e dinjitetit të lindur, autonomisë dhe vetëvendosjes, sipas të cilës të gjitha personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë të lirë në përzgjedhjen për të qenë aktiv dhe të jenë pjesë e një kulture sipas përzgjedhjes së tyre dhe patjetër duhet të kenë një shkallë të njëjtë të përzgjedhjes dhe kontrollit ndaj jetëve të tyre si dhe ndaj anëtarëve të tjerë të komunitetit.

Numri i madh i akteve nënligjore në këtë sferë nuk parashohin kurrfarë mekanizmesh për informim, mbrojtje e as rehabilitim të viktimave të dhunës, që janë të akomoduar në format e ndryshme të mbrojtjes jashtë institucionale.

Më tutje, në fazën përfundimtare të përgatitjes është edhe **Ligji i ri për barazi gjinore** i cili do të krijojë një kornizë më të gjerë për barazi gjinore në legjislacionin tonë. Qëllimi i ligjit është që të përfshijë aspektet gjinore gjatë miratimit të vendimeve dhe masave në të gjitha nivelet, vertikalisht dhe horizontalisht, si dhe të sjellë hapa dhe masa konkrete për avancimin e plotë të barazisë gjinore dhe prishjes së stereotipave dhe paragjytimeve gjinore, e me atë edhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Në **Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve**⁹⁵ mungojnë mjaftë masa që mund të çojnë drejtë barazisë inkluzive, nga aspekti i zbatimit të parimit të vullnetit më të mirë dhe preferencave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, parimit për promovimin e identitetit zhvillimor të fëmijëve me aftësi të kufizuara, qasjes për përkufizimin e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara, si dhe përfshirjes së tyre aktive në të gjitha proceset.

Sipas Ligjit, fëmijë “*konsiderohet çdo person deri në moshën 18 vjeçare, si dhe personat me aftësi të kufizuara në zhvillimin mendor dhe trupor deri në moshën 26 vjeçare*” (neni 11). Ligji është i ngarkuar me terminologji të ndryshme dhe ka nocione mjekësore për gjendjen e aftësive të kufizuara. Në nenin 12 (2) është përcaktuar se “*ndalohen të gjitha format e shfrytëzimit seksual dhe keqpërdorimit seksual të fëmijëve (shqetësimi, pornografia fëmijërore, prostitucioni fëmijëror), lëndimet e dhunshme, shitja ose tregtia me fëmijë, dhuna dhe keqtrajtimit psikike dhe fizike, ndëshkimet ose veprimet e tjera çnjerëzore, të gjitha llojet e eksploatimit, shfrytëzimi komercial dhe keqpërdorimi i fëmijëve, me të cilat shkelen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe të drejtat e fëmijës .*” Edhe krahas formave të theksuara të dhunës, Ligji nuk parasheh masa të veçanta për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna të fëmijëve me ose pa aftësi të kufizuara.

Ekzistojnë shumë paragjytime dhe stereotipa ndaj personave me çrregullime psikike, të bazuara në perceptimin e gabuar, “*se këto persona janë të “rrezikshëm” për shoqërinë, “të*

92 Panayotova, K., Kochoska, E. (2020) *Analysis: Work Assistance and Support for Employment of People with Disabilities Leaving Institutional Care*.

93 Ibid.

94 General Comment No. 5 on living independently and being included in the community, Committee on the Rights of Persons with Disabilities, Eleventh session, CRPD/C/GC/5, 27 October 2017. Disponueshëm në: <https://digitallibrary.un.org/record/1311739?ln=en>

95 „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut “ nr.23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18 и 198/18.

paafte për jetë të pavarur”, të “dobët”, “të paafte për të sjellë vendime, “të pavendosur”, “të papërgjegjshëm” dhe ajo që është më dëshpëruesja është se shpallen “faktorë” për sëmundjet e tyre psikike”⁹⁶. Stigmatizimi i këtyre ka pasoja serioze ndaj shëndetit dhe ndjenjës së vlerës personale të personit, që çon drejt izolimit dhe përjashtimit nga shoqëria⁹⁷. **Ligji për shëndetin mendor**⁹⁸ potencon se “mbrojtja e personave me sëmundje mendore bazohet në sigurimin e kujdesit më të mirë, shërbimit dhe rehabilitimit në pajtim me arritjet vijuese të sferës dhe në kuadër të mjeteve në dispozicion, adekuate me nevojat individuale të personit, përjashtimit të çfarëdo keqpërdorimi psikik dhe fizik, duke respektuar në tërësi dinjitetin e personalitetit të tij dhe interesave të tij më të mira”. Në pajtim me nenin 1 nga KDPAK, personat me aftësi të kufizuara psikosociale nuk konsiderohen si persona me aftësi të kufizuara. Sipas rekomandimeve të fundit të Komitetit Evropian për parandalimin e torturës, veprimeve ose ndëshkimeve jonjerëzore ose nënçmuese⁹⁹, krahas nevojës për aktivitete të rregullta në vend të hapur dhe rritjes së aktiviteteve rehabilituese, të gjithë shfrytëzuesve nga ES Demir Kapi, pa dallim nëse janë me aftësi të kufizuara, duhet t’u mundësohet e drejta efektive që të iniciojnë procedura për ligjshmërinë e akomodimit dhe qëndrimit të tyre, si dhe t’ju sigurohet shqyrtimi dhe revidimi i rregullt dhe në kohë i vendimeve për akomodim, nga ana e gjykatave.

Pjesa më e madhe e institucioneve shëndetësore, si dhe një pjesë e madhe e ordinancave shëndetësore publike dhe private, fizikisht nuk kanë qasje¹⁰⁰. Në **Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve**¹⁰¹, parashihet e drejta e informimit për pacientët me aftësi të zvogëluar në mënyrë të përhershme për gjykim (neni 11), por për shkak të mungesës së trajnimeve për komunikim dhe qasje ndaj personave me aftësi të kufizuara, në praktikë kjo e drejtë është vështirësuar. Aftësitë e kufizuara nuk janë pjesë e kriterëve për përsosje profesionale në sferën e shëndetit publik¹⁰². Në realizimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit për shëndetin riprodhues dhe seksual¹⁰³ janë siguruar trajnime për mjekët amë dhe punëtorët socialë në tërë shtetin. Në aspekt të realizimit të së drejtës për ndërprerje të shtatzënisë, në zgjidhen ekzistuese ligjore¹⁰⁴, për një vajzë shtatzënë e cila është e mitur ose të cilës i është hequr aftësia vepruese, kërkesën e parashtron prindi, respektivisht kujdestari i saj (neni 10). Në ligjin për ndërprerjen e shtatzënisë nuk janë paraparë mënyrat e sigurimit të pëlqimit nga gratë me aftësi të kufizuara, e as nuk janë paraparë mënyrat e komunikimit ose këshillimit të grave që janë të vendosura nëpër institucione dhe/ose shtëpi grupore dhe/ose format e reja të jetës së organizuar me përkrahje. Stereotipat dhe mendimet janë një pengesë shtesë për realizimin e të drejtave të mbrojtjes shëndetësore të personat me aftësi të kufizuara¹⁰⁵. Dispozita e vendosur në këtë mënyrë, duke e marrë parasysh gjendjen e grave me aftësi të kufizuara, abortet e detyrueshme dhe sterilizimet e grave, nëse janë rezultat i një procesi lig-

jor përmes të cilit miratohen vendime nga kujdestarët e tyre ligjorë, kundër vullnetit të tyre, mund të paraqesin formë të torturës dhe keqtrajtimit¹⁰⁶. Pozicioni i këtyre i kornizës ligjore, si dhe sistemi i pranishëm ku kujdestarët ose prindërit e një pjese të personave me aftësi të kufizuara, sjellin vendime në emrin e tyre, është tërësisht në kundërshtim me obligimet e KDPAK-së dhe KS-së.

Është obligim i shtetit sipas KDPAK-së që të sigurojë sisteme për përkrahjen e viktimave të cilës do formë të eksploatimit, dhunës dhe keqpërdorimit me qëllim që të promovohet forcimi fizik, mendor dhe psikologjik, rehabilitimi dhe riintegrimi social i personave me aftësi të kufizuara, që duhet të zbatohet në një ambient i cili e avancohet shëndetin, mirëqenien, vetë respektin, dinjitetin dhe autonominë e personit dhe i merr parasysh nevojat specifike në lidhje me gjininë dhe moshën e personit me aftësi të kufizuara¹⁰⁷. Komenti i përgjithshëm numër 2 i Komitetit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara¹⁰⁸, imponon një obligim për shtetet nënshkruese, që të gjitha shtëpitë e sigurta, shërbimet për përkrahje dhe procedurat për të jenë të qasshme edhe për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes efikase dhe të rëndësishme nga dhuna, keqpërdorimi dhe eksploatimi i këtyre personave, veçanërisht grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara. Paralelisht, shteti ka obligim edhe miratimin e një legjislacioni dhe politikave që do të garantojnë se rastet e eksploatimit, dhunës dhe keqpërdorimit të personave me aftësi të kufizuara janë identifikuar, hulumtuar dhe përndjekur penalisht. Komuniteti me aftësi të kufizuara ballafaqohet me vështirësi në aspekt të realizimit të së drejtës për qasje në drejtësi, duke u kufizuar e drejta e gjyqimit të drejtë, në kushte të barabarta¹⁰⁹. Gjykatat vendore janë pothuajse tërësisht jofunksionale për personat me aftësi të kufizuara, ndërsa njohuritë e gjykatësve nga sfera e aftësive të kufizuara¹¹⁰ dhe njohuritë e të drejtave të KDPAK-së janë ende në nivel të ulët. Analiza e procedurave gjyqësore të iniciuara për mbrojtjen nga diskriminimi në vitin 2020, potencojnë për mosmbajtje të statistikës së ndarë në mënyrë të qartë në raport me sferat dhe bazat e diskriminimit, respektivisht se gjykatat nuk e përfshijnë bazën e aftësive të kufizuara, me çka nuk ka të dhëna për trendet dhe dukuritë eventuale në këtë sferë¹¹¹. Personat me aftësi të kufizuara shumë rrallë u drejtohen seksioneve rajonale për ndihmë juridike falas pranë Ministrisë së Drejtësisë, që është si rezultat i informimit të pamjaftueshëm të këtyre shërbimeve, por edhe trajnimit të pamjaftueshëm të nëpunësve për punë me personat me aftësi të kufizuara¹¹². Gjithashtu, organizatat që ofrojnë NJF në përgjithësi nuk disponojnë me kapacitete të mjaftueshme për komunikim me personat me aftësi të kufizuara. Një pjesë e OC që punojnë me kategoritë e rrezikuara (personat me HIV, LGBT, romët, gratë) deri më tani nuk kanë bashkëpunuar dhe nuk i kanë përfshirë personat me aftësi të kufizuara, as si shfrytëzues e as edhe si pjesë e ekipeve të tyre¹¹³.

96 Stamenkova-Trajkova, V., (2013) Paragjykimet ndaj personave me çrregullime psikike dhe përfshirja e tyre në tregun e punës (Disertacion i doktoraturës), Shën Cirili dhe Metodi – Shkup, Fakulteti Filozofik, Instituti për Punë Sociale dhe Politikë Sociale “Nënë Tereza”, fq. 38. Disponueshëm në <https://bit.ly/3Cb164j>

97 Ibid.

98 „Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 71/07 dhe 150/15.

99 Council of Europe (2021) *Report to the Government of North Macedonia on the visit to North Macedonia carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT) from 2 to 10 December 2020*. Disponueshëm në <https://rm.coe.int/1680a359cb>

100 Veličkovski, R. (2012) Shëndeti seksual dhe riprodhues dhe personat me aftësi të kufizuara trupore - Raporti i vlerësimit të nevojave për shërbime, Hera, fq. 20. Disponueshëm në: <https://bit.ly/3vEHUba>

101 „Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 82/08, 12/09, 53/11 и 150/15.

102 „Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 136/2011

103 <http://iph.mk/wp-content/uploads/2019/08/Nov-tekst-na-AP-usoglasen-so-Sekretarijat-za-zakonodavstvo-11.09.2018.pdf>

104 „Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 101/2019 nga 22.05.2019

105 Veličkovski, R. (2012) Shëndeti seksual dhe riprodhues dhe personat me aftësi të kufizuara trupore - Raporti i vlerësimit të nevojave për shërbime, Hera, fq. 61-62.

106 Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, nenet 12 (4) dhe 23 (1) (b) dhe (c) dhe raporti i Referuesit Special për drejtat e secilit për të gëzuar standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit fizik dhe shpirtëror, E/CN 4/2005/51, paragrafët 9 dhe 12.

107 Poposka Zh. (2018) Interpretues i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara të Kombeve të Bashkuara, Polio Plus - Shkup.

108 Komenti i Përgjithshëm nr. 2 i Komisionit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Disponueshëm në: <https://bit.ly/3npFMjX>

109 Petrovska, N. dhe Avramovski, D. (2021) Qasja juridike, financiare dhe fizike në drejtësi në gjykatat themelore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Të gjithë për gjykim të drejtë.

110 Committee on the Rights of Persons with Disabilities (2018) Concluding observations on the initial report of the former Yugoslav Republic of Macedonia.

111 Instituti për të Drejtat e Njeriut (2020) Gjendja e të Drejtave të Njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut, fq. 8. Disponueshëm në: <https://bit.ly/3pzATYc>

112 Jovanovska, B. (2020) Fuqizimi ligjor në komunitet në procesin e deinstitutionalizimit: raport. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.

113 Koçoska E., Jovanovska, B., Ortakovski T., Stanojkovska-Trajkovska, N., Georgievska, S. (2021) Analiza e gjendjes për çështjen e aftësisë së kufizuar në R. e Maqedonisë së Veriut, UNICEF (në version pune).

Në aspekt të dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, Komiteti i KDPAK në pasqyrimet konkluduese për shtetin¹¹⁴, potencon se: politikat dhe programet nacionale gjinore nuk e përfshijnë çështjen e aftësive të kufizuara; ka mungesë të masave të veçanta për mbrojtjen e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara nga dhuna me bazë gjinore, veçanërisht atyre me aftësi të kufizuara psikologjike dhe/ose me aftësi të kufizuara intelektuale; ka një qasje të dobët në shërbimet e zakonshme dhe adaptimin e arsyeshëm të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, veçanërisht atyre me aftësi të kufizuara psikosociale dhe/ose me aftësi të kufizuara intelektuale; ka mungesë të lejueshmërisë së ligjeve në raport me qasjen në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara dhe mungesën e legjislatives për veprat e urrejtjes në lidhje me aftësitë e kufizuara.

Në këtë linjë, Komiteti tregon se shteti duhet: të zbatojë hetim për të gjitha supozimet e dhunës dhe keqpërdorimet e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht atyre me aftësi të kufizuara psikosociale dhe/ose me aftësi të kufizuara intelektuale dhe arsytet e dyshimita të vdekjes së shfrytëzuesve të institucioneve; ta rishqyrtojë legjislacionin dhe politikat ekzistuese për të shtuar mjetet dhe sanksionet juridike të cilat parandalojnë format e ndryshme të dhunës, keqpërdorimit dhe trajtimit të keq në sferat publike dhe private kundër personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara psikosociale dhe/ose fëmijëve me aftësi të kufizuara intelektuale; të sigurojë trajnime për personelin dhe punëtorët në strehimoret, që të qasen në aftësitë e kufizuara sipas të drejtave të njeriut; të sigurojë se strehimoret e viktimave të dhunës dhe shërbimet e tyre janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara; të ndërmarrë masa për të ndryshuar Kodin Penal, me qëllim krimet ndaj personave me aftësi të kufizuara të shihen si vepra nga urrejtja; të ndërmarrë masa për t'u siguruar se të gjithë personat me aftësi të kufizuara kanë qasje në drejtësi dhe se informatat dhe komunikimi janë në format të qasshëm; të përfshihen masa të posaçme për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara në legjislacionin ekzistues, të përfshihen të drejtat e tyre në politikat dhe programet gjinore dhe të promovohen veprimet afirmative me qëllim të avancimit të të drejtave të tyre; zh) të implementojë masa efektive ligjore, politike dhe praktike me qëllim të ballafaqimit me dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara; t'i ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për të rritur qasjen në shërbimet e rregullta dhe përshtatjen e arsyeshme të të gjitha grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara; të sigurojë një inkuadrim të organizatave të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në zhvillimin, implementimin dhe përcjelljen e shërbimeve të këtylla.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Për të siguruar informata relevante dhe të besueshme, si hulumtim i parë i këtij lloji në vend, hulumtimi është zbatuar sipas disa metodave dhe mjeteve kualitative hulumtuese. U bë një desk-analizë e dokumenteve, politikave, ligjeve dhe literaturës tjetër në sferën e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, si dhe të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, me fokus te gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara. Me qëllim që të depërtohet më thellë në gjendjen dhe nevojat e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara gjatë analizës është marrë parasysh edhe konteksti nacional dhe lokal, si dhe politikat nacionale dhe legjislacioni të orientuara drejt personave me aftësi të kufizuara, me theks ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara dhe parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje.

Krahas kornizës juridike, analiza ka për qëllim që t'i prezantojë perceptimet e atyre që punojnë në krijimin e politikave dhe praktikave dhe atyre që i implementojnë në kontakt direkt me shfrytëzuesit - gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, si dhe konstatimet e vetë grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara. Për këtë qëllim, të dhënat ishin mbledhur përmes:

1. Kërkesave për qasje në informatat që ishin dërguar deri te institucionet dhe organizatat relevante të cilat punojnë në sferën e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje;
2. Pyetësorëve online që u dërguan palëve të interesuara në nivel qendror dhe lokal; dhe
3. Intervistave dhe grupeve të fokusit me gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara.

MBLEDHJA E TË DHËNAVE DHE EKZEMPLARI

Kërkesa për qasje në informatat me karakter publik¹¹⁵

Një prej metodave të zbatimit të hulumtimit ishte mbledhja e të dhënave përmes parashtrimit të kërkesave për qasje të lirë në informata, nëpër institucionet dhe entet e identifikuar gjatë hartëzimit të faktorëve relevantë në lidhje me problemin e diskriminimit dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara. Kërkesat për qasje të lirë në informatat u parashtruan në:

- 22 IP Qendra Ndërkomunale për punë sociale (IPQNPS) edhe atë në Shkup, Strumicë, Manastir, Veles, Tetovë, Ohër, Shtip, Koçan, Berovë, Makedonski Brod, Gjevgjeli, Gostivar, Dibër, Dellçevë, Kumanovë, Kriva Pallankë, Kavadar, Negotinë, Prilep, Radovish, Strugë dhe Sveti Nikollë;
- Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale;
- IP Enti special - Demir Kapi;
- IP Enti Special - Banja Bansko;
- IPSH Spitali Psikiatrik - Demir Hisar;

¹¹⁴ CRPD/C/MKD/CO/1. Disponueshëm në: <https://bit.ly/3bPHPZh>

¹¹⁵ ANEKS 3.

- IPSH Spitali Psikiatrik - Shkup;
- Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Prokurorinë Publike - Shkup;
- Avokatin e Popullit; dhe
- 10 organizata qytetare që ofrojnë servis dhe shërbime për gratë viktime të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje: Shoqata maqedonase e juristëve të rinj, "Florens Najtingel" - Kumanovë, SHG Sveti Nikollë, Fronti Subverziv, Rrjeti Nacional kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, Këshilli nacional për barazi gjinore, Skaj Plus - Strumicë, SHG e Qytetit të Shkupit, Qendra e krizave "Nadezh" dhe HERA - Qendra e parë familjare.

Kërkesës iu përgjigjën:

- 14 IPQMPS (Berovë116, Manastir117, Veles118, Gjevgjeli119, Dibër120, Kavadar121, Koçan122, Kumanovë123, Makedonski Brod124, Negotinë125, Prilep126, Radovish127, Qyteti i Shkupit128 dhe Tetovë129);
- IPSH Spitali Psikiatrik - Shkup 130;
- Enti Special - Banja Bansko 131;
- Enti special - Demir Kapi 132;
- Ministria e Punëve të Brendshme 133;
- Avokati i Popullit 134;
- Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut135,
- Shoqata maqedonase e juristëve të rinj 136; dhe
- HERA - Qendra e parë familjare 137.

116 Numri arkivor: 03-300/2 nga 22.07.2021

117 Përgjigje e marrë më 11.08.2021

118 Përgjigje e marrë më 22.07.2021 në formë elektronike

119 Numri arkivor: 03-701/2 nga 27.07.2021

120 Përgjigje e marrë më 22.07.2021

121 Numri arkivor: 21-1252 nga 27.07.2021

122 Numri arkivor: 03-37/1 nga 19.07.2021

123 Numri arkivor: 3239/1 nga 31.08.2021

124 Numri arkivor: 03-137/3 nga 26.07.2021

125 Numri arkivor: 21-370/2 nga 29.07.2021

126 Numri arkivor: 03-970 nga 20.08.2021

127 Përgjigje e marrë më 22.07.2021 në formë elektronike

128 Numri arkivor: 2001-9 nga 09.08.2021

129 Përgjigje e marrë më 28.07.2021 në formë elektronike

130 Numri arkivor 03-891/2 nga 30.07.2021

131 Përgjigje e marrë më 20.07.2021

132 Numri arkivor 03-456/3 nga 10.08.2021

133 Aktvendim nr. 16.1.2-989/1 nga 30.07.2021

134 Përgjigje e marrë më 26.07.2021 në formë elektronike

135 Nr. ark. 03 - 523/2 nga 15.10.2021

136 Përgjigje e marrë më 27.08.2021

137 Përgjigje e marrë më 16.08.2021

Pyetësorët online¹³⁸

Pyetësorët online janë dërguar në Njësinë e Vetëqeverisjes Lokale (NJVL), te anëtarët e Trupit Koordinues për implementimin e Konventës së OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave civile (OC) që punojnë në sferën e parandalimit dhe luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Qëllimi i përdorimit të kësaj forme hulumtuese ishte që të shqyrtohen perceptimet e atyre që punojnë në krijimin e politikave dhe praktikave dhe atyre që i implementojnë përmes kontaktit direkt me shfrytëzueset - gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara.

Për të marrë të dhëna për gjendjen në nivel lokal, pyetësi u dërgua edhe te Koordinatorët për mundësi të barabarta të grave dhe burrave ose personave përgjegjës për punën me personat me aftësi të kufizuara (në komunat ku ka pozita të atilla) në të gjitha komunat e vendit dhe Qytetin e Shkupit (gjithsejtë 81). Përgjigje morëm nga 32 persona të punësuar në 21 NJVL (Gradsko, Aerodrom, Manastir, Bërvenicë, Vallandovë, Vevçani, Vinicë, Gazi Babë, Gjevgjeli, Gjorçe Petrov, Dibër, Dellçevë, Demir Kapi, Kavadar, Karposh, Kisella Vodë, Konçe, Kriva Pallankë, Llozovë, Mavrovë dhe Rostushë, Novaci, Probishtip, Nagoric i Vjetër, Strugë, Tetovë, Qendër, Qendër Zhupë, Çair, Çashkë, Çeshinovë-Oblleshevë dhe Shtip). Nga 32 të përgjigjur, 26 janë Koordinatorë për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, ndërsa 6 kanë pozita të tjera. Pjesa më e madhe e tyre (28) në NJVL punojnë më shumë se 3 vite. Vetëm 6 nga 32 prej tyre janë përgjigjur se punojnë drejtpërdrejtë me persona me aftësi të kufizuara, ndërsa një person është përgjigjur se më parë ka punuar në pozitë të atillë, por ka ndërëruar vendin e punës brenda institucionit.

Pyetësi është dërguar edhe deri te 26 organizata civile (OC) të cilat punojnë në sferën e të drejtave të grave, me fokus në parandalimin dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunën në familje. Përgjigje kanë dorëzuar 13 organizata edhe atë: KHAM Dellçevë, Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut, Polio Plus - lëvizja kundër handikapit, Qendra për hulumtimin dhe krijimin e politikave (CRPM), Qendra e krizave "Nadezh", EHO Organizata edukative-humanitare - Shtip, Shoqata maqedonase e juristëve të rinj, Rrjeti nacional kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, HERA, Unioni - Këshilli nacional për barazi gjinore dhe Organizata e grave - Strumicë.

11 organizatat që u përgjigjën në këtë pyetësor veprojnë në nivel nacional, 1 në nivel lokal, 3 në nivel rajonal, ndërsa një është rrjet nacional. Të gjitha organizatat veprojnë më shumë se 10 vite, respektivisht 7 funksionojnë më shumë se 10 vite, kurse 6 më shumë se 20 vite. Pjesa më e madhe e organizatave që i janë përgjigjur pyetësorit (7) kanë nga 5 deri 10 të punësuar, 4 kanë mbi 10 të punësuar, ndërsa 2 me 1 deri në 5 të punësuar. Vetëm në një organizatë ka të punësuar njerëz me aftësi të kufizuara. Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë grup i synuar i drejtpërdrejtë i punës së 4 prej këtyre organizatave.

Nga 24 anëtarët e Trupit koordinues për implementimin e Konventës së OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara që janë të punësuar në trupat e administratës shtetërore, të cilëve u ishte dërguar pyetësi, janë përgjigjur vetëm 7 persona edhe atë 2 anëtarë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, 2 anëtarë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe nga një anëtarë i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë dhe Sekretariatit për Çështje Evropiane.

138 ANEKS 4 dhe 5


Intervistat dhe grupet e fokusit¹³⁹

Në hulumtim u përfshinë drejtpërdrejt gjithsejtë 75 gra dhe vajza me aftësi të ndryshme të kufizuara - 15 përmes intervistave individuale dhe 60 përmes grupeve të fokusit.

Në aspekt të moshës, 16 gra ishin të moshës 20-29 vjeçare, 16 të moshës 30-39 vjeçare, 18 të moshës 40-49 vjeçare, 18 të moshës 50-59 vjeçare dhe 7 mbi moshën 60 vjeçare.

Në aspekt të aftësive të kufizuara, ishin përfshirë 32 gra dhe vajza me aftësi të kufizuara fizike, 23 gra dhe vajza shurdhe, 11 gra dhe vajza të verbra dhe 9 gra dhe vajza me aftësi të kufizuara intelektuale.

LLOJI I AFTËSISË SË KUFIZUAR




26 e këtyre grave dhe vajzave janë nga Shkupi, kurse të tjerat vijnë nga qytete të tjera të vendit (Manastiri, Strumica, Tetova, Struga, Velesi, Gjevgjelia, Shtipi, Prilepi, Resnja, Ohri dhe Negotina).

7 nga gjithsej 75 e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara janë shqiptare, 8 janë rome, 2 serbe, 1 turke kurse të tjerat janë maqedonase.

16 prej grave dhe vajzave pjesëmarrëse në intervistat dhe grupet e fokusit kanë arsim të lartë, 36 kanë arsim të mesëm, prej të cilave 18 kanë ndjekur shkollën speciale, kurse të tjerat kanë arsim fillor.

25 prej tyre janë të papunë, 11 janë në pension, 2 janë studente, ndërsa të tjerat janë të punësuar.

PUNËSIMI



139 ANEKS 6 dhe 7

Në aspekt të statusit martesor, 26 prej tyre janë të martuara, 6 të divorcuara, 7 janë të veja, kurse të tjerat janë të pamartuara.

Për shkak të pandemisë me virusin Covid-19, një pjesë e intervistave dhe grupeve të fokusit ishin realizuar sy më sy, ndërsa një pjesë përmes mjeteve të komunikimit në internet (Zoom, Viber, WhatsApp). Në fillim të secilës intervistë dhe grupi të fokusit, pjesëmarrëset u informuan se biseda do të incizohet dhe se garantohet fshehtësia e të dhënave, informatave dhe deklarimeve të tyre. Për shkak të ndjeshmërisë së tematikës dhe nevojës për mbrojtjen e të dhënave, në raport nuk janë shënuar të dhënat personale, ndërsa citatet dhe shembujt nuk identifikojnë pjesëmarrëset. Identiteti i pjesëmarrëseve në hulumtim është i njohur vetëm për ekipin hulumtues, ndërsa materialet e incizuara janë të mbrojtura në mënyrë përkatëse dhe në to ka qasje vetëm ekipi hulumtues.

ANALIZA E TË DHËNAVE

Në pajtim me metodat e mbledhjes së të dhënave dhe faktorëve të ndryshëm që janë përfshirë në hulumtim, analiza e të dhënave është realizuar në tre nivele, respektivisht përmes tri kornizave të ndryshme të kodimit. Pyetjet e kërkesave për informata me karakter publik dhe pyetësorët online ishin të mbyllur dhe koduar sipas grupeve të përcaktuara të pyetjeve, ndërsa pyetjet e intervistave dhe grupeve të fokusit ishin kryesisht pyetje që më pas ishin koduar dhe analizuar në mënyrë kuantitative, përmes një matrice më të gjerë dhe me transmetimin direkt të civateve, për të përfshirë dëshmi dhe deklarata më të besueshme nga gratë dhe vajzat që kanë marrë pjesë drejtpërdrejt në këtë hulumtim. Duke marrë parasysh ndjeshmërinë e tematikës, anonimiteti ishte i garantuar për të gjitha pjesëmarrëset dhe pjesëmarrësit në hulumtim, identiteti i të cilëve dihet vetëm nga ekipi hulumtues.

KUFIZIMET NË HULUMTIM

Meqë bëhet fjalë për një hulumtim të parë të këtij lloji për këtë tematikë në vend, ka mungesë të literaturës relevante nacionale e cila mund të shërbejë si bazë dhe referencë në hulumtim. Për këtë arsye, hipoteza ishte vendosur në konstatimet e hetimit në vend për dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje ndaj grave dhe vajzave, me të cilën ishin përfshirë të dhënat për intensitetin e kësaj dukurie, si dhe për perceptimet e grave dhe vajzave në aspekt të dhunës në vendin tonë. Në hulumtimet dhe analizat të cilat shërbyen si bazë për hulumtimin ishin të përfshira edhe konstatimet për dhunë ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara.

Një prej konstatimeve kryesore nga hulumtimet paraprake për dhunën ndaj grave në vendin tonë, është se dhuna kryesisht po heshtet dhe/ose nuk shihet, dukuri kjo që shfaqet edhe më shumë te gratë me aftësi të kufizuara. Kjo ishte një sfidë e veçantë për hulumtim, për faktin se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara e kishin më të vështirë që të flasin me përvojat e tyre personale në grupe më të mëdha. Për këtë arsye, hulumtueset vendosën që ta rrisin numrin e intervistave të planifikuara individuale, ndërsa ta zvogëlojnë numrin e grupeve të fokusit që ishin paraparë me planin hulumtues, me qëllim që t'u mundësohet pjesëmarrëseve një atmosferë më intime dhe më të besueshme.

Përfundimisht, rrjedha e hulumtimit u rëndua meqë realizohej në kohë pandemie me COVID-19. Me qëllim të mbrojtjes nga virusi, ekipi hulumtues vendosi që pjesën më të madhe të

intervistave dhe grupeve të fokusit t'i realizojë përmes internetit, përmes mjeteve të komunikimit Zoom, Viber, WhatsApp, Skype, etj. Numri i vogël i intervistave të cilat nuk kishte mundësi që të realizohen përmes internetit u realizuan me prani fizike, duke respektuar të gjitha masat dhe protokollet për mbrojtje nga virusi KOVID-19, respektivisht në hapësira të hapura, me distancë të mjaftueshme të pjesëmarrëseve, me mjete dezinfektuese dhe maska.

KONSTATIMET E HULUMTIMIT

TË KUPTUARIT DHE NJOHJA E DISKRIMINIMIT DHE DHUNËS NGA GRATË DHE VAJZAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Të gjitha gratë dhe vajzat që morën pjesë në intervistat dhe grupet e fokusit (gjithsej 75) dinin të theksojnë ndonjë lloj të dhunës, kurse pjesa më e madhe e tyre dallojnë diskriminimin dhe dhunën. Dhuna fizike dominon si lloji më i njohur i dhunës, por ka pjesëmarrëse të cilat njohin edhe dhunën ekonomike dhe psikologjike. Diskriminimi më së shumti ndodh në institucionet dhe në vendet e punës. Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara shpeshherë ballafaqohen me diskriminim gjatë punësimit (“*Na duhet ndonjë më e përfaqësueshme*”¹⁴⁰), në sistemin arsimor (njëres nga pjesëmarrëset profesori në fakultet i kishte thënë: “*Ç’të duhet fakulteti, ti je person me aftësi të kufizuara, ato që janë normalë nuk mund të gjejnë punë, e lere më ti me aftësi të kufizuara*”¹⁴¹), vendet e punës (zakonisht punojnë në kompani mbrojtëse, pa dallim të arsimimit dhe kualifikimeve) etj.

Megjithatë, disa lloje të dhunës nuk njihen madje edhe kur janë përjetuar personalisht, si për shembull, ndjekja, shantazhi, kushtëzimi etj. Njëra pjesëmarrëse tregoi se si ish-partneri e kishte ndaluar që të shoqërohet me miqtë, e kishte ndjekur që të shoh se ku shkon dhe kishte ndikuar në vendimin e saj për abort, por ajo atë e sheh vetëm në prizmin e dashurisë dhe përkushtimit të tij ndaj lidhjes së tyre, e nuk e sheh si keqtrajtim. Gjithashtu, edhe sjellja e pahijshme në vende publike kuptohet si diçka normale dhe e zakonshme dhe nuk konsiderohet si lloj i keqtrajtimit ose dhunës.

Edhe pse numri më i madh i pjesëmarrësve njohin ndonjë lloj të dhunës dhe bëjnë dallim ndërmjet dhunës dhe diskriminimit, ato nuk janë të njoftuara me Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, e as edhe me përkufizimet, nocionet dhe zgjidhjet e tjera ligjore (“*Albeizmi? Ajo është një sëmundje e rëndë, kurë dergjesh*”¹⁴²).

PERCEPTIMET E GRAVE DHE VAJZAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA PËR DHUNËN DHE ROLET GJINORE

Për shqyrtimin e perceptimeve në aspekt të dhunës dhe ekzistimit të stereotipave dhe paragjyqimeve në aspekt të roleve gjinore, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara që marrin pjesë në hulumtim, ishin pyetur nëse pajtohen me disa deklaramë që ishin formuluar që të pasqyrojnë mendime dhe role paragjyquese.

Konstatimi i parë për të cilën pjesëmarrëset e dhanë mendimin e tyre ishte “**Burri është ai që duhet të jetë kryesori në familje kur sillen vendimet**”. Në aspekt të këtij deklaramë, 8 (nga gjithsej 75) të pjesëmarrësve u pajtuan, ndërsa të gjitha të tjerat deklaruan se burri dhe gruaja duhet të jenë të barabartë dhe të përbashkët për të sjellë vendime brenda familjes. Ato që u pajtuan me deklaramë se burrin e shohin si kreu i familjes, ai që sjell para dhe kujdeset për të tjerët (“*gruaja duhet ta dëgjojë burrin, duhet ta respektojë... burri udhëheq me paratë dhe duhet t’i blej asaj*”¹⁴³). Njëra prej pjesëmarrësve potencoi se në familjet shqip-tare, situata është pak më ndryshe, respektivisht se jo vetëm burri dhe gruaja i sjellin vendi-

met¹⁴⁴, ndërsa një pjesëmarrëse tjetër potencoi se pafuqia ekonomike e grave me aftësi të kufizuara i vë në pozitë vartëse brenda familjes¹⁴⁵.

Ende dominon perceptimi se gratë e provokojnë dhunën, respektivisht faji në masë të madhe gjendet te vetë viktimat. Madje 40 (prej 75, respektivisht 54%) e të intervistuarave janë përgjigjur se pajtohen me deklaramë se “**Shpeshherë gratë vetë janë fajtores për dhunën**”. Ato e shohin fajin e dhunës në veshjen dhe sjelljen provokuese (“*xhup në kokë, prapanicë lakuriqe*”¹⁴⁶, “*sa është paraqitur lakuriqësia, ndonjëherë është më mirë të mos shikosh*”¹⁴⁷), kundërshtim i burrit (“*gruaja din të flas shumë, gjithmonë diçka nuk i përshtatet*”¹⁴⁸, “*nëse dikush e kërkon, do ta gjejë*”¹⁴⁹), shkaktimi i xhelozisë te burri (tradhtia si arsye për dhunën fizike¹⁵⁰, citimi i frazave si “*Gruan rrihe 3 herë në ditë, nëse nuk e din përse e rreh, do ta dijë ajo*”¹⁵¹) dhe të ngjashme.

Është i dukshëm edhe dallimi i gjeneratave gjatë të menduarit në aspekt të këtij deklaramë, respektivisht edhe pse pjesa më e madhe e të intervistuarave konsiderojnë se vajzat më të reja që vishen në mënyrë provokuese e shkaktojnë dhunën, vajzat dhe gratë më të reja e kundërshtojnë këtë mendim (për shembull, një vajzë e shurdhër nuk ndihet fajtores “*sepse dikush ka problem me stimulimet*”¹⁵²).

Në raport me deklaramët se “**Dhuna në shtëpi është punë private dhe duhet të zgjidhet brenda familjes**” dhe “**Nuk është punë e madhe nëse burri e godet gruan në afekt ose nervozë**” asnjëra nga të intervistuarat nuk u pajtua me këtë. Vetëm disa prej tyre potencuan se paraqitja e dhunës në familje varet nga rëndësia dhe serioziteti i debatit, respektivisht se debatet më të vogla duhet të zgjidhen brenda shtëpisë dhe se në ato momente është mirë që njëri të lëshoj pe (“*Nëse burri bërtet, ti hesht, do të vijë koha kur do t’i këndosh*”¹⁵³). Gjithashtu disa nga të intervistuarat përsëri potencuan se, edhe pse nuk duhet, te ne më së shpeshti dhuna mbetet brenda katër mureve për shkak të mosbesimit ndaj institucioneve dhe jo efikasitetit të tyre për të reaguar në rastet e dhunës në familje.

Kishim mendime të ndara në aspekt të deklaramë në vijim - “**Gruaja duhet ta kënaqë burrin madje edhe kur ajo nuk ka dëshirë për intimitet**”. 30 të intervistuarat nuk u pajtuan me këtë deklaramë (“*java ka 7 ditë, nuk do të prishet bota*”¹⁵⁴, “*nëse është ashtu, unë do të pres kur të jetë lodhur, për t’u hakmarrë, revansh 1:1*”¹⁵⁵), ndërsa të tjerat u pajtuan (“*nëse e refuzon, ai menjëherë do të dyshojë se ka qenë me dikë tjetër*”¹⁵⁶, “*edhe gruaja është e obliguar që t’i bëjë detyrat... ose edhe ajo ka kapur diçka anash edhe ajo dhe nuk e përfill burrin*”¹⁵⁷, “*nëse e refuzoj, do të hidhërohet*”¹⁵⁸).

144 Grupi i fokusit 10.09.2021

145 Intervistë 2 (17.08.2021)

146 Grupi i fokusit 24.07.2021 (1)

147 Grupi i fokusit 24.07.2021 (1)

148 Intervistë 14 (07.09.2021)

149 Grupi i fokusit 24.07.2021 (1)

150 Intervistë 2 (17.08.2021)

151 Grupi i fokusit 10.09.2021

152 Grupi i fokusit 24.07.2021 (2)

153 Grupi i fokusit 10.09.2021

154 Grupi i fokusit 24.07.2021(2)

155 Grupi i fokusit 24.08.2021 (2)

156 Intervistë 4 (24.08.2021)

157 Grupi i fokusit 24.07.2021 (1)

158 Grupi i fokusit 24.07.2021 (2)

140 Intervistë 15 (07.09.2021)

141 Grupi i fokusit 10.09.2021.

142 Grupi i fokusit 24.07.2021(1)

143 Grupi i fokusit 31.08.2021.

Pothuajse të gjitha gratë nuk u pajtuan me deklarinimin “**Gruaja me aftësi të kufizuara ka më shumë gjasa që të mbetet me një partner të dhunshëm se sa gratë tjera**”. Ato potencuan se ka më shumë rëndësi stabiliteti ekonomik dhe përkrahja e familjes se sa aftësitë e kufizuara. Gjithashtu, u potencua edhe roli i familjes së viktimës për fuqizimin e saj dhe ndërtimin e vetëbesimit të saj gjatë zhvillimit dhe fëmijërisë (“*prindërit i mësojnë fëmijët se nuk mundën asgjë vetë, nëse ka prind të tillë, ka më shumë gjasa që të mbetet në një lidhje të dhunshme*”¹⁵⁹). Gjithashtu, asnjë prej të intervistuarave nuk u pajtua se “**Gruaja duhet të durojë për shkak të fëmijëve**”.

Deklarimi i fundit përsëri kishte të bëjë me perceptimin e viktimave, respektivisht “**Gratë që thonë se kanë qenë të keqpërdorura, shpesh herë sajojnë për vëmendje**”. Në aspekt të këtij deklarimi, përsëri kishim mendime të ndara. 13 (nga gjithsej 75) të intervistuarat u pajtuan me deklarinimin, ndërsa të tjerat nuk u pajtuan ose nuk u përgjigjën. Prapë se prapë, ato që u pajtuan me deklarinimin, potencuan se ajo ndodh shumë rrallë dhe se në shumicën e rasteve, gratë që kanë qenë viktimë të dhunës nuk gënjehen.

PËRVOJAT ME DISKRIMINIMIN DHE DHUNËN NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Përvojat me diskriminimin në jetën e përditshme

Të gjitha gratë që morën pjesë në hulumtim (gjithsej 75) u përgjigjën në mënyrë pohuese në lidhje me çështjen nëse ballafaqohen me vështirësi gjatë jetës së përditshme. Pjesa më e madhe e tyre në masë të madhe varet nga anëtarët e familjes të cilat u ndihmojnë çdo ditë, ndërsa një pjesë e vogël e tyre kanë edhe asistentë personal. Vështirësitë me të cilat ballafaqohen gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, varet nga lloji i aftësive të kufizuara që e kanë.

Kështu, për gratë dhe vajzat me shikim të dëmtuar, si pengesë më të madhe i kanë barrierat gjatë lëvizjes, respektivisht mospërshtatja e rrugëve dhe sipërfaqeve publike, transportit publik, trotualet e prishura, etj. Gjithashtu, të intervistuarat që kanë shikim të dëmtuar e identifikojnë edhe problemin se nuk ka kuadër të trajnuar nëpër institucione dhe nuk kanë shprehur të komunikimit me personat e verbër, andaj më së shpeshti nuk u drejtohen atyre por shoqëruesve të tyre, me çka të intervistuarat ndihen të nënçmuara dhe diskriminuara, respektivisht sikur të jenë të padukshme dhe parëndësishme. Një pjesë shumë e vogël e tyre kanë mundësi që të funksionojnë në mënyrë të pavarur, në masë të madhe për shkak të mungesës së programeve të edukimit dhe integritetit të personave të verbër dhe për këtë edhe varen nga të afërmit, respektivisht anëtarët femra në familje, nënat dhe vajzat, që në pjesën më të madhe të kohës kujdesen dhe i shoqërojnë gjatë përditshmërisë.

Për gratë dhe vajzat me dëgjim të dëmtuar, pengesat më të mëdha për funksionim normal në shoqëri janë problemet me komunikimin, respektivisht mospasjen e interpretuesit në institucione, spitale dhe ambulanca, ndërmarrjet publike dhe ngjashëm, mosqasja në përmbajtjet e TV-së për shkak të sinkronizimit të shumicës së përmbajtjeve, si dhe procedurat e gjata për të gjetur një interpretues. Problem jashtëzakonisht i veçantë për gratë dhe vajzat me dëgjim të dëmtuar janë edhe diskriminimi në procesin arsimor dhe punësimin. Gratë dhe vajzat me dëgjim të dëmtuar nuk mund të marrin arsim kualitativ për shkak të mungesës së interpretuesve,

ndërsa kanë edhe problem me shkrim-leximin, që në mënyrë plotësuese e komplikon problemin e tyre të komunikimit me rrethin. Për gratë dhe vajzat e shurdha, më së shumti rëndësi ka përkrahja e familjes - “*Gjithçka lidhet me ndihmën e nënës time*”¹⁶⁰, “*Gjithmonë e marr me mua nënën time kur shkoj te mjeku amë*”¹⁶¹, ndërsa shurdhimi është bërë problem i ekzistencës së tyre - “*I kemi lodhur edhe fëmijët edhe të tjerët për të na ndihmuar*”¹⁶².

Për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara trupore, problem më i madh paraqet qasja, që dukshëm e kufizon lëvizjen e tyre. Edhe pse vërehet një përparim i institucioneve në aspekt të krijimit të qasjes gjatë viteve të kaluara, ajo prapë se prapë nuk është e plotë. Shumë institucione kanë qasje nga jashtë, respektivisht ka shteg për personat me aftësi të kufizuara, por në brendësi nuk ka qasje nëpër tualete dhe/ose nuk ka ashensor. Njëra nga të intervistuarat tregoi se pengesat aftësitë e kufizuara janë të dukshme kur ka barriera arkitektonike dhe kur duhet të kërkohet ndihmë, e që kontribuon për zhvillimin e paragjytimeve. Një e intervistuar me aftësi të kufizuara fizike e theksoi edhe shembullin kur ishte në proces të divorcit se tre veta është dashur që ta dërgojnë në gjykatë sepse nuk kishte pasur kurrfarë qasjeje. Një tjetër theksoi se madje edhe parqet kanë shkallë dhe pjesë jo të qasshme, andaj për të shkuar në park ajo duhet të kërkojë shoqërim. Nëse nuk do të ekzistonin këto barriera ata do të ishin të barabarta në shoqëri me të tjerët. Gjithashtu, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara e potencuan problemin me paragjykimet e rrethit që edhe kontribuon për përjashtimin e tyre nga shoqëria. Nga grupi i fokusit të grave dhe vajzave me paralizë cerebrale¹⁶³ doli edhe konkluzioni se prindërit që janë vazhdimisht me ta, ndajnë një barrë dhe lodhje të madhe, që reflektohet edhe në kualitetin, aktivitetet dhe avancimet në jetën e tyre. Varësia nga kujdesi i të afërmeve dhe familjes për të funksionuar në jetën e përditshme, respektivisht fakti se ato shumë rrallë janë vetëm, e kjo për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara paraqet pengesë për zhvillimin e jetës së tyre seksuale. Prindërit më së shpeshti e shmangin temën e arsimit seksual dhe asistentëve seksual, kështu duke u shkurtuar funksionimin formal të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, në atë segment jetësor.

Vetëm njëra nga të intervistuarat e potencoi interseksionalitetin, respektivisht ekzistimin e më shumë karakteristikave të identitetit që shfaqen si një efekt vështirësues gjatë diskriminimit¹⁶⁴, ndërsa disa të tjera potencuan se para se gjithash, ekziston edhe diskriminimi institucional dhe sistematik (p.sh. në repartet gjinekologjike ku karriget për kontroll nuk janë të përshtatura për gratë me aftësi të kufizuara¹⁶⁵).

Përvojat me dhunën dhe keqtrajtimin

Konstatimet e hulumtimeve treguan se dhuna është e pranishme në jetët e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara. Pjesa më e madhe e të intervistuarave (75) kanë përjetuar ndonjë lloj të dhunës dhe/ose kanë qenë dëshmitare të dhunës. 33 e të intervistuarave (44%) thanë se drejtpërdrejtë kanë përjetuar ndonjë lloj të dhunës, 14 prej 15 prej tyre, ndërsa 26 (35%) kanë qenë dëshmitare të dhunës. Përvojat dhe dëshmitë për dhunën dhe keqtrajtimin janë në mjedis të ndryshme, duke filluar nga familja, vendi i punës, institucionet e deri te sektorët publik.

160 Grupi i fokusit 24.07.2021 (2)

161 Grupi i fokusit 24.07.2021 (2)

162 Grupi i fokusit 24.07.2021 (2)

163 22.07.2021

164 Intervistë 15 (07.09.2021)

165 Intervistë 14 (07.09.2021)

Pjesa më e madhe e kryerësve të dhunës dhe keqtrajtimit janë në familje, respektivisht të afërmit dhe familjarët. Përvojat e këtilla fillojnë me ofendime dhe nënçmime, e deri te sulmet fizike me armë të ftohta dhe gjuajtjes me gjësende. Përvojat personale me format më serioze të dhunës ishin theksuar vetëm gjatë intervistave, ndërsa në grupet e fokusit si forma të dhunës dhe keqtrajtimit që i kishin përjetuar gratë me aftësi të kufizuara dhe që i identifikojnë, më së shpeshti ishin rastet e përndjekjes nga të panjohurit, keqtrajtime në hapësira publike, keqtrajtime në vendet e punës, dhuna nëpër institucione për persona me aftësi të kufizuara etj. Kjo përsëri na tregon faktin se për dhunën ende nuk flitet në publik dhe se ekziston frika nga gjykimi i rrethit.

Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara ballafaqohen edhe me përqeshje dhe nënçmime që nga mosha e hershme, shpesh herë duke filluar në familje, e më pas edhe në rrethin ku jetojnë. 9 prej 15 grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara që janë intervistuar, na thanë se që nga fëmijëria kanë përjetuar ofendime dhe nënçmime, më së shumti nga babai, që në disa raste edhe e kishte akuzuar nënën se ka lindur fëmijë me aftësi të kufizuara. Nënçmimet e prindërve më së shpeshti në aspekt të asaj se gratë me aftësi të kufizuara nuk mundën të bëjnë asgjë vetëm, se janë të paafta, jo të hijshme për t'u shikuar, shoqëruar, etj. ("Shih se si je" ¹⁶⁶), ndërsa brenda rrethit shpesh herë përjetojnë edhe keqardhje ("Shihe, për gjynah" ¹⁶⁷), si dhe fjalë ofenduese ("Ti ke ngecur mendërisht, nuk kupton asgjë" ¹⁶⁸). Për shkak të perceptimit të rrethit dhe familjes se personat me aftësi të kufizuara janë të paaftë, ata më së shpeshti, që nga fëmijëria janë të izoluar në shtëpi, nuk kanë mundësi që të lëvizin vetë dhe tërë jetën varen nga përkujdesja e të afërmeve.

Për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, nëna është ajo që më së shpeshti e ka rolin më të rëndësishëm për ndihmë dhe përkrahje në familje. Pyetjes se kujt do t'i tregonin së pari nëse do të përjetonin ndonjë lloj të dhunës, pothuaj se gjysma e të intervistuarave (gjithsej 75) u përgjigjen se ajo është nëna e tyre. Shtatë të intervistuarave u përgjigjen se së pari do t'i tregonin shoqes së tyre të afërt, ndërsa tri u përgjigjen se së pari do t'i tregonin motrës ose vëllait. Katër prej tyre që morën pjesë në intervistë (gjithsej 15) thanë se nuk do t'i tregonin askujt sepse nuk kanë asnjë të afërm të familjes ose nuk kanë përkrahje nga prindërit (njëra prej tyre i citoi edhe fjalët e babait të saj: "Nëse dëgjo se ke bërë diçka që do të na turpëroj, ta dish se ne në shtëpi do të dënojmë" ¹⁶⁹). Prapë se prapë, edhe ato që janë viktimat të dhunës e që marrin guximin që të tregojnë, shpeshherë hasin në paragjykime të rrethit dhe të afërmeve. Shpeshherë, pikërisht nënat e tyre të cilat edhe vetë kanë qenë viktimat të dhunës i kanë këshilluar që të heshtin "që të mos qeshin të tjerët" ¹⁷⁰ dhe të durojnë që të mos mbeten të vetme ("burri është ombrella e shtëpisë" ¹⁷¹). Për një numër më të vogël të të intervistuarave, asistentët dhe personat përgjegjës të organizatave dhe unioneve ku janë anëtare, janë personat me të cilët do ta ndanin lajmin nëse do të përjetonin dhunë ose keqtrajtime.

Komentet, thirrjet, fishkëllimat, ndjekjet e pahijshme në hapësirat publike perceptohen si diçka normale që e përjeton secila grua dhe femër. Këto lloje të shqetësimit seksual nuk janë shumë prezentë te gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara për shkak të faktit që ato shumë rrallë lëvizin vetëm në vende publike, por më së shpeshti janë në shoqërimin e prindërve,

166 Intervistë 9 (01.09.2021)

167 Grupi i fokusit 03.09.2021 (2)

168 Grupi i fokusit 03.09.2021 (1)

169 Intervistë 2 (17.08.2021)

170 Intervistë 13 (07.09.2021)

171 Intervistë 15 (07.09.2021)

kujdestarëve, asistentëve, miqve, etj. Gjashtë prej të intervistuarave na thanë se kanë qenë të ndjekura nga ndonjë person i panjohur që në mënyrë shtesë i ka frikësuar që të lëvizin vetëm, duke kërkuar mënyra që gjithmonë të jenë me dikë tjetër, që dukshëm e ka kufizuar lirinë e tyre të lëvizjes ("Kur nuk dëgjon, nuk e din se me çfarë qëllimi ju vjen dikush nga mbrapa" ¹⁷²)

Për përvojat me dhunën fizike folën dhe 15 të intervistuarave (nga gjithsej 75). Kryerësit e dhunës ishin baballarët dhe partnerët e tanishëm dhe të mëparshëm. Dhunuesit zakonisht kanë qenë nën ndikimin e alkoolit, ndërsa viktimat e duronin dhunën kryesisht për shkak të mospasjes së përkrahjes nga familja dhe institucionet dhe mospasjen e pavarësisë ekonomike që të mund të largohen. Njëra nga të intervistuarat ka duruar dhunë fizike, psikologjike dhe ekonomike nga bashkëshorti, më shumë se 40 vjet sepse nuk ka qenë ekonomisht stabile dhe nuk ka marrë përkrahjen e të afërmeve (vëllai i saj i ishte kërcënuar: "Nëse bën ndonjë sherr, un do të godas me satër" ¹⁷³). Një tjetër e intervistuar ka treguar për torturën e gjatë psikike dhe fizike nga ish bashkëshorti e cila zgjatë edhe në ditët e sotme (e divorcuar nga viti 2008, ai edhe e përcjell dhe i kërcënohet). Një tjetër tregonte si ka ndodhur që ajo të thirr ndihmën e shpejtë, të gënjejë se ka dhimbje vetëm që të qëndrojë në spital e jo me bashkëshortin. Shpeshherë viktimat e dhunës e marrin fajin për dhunën, sikurse që sqaroi njëra nga të intervistuarat se gjatë ditëve të caktuara të muajit (në SPM) ajo është shumë më nervoze, e që gjatë bisedës tregon se bashkëshorti pi, vjen në shtëpi vonë dhe e dënon se pse nuk e pret me buzëqeshje (sepse është në "ato" ditë të muajit), ndërsa në të kaluarën edhe e kishte tradhtuar.

Format më të rënda të dhunës fizike që i kanë përjetuar disa nga të intervistuarat përfshijnë edhe gisht të thyer, hundë të kafshuar, kaçavide të ngulur, goditje me gjësende, si dhe të mavijosuara dhe prerje. Në pesë incidentet më serioze ka pasur edhe fëmijë të përfshirë si dëshmitarë.

Dhuna fizike pothuajse gjithmonë është e shoqëruar me dhunë psikologjike dhe ekonomike. Njëra nga të intervistuarat tregoi se si pas aksidentit të komunikacionit ku kishte mbetur e palëvizshme, babai ia kishte marrë pagesën e dëmshpërblimit dhe e kishte shpenzuar në alkool dhe bixhoz ¹⁷⁴. Disa të tjera na thanë se burrat e dhunshëm ua merrnin pagat, me çka ato në tërësi kishin mbetur të varura nga ta duke mos pasur mundësi për t'u larguar.

Të intervistuarat që kishin qëndruar në institucione ose familje për përkujdesje gjatë një periudhe të caktuar kohore, treguan për atmosferën tmerruese të dhunës, nënçmimit dhe moskujdesit ("të lënë si qentë" ¹⁷⁵). Në këto institucione kanë përjetuar dhunë fizike nga ana e personelit dhe të tjerët aty, anashkalim (nuk mësojnë asgjë dhe nuk punohet për zhvillimin e tyre), rregullimin me barëra (njëra prej tyre tha se edhe në ushqimet u kanë hedhur barëra nga të cilat flinin me ditë të tëra), si dhe keqtrajtime seksuale (prekje të pahijshme, detyrim për tu zhveshur para të tjerëve, etj.). Njëra nga të intervistuarat që kishte marrë pjesë në grupin e fokusit, na tregoi për dhunën që e kishte përjetuar në familjen për përkujdesje, nuk i kanë mundësuar kujdesin dhe trajtimin e nevojshëm, e kishin rrahur dhe goditur me gjësende (holluese, karrige, etj.).

172 Grupi i fokusit 24.07.2021 (2)

173 Intervistë 2 (17.08.2021)

174 Intervistë 13 (07.09.2021)

175 Grupi i fokusit 31.08.2021

Pasoja e dhunës dhe keqtrajtimit

Pasoja që i kanë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, nga dhuna dhe/ose keqtrajtimi i përjetuar janë të llojlojshme, varësisht nga dhuna dhe/ose keqtrajtimi i kryerësit.

Sic është përshkruar më lartë, të intervistuarat që kanë përjetuar keqtrajtime në formë të fjalëve ose ndjekjes në hapësira publike, ndjenjë një frikë për të lëvizur vetëm, sidomos në orët e vonshme dhe në vendet ku nuk ka frekuencë më të madhe të njerëzve. Me këtë, kufizohet liria e tyre e lëvizjes dhe krijohet një presion shtesë për njerëzit që kujdesen për ta, në mënyrë që të mos i lënë të vetme.

Gratë me aftësi të kufizuara që janë nënçmuar dhe ofenduar në familje, ndjejnë pasoja emocionale dhe psikologjike. Ato më së shpeshti kanë nivel të ulët të vetëbesimit, ndjenjës së padëshirueshme, nënçmimit, si dhe mosbesimit ndaj rrethit të tyre.

Gratë me aftësi të kufizuara të cilat kanë qenë viktime të dhunës fizike kanë pasoja afatgjate psikologjike dhe emocionale në formë të traumave, frikës dhe tërheqjes. Deri sa jetojnë së bashku me dhunuesin, ato vazhdimisht janë në frikë se mund të provokojnë ndonjë sjellje të dhunshme (*“vazhdimisht frikësohesha se nëse nuk luaj sipas notave mund të sulmohem”*¹⁷⁶), se dhuna mund të ndodhë madje edhe nëse nuk ka kurrfarë provokimi (*“kur do të hapet dera, e ndjen se a është i dehur apo jo”*¹⁷⁷) dhe ndjenjë të pafuqisë totale (*“ai lëviz, unë jam në karrocë, mund të më bëjë çfarëdo që do”*¹⁷⁸).

Përfundimisht, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara që kanë përjetuar dhunë dhe keqtrajtimit në institucionet dhe shtëpitë ku kanë qenë të strehuara, kanë pasoja afatgjatë që reflektojnë me një nivel të ulët të zhvillimit emocional, mosbesim ndaj personave të tjerë, frikë, nivel të ulët të vetëbesimit dhe izolim nga shoqëria.

PËRGGJIGJE INSTITUCIONALE NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Evidenca e viktimave dhe autorëve të dhunës familjare me aftësi të kufizuara

Në bazë të kërkesës për informata me karakter publik, vetëm 5 IPQNKPS (Berovë, Manastir, Gjevgjeli, Dibër dhe Qyteti i Shkupit) dorëzuan të dhëna për numrin e grave me aftësi të kufizuara të cilat janë evidentuar si viktime të dhunës. 9 IPQNKPS-të tjera të cilat u përgjigjën ndaj kërkesave për informata theksojnë se nuk kanë raste të dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe nuk mbajnë evidencë të rasteve të dhunës familjare ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara.

Në periudhën nga viti 2018 deri 2021 (tremujori i parë), janë regjistruar gjithsej 13 raste të dhunës ndaj burrave dhe grave me aftësi të kufizuara, përkatësisht nga 2 deri në 4 raste në nivel vjetor (shih tabela 1).

176 Intervistë 4 (24.08.2021)

177 Intervistë 13 (07.09.2021)

178 Intervistë 13 (07.09.2021)

	Numri i rasteve të evidentuara të dhunës familjare				Numri i rasteve të dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuara			
	2018	2019	2020	2021	2018	2019	2020	2021
IPQNKPS - Berovë	20	14	10		2		1	
IPQNKPS - Manastir	69	73	95	54		1	2	2
IPQNKPS - Veles	23	29	42					
IPQNKPS - Gjevgjeli	33	26	22					1
IPQNKPS - Dibër	7	6	9	7				1
IPQNKPS - Kavadar	26	29	31					
IPQNKPS - Koçan	40	34	31					
IPQNKPS - Kumanovë	53	67	42					
IPQNKPS - Makedonski Brod		1	2					
IPQNKPS - Negotinë	8	8	11					
IPQNKPS - Prilep	155	281	284					
IPQNKPS - Radovish								
IPQNKPS - Shkup	478	558	575		1	1	1	
IPQNKPS - Tetovë		32	34	33				
Gjithsej	912	1158	1188	94	3	2	4	4

Tabela 1: Numri i rasteve të dhunës ndaj grave me dhe pa aftësi të kufizuara

Në bazë të të dhënave të dorëzuara nga Qendrat ndërkomunale për punë sociale, nga 13 raste të evidentuara të dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuara, 10 raste kanë të bëjnë me dhunë ndaj grave me aftësi të kufizuara, ndërsa 3 raste janë evidentuar si dhunë ndaj burrave me aftësi të kufizuara. Në bazë të aftësisë së kufizuar, dhuna është evidentuar ndaj 2 grave me aftësi të kufizuar intelektuale, 2 gra me retardim të lehtë mendore, 2 burra me retardim të lehtë¹⁷⁹, 1 grua me shikim të dëmtuar, 1 grua me aftësi të kufizuar të lehtë, 1 burrë dhe 1 grua me formë më të rëndë të sëmundjes kronike dhe sëmundjes shpirtërore. Në aspekt të formave të dhunës, nga IPQNKPS janë evidentuar dhunë fizike, psikike, si dhe keqpërdorim emocional.

Sipas informacioneve të Avokatit të Popullit¹⁸⁰, gjatë vitit 2019 janë evidentuar 171 fëmijë viktime të dhunës, nga të cilët një fëmijë mashkull është me aftësi të kufizuara. Një nga konstatimet nga hulumtimi i kryer për dhunën në familje në vitin 2019. (ku përfshihen 30 IP Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale, 76 stacione policore, 34 institucione shëndetësore publike dhe 25 gjykata themelore), për të cilën AP thekson se një pjesë e QPS ose nuk kanë evidencë për këtë kategori të viktimave ose nuk kanë rast të evidentuar të viktimës së dhunës në familje - person me aftësi të kufizuara. Sipas konstatimeve të hulumtimit të AP dhe informacioneve që kanë marrë nga QPS, *“në vitin 2019 ka pasur 8 viktime¹⁸¹ me aftësi të*

179 Terminologjia e përdorur sipas ligjeve egzistuese.

180 Dorëzuar në formë emaili më 26.07.2021

181 Dallimi me numrin e paraqitur më lart është për shkak të numrit të QPS-ve që kanë dorëzuar të dhënat.

kufizuara, prej të cilave shumica gra - 6, 1 burrë dhe 1 djalë deri në 18 vjeç, ndërsa nga muaji janar-maj 2020 ka pasur gjithsej 5 viktimë me aftësi të kufizuara - të gjitha gra". Nga AP theksojnë se ka pasur "1 person me invaliditet trupor, 2 me aftësi të kufizuara intelektuale, 1 person me çrregullim shqisor dhe 2 me çrregullim psikik". Avokati i Popullit gjithashtu thekson se në hetimin e tyre "pothuajse të gjitha stacionet policore janë përgjigjur se nuk ka pasur viktimë të tilla, me përjashtim të Stacionit Policor në Ohër (një grua), Stacionit Policor në Strumicë (një grua) dhe Stacionit Policor në Draçevë (një djalë nën 18 vjeç) të cilët kanë theksuar se kanë një person me aftësi të kufizuara, viktimë e dhunës në familje"¹⁸². Sa i përket aftësisë së kufizuar, nga të dhënat e marra rezulton se në Stacionin Policor Ohër personi ka "çrregullim shqisor, në Stacionin Policor Strumicë me aftësi të kufizuar fizike, ndërsa në Stacionin Policor Draçevë është me probleme psiko-sociale. Të dhënat të cilat i ka marrë AP nga institucionet shëndetësore publike për numrin e viktimave të dhunës në familje tregojnë për 3 persona të evidentuar me aftësi të kufizuara në vitin 2019. (1 burrë, 1 grua dhe 1 vajzë deri në 18 vjeç) dhe 1 rast në pesë muajt e parë të vitit 2020. (djalë deri në 18 vjeç). Avokati i Popullit po ashtu thekson se "asnjë gjykatë Themelore nuk ka cekur se ka evidentuar viktimë të dhunës në familje me aftësi të kufizuara".

Në përgjigjen e dorëzuar nga Prokuroria Publike¹⁸³ thuhet se "...nuk kemi mundësi t'ju ofrojmë informatat e kërkuara, sepse nuk janë informata që tashmë ekzistojnë dhe janë në dispozicion të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjegjësisht, gjatë përgatitjes së Raporteve Vjetore për punën e Prokurorisë Publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, veprat penale për dhunë në familje dhe lloje të tjera të dhunës ndaj grave dhe personave me aftësi të kufizuara nuk trajtohen veçmas, e as në baza tjera për të cilën ju kërkonit informacione...".

Ministria e Punëve të Brendshme, në lidhje me evidentimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje¹⁸⁴ ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, thekson se bashkëpunon ngushtë me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe me organet e drejtësisë. Në evidencën e dorëzuar nga Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka të dhëna për viktimat me aftësi të kufizuara. Sa u përket formave të dhunës, pra ankesave që ka marrë MPB-ja, më të përfaqësuara janë ankesat për maltretim psikik (2019 - 2557 ankesa, 2020 - 3207 ankesa dhe 2021 - 1601 ankesa), pastaj vijnë ankesat për maltretim fizik (2019 - 557 ankesa, 2020 - 497 ankesa dhe 2021 - 250 ankesa). Numri më i ulët i ankesave është për maltretimin ekonomik (2019 - 82 ankesa, 2020 - 55 ankesa dhe 2021 - 32 ankesa). Nuk ka të dhëna për viktimat me aftësi të kufizuara, si dhe të dhëna për autorët e dhunës me aftësi të kufizuara.

Lidhur me të dhënat e dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara nga organizatat e shoqërive civile, Shoqata maqedonase e juristëve të rinj¹⁸⁵ në vitin 2020 kanë evidentuar një ngjarje të dhunës në familje të një gruaje viktimë me aftësi të kufizuara, ndërsa në vitin 2021 janë evidentuar dhe raportuar dy raste, njëri rast me një vajzë viktimë me aftësi të kufizuara dhe tjetri rast me një grua viktimë me aftësi të kufizuara. SHJRM nuk tregon se për çfarë forme të dhunës bëhet fjalë në rastet e evidentuara. OQ HERA thekson se deri në vitin 2020 nuk kanë mbajtur evidencë të veçantë mbi bazën e aftësisë së kufizuar, përkatësisht se "[deri] në vitin 2020 të dhënat e përmbledhura nuk janë veçuar në bazë të aftësisë së kufizuar. "Nga viti 2021, statistikat dhe përpunimi i të dhënave janë elaboruar më hollësisht".

182 Përgjigje e marrë më 26.07.2021

183 Nr. ark. 03 - 523/2 nga 15.10.2021

184 Aktvendim nr: 16.1.2-989/1, 20.07.2021

185 Informatë e marrë më 27.08.2021

Gjithashtu, në pyetësorin online, përfaqësuesit e OQ-së të cilët u përgjigjën në pyetësin dhanë të dhënë se në 3 vitet e fundit, te organizatat që ofrojnë ndihmë dhe mbështetje për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, janë paraqitur më së shumti 10 raste, e më shpesh ato janë 1-3 në vit.

Në pyetjen nëse IPQNKPS dhe Ministria e Punëve të Brendshme kanë iniciuar procedurë ndaj prindërve/kujdestarëve të fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara për shkak të dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, vetëm IPQNKPS Manastir thekson se kanë iniciuar 3 procedura në Gjykatën Themelore në Manastir, me ç'rast si dhunues paraqiten: bashkëshorti, partneri jashtëmartesor dhe ish-bashkëshorti, por nuk jepet asnjë informacion specifik nëse këta autorë janë prindër apo kujdestarë të fëmijëve apo të rriturve me aftësi të kufizuara. 13 IPQNKPS tjera, MPB-ja, si dhe AP-ja nuk kanë iniciuar apo evidentuar procedime dhe raste ndaj prindërve/kujdestarëve të fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara.

Sa u përket autorëve me aftësi të kufizuara, evidenca gjithashtu është e pakët. Sipas informacioneve të marra nga IPQNKPS, në 3 vitet e fundit janë evidentuar vetëm 8 autorë me aftësi të kufizuara, 2 raste në Berovë, Manastir, Radovish dhe 1 rast në Gjevgjeli dhe Qytetin e Shkupit. Në aspekt të dimensionit gjinor, 5 nga autorët kanë qenë meshkuj dhe 3 femra me aftësi të kufizuara. 3 autorë kanë qenë me paaftësi të lehtë intelektuale (2 burra, 1 grua), 2 persona me retardim të lehtë mendore (burra), 1 grua me sëmundje shpirtërore, 1 burrë me aftësi të kufizuar trupore më të rëndë (këmbë e amputuar) dhe 1 grua me aftësi të kufizuar trupore.

Në 3 vitet e kaluara nga ana e MPB-së nuk janë evidentuar autorë të dhunës familjare me aftësi të kufizuara.

Evidenca dhe dhuna në institucionet, shtëpitë në grupe dhe format e organizuara të mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara

Vendi i banimit është një faktor i rëndësishëm që kontribuon në rritjen e rrezikut të dhunës, eksploatimit dhe torturës ndaj personave me aftësi të kufizuara. Ky element mbështet dhe inicion dhunën sistematike të shoqëruar nga praktika diskriminuese që kufizojnë qasjen e barabartë në shërbimet dhe resurset publike.¹⁸⁶

Pyetjes nëse në 3 vitet e fundit IPQNKPS ka pasur raste të dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuar të vendosur në institucione, shtëpi në grupe dhe forma tjera të jetesës së organizuar, nga gjithsej 14 IPQNKPS, 12 janë përgjigjur se nuk kanë evidentuar viktimë të dhunës me aftësi të kufizuara të vendosura në institucione, shtëpi në grupe dhe forma tjera të jetesës së organizuar, dhe 2 IPQNKPS nuk kanë dhënë përgjigje për këtë pyetje

Lidhur me procesin e nisur të deinstitutionalizimit dhe futjes së formave të reja të mbrojtjes jashtëinstitucionale, si dhe për të perceptuar dhe marrë informacion mbi gjendjen e personave me aftësi të kufizuar në këto institucione, kërkesa për qasje të lirë në informacione janë parashtruar në IP Enti Special Demir Kapi, institucion që është përgjegjës edhe për shtëpitë në grupe për fëmijë me aftësi të kufizuara në Negotinë, Korushnicë dhe Timjanik, të dalë nga vetë institucioni, IP Instituti për Mbrojtje dhe Rehabilitim Banja Bansko - Strumicë, Spitali Psikiatrik Bardovcë - Shkup, si dhe në Spitalin Psikiatrik - Hisar. Përgjigje janë marrë

186 Koçoska, E., (2017) Dhuna ndaj personave me aftësi të kufizuara, Polio Plus - Shkup.

nga IP Institucioni special Demir Kapi, IP Instituti për mbrojtje dhe rehabilitim Banja Bansko - Strumicë dhe Spitali Psikiatrik në Shkup. Në bazë të kërkesave të parashtruara për informacione, ISHMS Demir Kapi thekson se në 3 vitet e fundit janë evidentuar 2 raste të dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuara (shih tabelën 2) nga punonjës të institucionit.

Viti	Shfrytëzues i IPMS Demir Kapi	Gjinia	Mosha	Aftësi të kufizuar	Përkatësi etnike	Shfrytëzues	Dhuna
2019	Person me aftësi të kufizuar	Meshkuj	61	Aftësi e kufizuar e rëndë intelektuale	Maqedonas	IPQNKPS Prilep	“I punësuar është grindur verbalisht me shfrytëzues, i ka rënë shuplakë shfrytëzuesit“
2020	Person me aftësi të kufizuar	Femra	34	Aftësi e kufizuar e rëndë intelektuale	Rome	IPQNKPS Shtip	„Përdhunim të personit të pafuqishëm“

Tabela 2: Raste të evidentuara të dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuar në IPMS Demir Kapi¹⁸⁷

Në bazë të veprave të kryera, IPMS Demir Kapi ka iniciuar procedurë ndaj punonjësve. Në rastin e parë është njoftuar IPQNKPS Prilep dhe është paraqitur denoncim në MPB dhe në Prokurorinë Publike në Kavadar. Procedura është ndërprerë për faktin se kujdestari i personit me aftësi të kufizuar të vendosur në IPMS Demir Kapi ka hequr dorë nga ndjekja penale. Në rastin e dytë është paraqitur denoncim nga IPMS Demir Kapi në MPB dhe PPTH Kavadar “përdhunim të personit të pafuqishëm” nga neni 187 par. 4 në lidhje me par. 1 të Kodit Penal. Punonjësi fillimisht është pezulluar nga puna, e më pas është pushuar nga puna dhe Gjykata Themelore në Negotinë e ka dënuar me 2 vite burg. IP Banja Bansko¹⁸⁸ thekson se “në 3 vitet e fundit në IP Banja Bansko nuk është evidentuar dhe raportuar asnjë rast i dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuara”.

Nga Spitali Psikiatrik në Shkup theksojnë¹⁸⁹ se “në kuadër të veprimtarisë shëndetësore, të shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore në Spital trajtohet sëmundja themelore psikiatrike dhe mbahen evidenca përkatëse të përcaktuara me ligjet, me çrast nuk kemi obligim të mbajmë statistika të veçanta për personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë evidencë të numrit të rasteve të dhunës që përfshijnë persona me aftësi të kufizuara”.

Nga Avokati i Popullit është theksuar se “mekanizmi kombëtar parandalues në 3 vitet e fundit nuk ka vërejtur raste të dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuar të vendosur në institucione, shtëpi në grupe dhe forma tjera të jetesës së organizuar”. Mirëpo, “në një rast, pas marrjes së informatave nga mediat, ekipi për monitorimin e zbatimit të KDPAK-së pranë Seksionit të Fëmijëve dhe Personave me Aftësi të Kufizuara të Avokatit të Popullit ka vepruar me iniciativë të tij për rastin e dhunës ndaj vajzës me aftësi të kufizuar, shfrytëzuese e Entit Special Demir Kapi”.

Përgjigje të tilla për pyetjet në kërkesat për informata me karakter publik janë në kundërshtim me dëshmitë e grave dhe vajzave që kanë marrë pjesë në hulumtim, të cilat kanë kaluar një pjesë të jetës së tyre në institucion, shtëpi në grup ose familje kujdestare¹⁹⁰ (shih më lart në pjesën “Përvoja me dhunë dhe maltretim”). Ata rrëfyan ngjarjet e tmerrshme që kanë përjetuar ose në të cilat kanë dëshmuar, për shpërfilljen e plotë të denoncimeve të tyre nga autoritetet kompetente dhe për pasojat afatgjata që ende ndikojnë në ndjenjën e tyre të sigurisë dhe vetëbesimit.

Përvojat me paraqitjen e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara që kanë pësuar dhunë dhe / ose maltretim

Për sa i përket ndihmës dhe mbështetjes nga institucionet, 36 nga gjithsej 75 të anketuara që kanë marrë pjesë në intervista dhe grupe të fokusit, në rast dhune apo maltremiti, fillimisht do të thërrisnin policinë. Vetëm 9 nga të anketuarat janë të njohura me punën e organizatave që ofrojnë mbështetje për gratë viktime të dhunës, shumica e tyre sepse kanë qenë vullnetare ose kanë punuar në organizatë të tillë, dhe jo sepse kanë marrë materiale me informacione ose kanë marrë pjesë në trajnime. Vetëm 5 gra me aftësi të kufizuara e paraqitën dhunën në polici, ndërsa dy nga gratë që kanë qëndruar në institucion e kanë paraqitur në Qendrën për Punë Sociale.

Sa u përket përvojave me paraqitjen, të anketuarat që paraqitën thanë se më shpesh të punësuarit në institucionet ku paraqitet nuk janë të njohur se si të reagojnë kur paraqesin dhunën nga personi me aftësi të kufizuara, kanë vështirësi në komunikim (veçanërisht femrat e shurdhra kanë problem se nuk ka interpretues), dhe në ndërhyrjet e policisë në rastet e dhunës fizike, të anketuarat kanë thënë se asgjë nuk është zgjidhur dhe se dhuna ka vazhduar njësoj ose edhe më keq pas 2-3 ditësh. Si rezultat, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara që përjetojnë dhunë nuk u besojnë institucioneve dhe paraqesin rrallë (“Do të vijmë, do të shohin dhe do të ikin dhe nuk do të bëjnë asgjë derisa të ndodhë diçka vërtet serioze. Institucionet nuk janë të gatshme të punojnë me personat pa aftësi të kufizuara dhe jo me personat me aftësi të kufizuara”¹⁹¹). Gjithashtu, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara që kanë përvojë me paraqitjen konstatojnë se paraqitja e dhunës nga gruaja me aftësi të kufizuara nuk merret seriozisht për shkak të stereotipeve dhe paragjykimeve, sepse mendohet se personi nuk mund të kuptojë se çfarë është dhuna¹⁹². Një e anketuar tregoi se si pas thirrjes së dytë në polici për incident më serioz të dhunës fizike, policët që erdhën në shtëpi e morën në pyetje para fëmijës së saj i cili ishte dukshëm i mërzhitur dhe nuk i shpjeguan asgjë për paraqitjen e rastit të dhunës në familje, gjë që e bëri atë të hiqte dorë nga paraqitja¹⁹³. Një tjetër e anketuar tregoi se ka paraqitur shumë herë në polici, por nuk ka marrë kurrfarë ndihme, por gjithashtu ka qenë edhe tek Avokati i Popullit, ku e kanë marrë në pyetje, kanë bërë procesverbal dhe kurrë nuk kanë marrë kurrfarë përgjigje. Mbështetja e vetme që e anketuara mori ishte nga organizata civile, kryesisht në formën e mbështetjes dhe inkurajimit emotiv dhe psikologjik¹⁹⁴. Vetëm një e anketuar ka treguar për përvojën e saj në paraqitjen e dhunës seksuale, kur gjatë paraqitjes së sulmit seksual, në vend të mbrojtjes nga policia mori “e ka kërkuar vetë”, respektivisht ka hasur në paragjykime dhe dënime nga policët të cilët e kanë këshilluar që mos ta paraqes sulmin sepse dyshonin se ajo e kishte shkaktuar dhe nuk mund të dëshmonte apo të fitonte diçka duke paraqitur¹⁹⁵.

190 Grupi i fokusit 31.08.2021

191 Intervistë 9 (01.09.2021)

192 Intervistë 8 (31.08.2021)

193 Intervistë 10 (01.09.2021) - më pas intervista ishte ndërprerë për shkak se e anketuara po telefononte fshehurazi, në momentin kur ishte vetëm.

194 Intervistë 15 (07.09.2021)

195 Grupi i fokusit 10.09.2021

187 Numri arkivor 03- 456/3 nga 10.08.2021

188 Përgjigje nga 20.07.2021

189 Numri arkivor 03 - 9891/2 nga 30.07.2021

Kështu, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara që pësojnë dhunë shpesh nuk shohin zgjidhje dhe se mund të marrin ndihmën dhe mbështetjen e nevojshme nga diku (“*Kemi mbetur vetëm, nuk ka kush të ndihmojë dhe të mbështesë*”¹⁹⁶, “*Është e vështirë kur nuk dini çfarë të bëni, kujt t’i drejtoheni, kur jeni të painformuar*”¹⁹⁷). Një e anketuar tregoi përvojën e saj në Departamentin e Psikiatrisë ku vetë ishte paraqitur për qëndrim për shkak të pasojave të dhunës që kishte përjetuar që në fëmijërinë e hershme, ku e kishin bindur se duhej të përpiqej të kënaqte burrin e saj dhe se ajo ishte fajtoare për tradhtinë e tij¹⁹⁸. Të anketuarat që kanë qëndruar në institucione dhe familje kujdestare dhe janë paraqitur për ndihmë në Qendrën për Punë Sociale kanë thënë se kanë marrë ndihmën e nevojshme, përkatësisht janë transferuar shpejt në vend tjetër¹⁹⁹.

Serviset e ndihmës dhe mbështetjes së grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara që janë viktimat të dhunës

Në pyetjen se cilat servise të mbështetjes janë në dispozicion për të mbështetur viktimat me aftësi të kufizuara, si dhe për kryerësit me aftësi të kufizuara, në aspektin e parandalimit, mbrojtjes dhe riintegrit, përgjigjet e kërkesave për informacionet janë dorëzuar nga 13 IPQNPS. Përveç kësaj, serviset për mbështetjen e viktimave dhe/ose kryerësve me aftësi të kufizuara shihen si servise të veçanta që nuk duhet të jenë pjesë e serviseve ekzistuese ose pjesë e serviseve të reja që do të kishin qasje ndërsektoriale. Për shembull, disa nga përgjigjet e IPQNPS-së janë: “*Nuk ka servise për të mbështetur viktimat me aftësi të kufizuara, as për kryerësit me aftësi të kufizuara*” ose “*Nuk ka konkretisht për viktimat me aftësi të kufizuara*”²⁰⁰. Ky perceptim është përmirësuar edhe me mendimin për profilin e personave që duhet të përfshihen në serviset e mbështetjes së viktimave me ose pa aftësi të kufizuara. Disa nga IPQNPS-të theksojnë se në profilin e personave të angazhuar në këto servise mund të përfshijë edhe defektolog. Paralelisht, disa IPQNPS theksojnë serviset e tjera që i zbatojnë në bashkëpunim me OC-në si formë përmes së cilës mund të identifikonin «mundësisht» dhunën në familje, pa marrë parasysh që shërbimi i tillë, në këtë rast asistenti personal, mund të jetë dhunuesi / dhunuesja në shtëpinë e personit me aftësi të kufizuara.

Përfaqësuesit e Trupit Koordinues për Zbatimin e KDPK-së të cilët i janë përgjigjur pyetësorit online ose nuk janë në dijeni nëse institucioni ku punojnë ka programe, shërbime apo servise të veçanta për personat me aftësi të kufizuara ose janë përgjigjur se nuk ka programe, shërbime apo servise të tilla. Ata gjithashtu përgjithësisht nuk e dinë nëse ka programe, shërbime apo servise të veçanta për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara.

Në nivel lokal, vetëm 9 nga gjithsej 32 të anketuar nga NJVL-ja që iu përgjigjën pyetësorit online janë përgjigjur se institucioni ku punojnë ka programe, shërbime apo servise të veçanta të synuara posaçërisht për personat me aftësi të kufizuara, 6 janë përgjigjur se nuk e dinë, ndërsa 17 (53%) janë përgjigjur se nuk ka programe, shërbime apo servise të tilla. Programet, shërbimet dhe serviset e ofruara përfshijnë: ofrimin e asistentëve personalë dhe asistentëve arsimorë për personat me aftësi të kufizuara, kujdestarët për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, subvencionet për qasjen në shtëpi, planet arsimore individuale dhe punën individuale me nxënësit, patrullat humane, mbështetja financiare e njëhershme, bursat për fëmijët me aftësi të kufizuara, Qendra për kujdesin e personave me

196 Intervistë 4 (24.08.2021)

197 Grupi i fokusit 24.07.2021 (2)


198 Intervistë 11 (04.09.2021)

199 Grupi i fokusit 31.08.2021

200 Shih ANEKSI 1.

aftësi të kufizuara, mbështetja e organizatave joqeveritare që punojnë me personat me aftësi të kufizuara, LAP-i për personat me invaliditet, personi i emëruar i kontaktit për personat me aftësi të kufizuara, aktivitetet dhe projektet e veçanta që synojnë personat me aftësi të kufizuara në Programin për mbrojtjen sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore të komunës, etj. Në pyetjen nëse komuna ka programe, shërbime apo servise të synuara posaçërisht për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, vetëm 1 e anketuar është përgjigjur pozitivisht, ndërsa 3 janë përgjigjur se nuk e dinë dhe pjesa tjetër janë përgjigjur negativisht. Nuk është theksuar asnjë shembull i programeve, shërbimeve apo serviseve të tilla.

A ka institucioni në të cilin punoni programe/shërbime/servise të orientuara në mënyrë të veçantë? (32 responses)



10 nga 13 përfaqësuesit e OC-së që iu përgjigjën pyetësorit online konfirmuan se organizata ka servis për viktimat e dhunës, shumica prej tyre ndihmë juridike për viktimat e dhunës (10) dhe ndihmë psiko-sociale (7), ndërsa 2 kanë numër SOS të ndihmës për viktimat e dhunës në familje, njëra ka strehim për akomodimin e viktimave të dhunës në familje dhe njëra ka shtëpi për banim të hapur (servis riintegrimi). 9 prej organizatave ofrojnë servise që janë në dispozicion për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara që janë viktimat të dhunës.

10 nga përfaqësuesit e OC-së që iu përgjigjën pyetësorit online deklaruan se puna e organizatave të tyre është gjithëpërfshirëse për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, ndërsa 3 u përgjigjën se nuk është. E arrijnë gjithëpërfshirjen kryesisht duke ofruar qasje në eventet që i organizojnë (9 përgjigje) dhe duke ofruar mbështetje të drejtpërdrejtë për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara (8 përgjigje), dhe më pak përmes qasjes në mjediset e organizatës (5 përgjigje) dhe përgatitjes së materialeve në formate të disponueshme për personat me aftësi të kufizuara (3 përgjigje).

Qasja e institucioneve dhe organizatave


1. Aftësimi përkatës

Lidhur me pyetjen nëse është paraparë aftësimi përkatës për viktimat me aftësi të kufizuara, si dhe për kryerësit me aftësi të kufizuara, 13 IPQPS tregojnë se nuk kanë udhëzues, ndërsa vetëm nga IPQNPS Makedonski Brod janë përgjigjur se kanë. Gjithashtu, udhëzues nuk kanë as Entet Speciale (Demir Kapi dhe Banja BANSKO), MPB-ja dhe AP-ja. Nga Spitali Psikiatrik në Shkup, lidhur me këtë çështje theksojnë se “*nuk ka protokoll apo algoritëm të veçantë për trajtimin me personat me aftësi të kufizuara*”²⁰¹. Në përgjigjen e kësaj pyetjeje, MPB-ja thekson se është në procedurë miratimi i akteve nënligjore të Ligjit të ri për parandalimin dhe

201 Numri arkivor 03-891/2 nga 30.07.2021

mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje. AP-ja thekson se megjithëse nuk kanë Udhëzues për aftësimin përkatës, në punën e tyre ende përdorin një numër të madh publikimesh dhe analizash në nivel vendas dhe ndërkombëtar (OSBE - Udhëzuesi për aftësimin përkatës, doracaku i UNICEF-it, Udhëzuesi për zbatimin e strategjisë nacionale për barazi dhe mosdiskriminim mbi përkatësinë etnike, moshën, paaftësinë mentale dhe fizike dhe mbi bazë gjinore të Këshillit Britanik, etj.), si dhe KDPAK-së. Nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut theksojnë se “PPRMV-ja nuk ka protokolle për informimin dhe referimin e viktimave me aftësi të kufizuara dhe kryerësve me aftësi të kufizuara, as udhëzues për zbatimin e aftësimin përkatës për viktimat me aftësi të kufizuara, si dhe për kryerësit me aftësi të kufizuara”. Nga OC-ja që iu përgjigjën pyetësorit online, shumica nuk kanë udhëzues për zbatimin e aftësimin përkatës për shërbimet që i ofrojnë (10), vetëm një i anketuar është përgjigjur se kanë, ndërsa 2 se nuk e dinë.

A keni udhëzues për aplikimin e përshtatjes adekuate për shërbimet që i siguron organizata juaj? (13 responses)



Duke pasur parasysh rëndësinë e aftësimin përkatës për personat me aftësi të kufizuara, dhe për shkak të karakterit të tij antidiskriminues, si dhe nevojës për mosidentifikimin e tij me qasjen nga neni 9 të KDPAK-së, është e nevojshme të përgatiten materialet udhëzuese të cilat do të shpëtojë aftësimin përkatës si instituti juridik antidiskriminues, si dhe mënyrat e realizimit të tij.

2. Disponueshmëria

Kur bëhet fjalë për qasjen e vetë institucioneve, 3 IPQNPS tregojnë se janë fizikisht të disponueshme **për personat me aftësi të kufizuara. 4 IPQNPS tregojnë se janë pjesërisht të disponueshme për personat me aftësi të kufizuara, ndërsa 6 IPQNPS të tjera që iu përgjigjën kërkesave për informacione tregojnë se nuk janë të disponueshme.**Një pjesë e madhe theksojnë se nuk kanë qasje fizike në objektet e tyre - “Nuk ka rampë hyrëse në objektet ku ndodhet QPS Veles dhe nuk është teknikisht e realizueshme për t’u bërë” ose “Hapësirat e IPQNPS Berovë janë të vendosura në katin e dytë, pa ashensor dhe pa mundësinë e shfrytëzimit të hapësirës për lëvizje me mjete ndihmëse (korridore të ngushta, dyer standarde, shkallë të pjerrëta), pa mbështetje adekuate për lëvizje në shkallë, etj.”.

Ka diskriminim sistematik në vend ndaj personave me aftësi të kufizuara fizike që përdorin karrocë invalidore për të hyrë në IPQNPS. Ky konstatim konfirmohet edhe nga rezultatet e testimit të situatës së kryer nga Komiteti i Helsinkit në vitin 2020²⁰²për qasjen e personave

²⁰²Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (2020) Diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuara fizike të cilët përdorin karrocë invalidore për të hyrë në qendrat ndërkombëtare për punë sociale - Testimi i situatës (në versionin e punës).

që përdorin karrocë invalidore në IPQNPS. Sipas analizës, 21 nga gjithsej 30 IPQNPS vetëm 4 kanë konfirmuar se kanë qasje të plotë, përkatësisht kanë qasje të jashtme për personat me karrocë invalidore, qasje të plotë të brendshme dhe tualete të disponueshme. 15 qendra kanë vetëm qasje të jashtme - rampë, por asnjëra prej tyre nuk ka qasje të brendshme për personat që përdorin karrocëinvalidore, ndërsa vetëm 1 nga këto 15 qendra ka tualet të disponueshëm. Rreth 6 QPS janë krejtësisht të padisponueshme. Gjithashtu, është konstatuar mospërshtatshmëri në një pjesë të nëpunësve në qendrat, ku “Testerëve u është thënë se është më mirë që dikush të vijë në qendër në emër të tyre, u është thënë se megjithëse qendra është e disponueshme, do të duhet të paraqiten, ndërsa një pjesë e nëpunësve u habitën dhe bënë komente të papërshtatshme në pyetjen nëse qendrat kanë tualete të disponueshme”.

Sa i përket qasjes në MPB, nga institucioni theksojnë se “MPB-ja për objektet e Sektorëve të Punëve të Brendshme, Stacioneve Policore dhe Shërbimeve Administrative në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka vendosur rampa për të lëvizur personat me aftësi të kufizuara”, ndërsa nga PP-ja theksojnë se hapësirat janë të qasshme dhe të disponueshme për personat me aftësi të kufizuara.

Nga 3 anëtarë të Trupit Koordinues për Zbatimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara të punësuar në organet e administratës shtetërore të cilët iu përgjigjën pyetësorit online, të pyetur nëse institucioni i tyre është i disponueshëm për personat me aftësi të kufizuara, u përgjigjën po dhe jo, ndërsa 1 u përgjigj se nuk e di.

Qasja është problem edhe për OC-në. SHMJRR dhe HERA, në përgjigjet e kërkesave për informacione, theksojnë se nuk kanë qasje fizike në hapësirat e tyre, dhe as në Qendrën e Parë Familjare që menaxhohet nga HERA. SHMJRR-ja thekson: “Në çdo rast, në ofrimin e shërbimeve tona merren parasysh specifika e rastit, lloji i veprës penale, serioziteti i traumës, cenueshmëria e viktimës, nevojat dhe dëshirat e viktimës. Në hapësirat tona ofrohen shërbimet juridike dhe psikosociale, me mundësinë e përshtatjes së shërbimeve që do të ofrohen me telefon ose vizitë në terren. Sipas kushteve të vendosura nga virusi COVID-19, shërbimet përshtaten duke përdorur mjetet dhe mundësitë informatike.”

Në nivel lokal, 22 nga gjithsej 32 të anketuar nga 31 NJVL janë përgjigjur se institucioni në të cilin punojnë është i disponueshëm për personat me aftësi të kufizuara (10 janë përgjigjur negativisht).

A është institucioni në të cilin punoni i aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara? (32 responses)




Situata është shqetësuese që qasja nuk kuptohet në përputhje me detyrimet e KDPAK-së dhe barazohet vetëm me ekzistimin e rampës apo ashensorit në institucion, përkatësisht e gjithë struktura e ndërtesës dhe nevojat e ndryshme të personave me aftësi të kufizuara nuk merret parasysh.

3. Materialet dhe informacionet në format të disponueshëm

Ashtu si disponueshmëria, edhe terminet për informacionet e disponueshme nuk kuptohen në përputhje me KDPAK-në dhe nevojat e ndryshme të personave me aftësi të kufizuara. Sa u përket linjave telefonike për të paraqitur dhunën, sërish ka boshllëk të madh në njohjen e numrit të disponueshëm për personat me aftësi të kufizuara - “*Të disponueshëm janë vetëm telefonat e institucioneve për të paraqitur, si MPB-ja, QPS-ja. Linjat e tjera bien në sy përpara qendrës dhe në vende përreth qytetit, por përdoren dobët*”²⁰³.

Organizatave civile kryesisht hartojnë materiale në formatin e disponueshëm sipas nevojave dhe buxhetit të parashikuar të projekteve. 6 nga 13 përfaqësuesit e OC-së që iu përgjigjën pyetësorit online u përgjigjën se organizatat e tyre nuk kanë hartuar asnjëherë materiale informative / edukative për personat me shikim të dëmtuar (Letra e Brait) (5 kanë hartuar dhe 2 nuk e dinë). 6 nga 13 janë përgjigjur se organizatat e tyre nuk kanë hartuar asnjëherë materiale informative / edukative për personat me aftësi të kufizuara intelektuale (5 kanë hartuar dhe 2 nuk e dinë). Shumica e organizatave (8 nga 13) angazhojnë interpretues **të gjuhës së shenjave vetëm nëse evenimenti është posaçërisht për personat me dëgjim të dëmtuar, ndërsa 3 asnjëherë nuk kanë angazhuar interpretues dhe vetëm 2 u përgjigjën se gjithmonë angazhojnë.**

A angazhoni interpretues të gjuhës së shenjave për evenimente të cilat i organizon organizata juaj? (13 responses)



SHMJRR-ja, në përgjigjen e kërkesës për informacione, thekson se “[n]ë kuadër të projektit janë hartuar materiale promovuese (posterë dhe broshura) me të dhënat themelore dhe kontaktet e dobishme për viktimat. Për projektin është krijuar faqja në FB ku mund të gjen-den përmbajtjet informative për edukimin, informimin, njohjen dhe parandalimin e veprave penale të dhunshme, si dhe të bëni pyetje me shkrim në inboks, ndërsa faqja e internetit pristapdopravda.mk është përshtatur ku viktimat mund të bëjnë edhe pyetje anonime”. HERA, përmes Qendrës së Parë Familjare, bën me dije se kanë informacione të disponueshme: “Për të marrë shërbim, në përputhje me vlerësimin dhe bisedën me përdoruesit, shërbimi përshtatet në mënyrë që të jetë në përputhje me nevojat e përdorueses / përdoruesit. Për shembull, për përdorues me dëmtime të dëgjimit dhe të të folurit, interpretuesi i gjuhës së

203 Shih ANEKSIN 2.

shenjave përfshihet në psikoterapi me pëlqim shtesë. Përveç kësaj, ka përgatitur broshurë të Letrës së Brait [sic] dhe në formatin lehtësisht të kuptueshëm për dhunën me bazë gjinore”.

Nga organizatat që i janë përgjigjur pyetësorit online, vetëm 2 të anketuar janë përgjigjur se në buxhetet e organizatave të tyre parashikojnë mjete për ofrimin e qasjes, ndërsa 6 janë përgjigjur se nuk parashikohen dhe një i anketuar ka shtuar se e kanë parë nevojën për mjete të tilla vitin e kaluar kur kishin nevojë për interpretues të gjuhës së shenjave, të cilin nuk e kishin parashikuar dhe angazhuar vullnetar.


4. Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në institucionet dhe organizatat

Sa i përket përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara, vetëm në 4 IPQNPS (nga 14 që iu përgjigjën kërkesave për informacione) ka të punësuar person me aftësi të kufizuara në IPQNPS Berovë (1 femër me aftësi të kufizuara fizike), IPQNPS Manastir (1 mashkull me aftësi të kufizuara fizike dhe 1 mashkull me dëgjim të dëmtuar), IPQNPS Dibër (1 mashkull me aftësi të kufizuara fizike) dhe IPQNPS Kavadar (1 mashkull me aftësi të kufizuara të kombinuara). Nga MPB-ja theksojnë se ka të punësuar 5 persona me aftësi të kufizuara, si vijon “3 persona me aftësi të kufizuara fizike, 1 person me invaliditet të rëndë fizik dhe 1 person në kategorinë e personave me dëgjim të dëmtuar. Nga këta 5 persona të punësuar, 4 janë femra dhe janë të shpërndara sipas vendbanimit...”²⁰⁴. Gjithashtu, IP ES Demir Kapi ka të punësuar 1 mashkull me aftësi të kufizuara fizike. Nga PP-ja theksojnë se janë të punësuar 2 persona me aftësi të kufizuara, një mashkull dhe një femër, pa informacione më të detajuara se për çfarë lloj aftësie të kufizuar bëhet fjalë. Përfaqësuesit e Trupit Koordinues për Zbatimin e KDPAK-së të cilët iu përgjigjën pyetësorit online 2 janë përgjigjur se nuk e dinë nëse institucioni në të cilin punojnë ka të punësuar persona me aftësi të kufizuara, 3 janë përgjigjur pozitivisht dhe 2 se nuk ka.

Në organizatat civile që kanë dorëzuar përgjigjet e kërkesave, nuk ka persona të punësuar me aftësi të kufizuara, ndërsa nga OC-ja që iu përgjigjën pyetësorit online, vetëm në një ka të punësuar më shumë persona me aftësi të kufizuara dhe kjo është organizata që punon në fushën e aftësisë së kufizuar.

Në nivel lokal, vetëm në 12 nga 32 të anketuar nga NJVL-ja janë përgjigjur se në institucionin ku punojnë ka persona të punësuar me aftësi të kufizuara.

A ka të punësuar me aftësi të kufizuar në institucionin në të cilin punoni? (32 responses)



204 Të dhënat transmetohen siç thuhet në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik.

5. Protokollet e informimit dhe referimit

Lidhur me protokollet për informimin dhe referimin e viktimave të dhunës me aftësi të kufizuara, të gjitha IPQNPS-të që iu përgjigjën kërkesave për informacione theksojnë se kanë protokolle për referimin dhe informimin e viktimave, të udhëhequra në radhë të parë nga protokollet dhe udhëzimet që dalin nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, si dhe akteve nënligjore që janë në procedurë të miratimit. Por, ashtu si edhe për serviset, IPQNPS-të theksojnë se nuk kanë protokolle të veçanta për informimin dhe referimin e viktimave me aftësi të kufizuara dhe kryerësve me aftësi të kufizuara. Në këtë drejtim, për shembull, nga IPQNPS Diber theksojnë se *“ka protokolle për informimin dhe trajtimin e viktimave të dhunës dhe udhëhiqemi prej tyre, por jo protokolle të veçanta për viktimat me aftësi të kufizuara”*, ndërsa nga IPQNPS Kumanovë konfirmojnë se *“ka protokolle, por nuk janë të specializuara për viktimat me aftësi të kufizuara”*. Lidhur me protokollet dhe AP-në, thekson se *“në lidhje me viktimat me aftësi të kufizuara veprojnë në përputhje me mandatin dhe kompetencat e përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligjin për Avokatin e Popullit. Për rrjedhojë, në rast nevojë për këshillim juridik, i ka parasysh protokollet ekzistuese”*. Nga IP ES Demir Kapi theksojnë se *“informimi për dhunën nga personat me aftësi të kufizuara të vendosur në Entin dhe në njësitë banesore bëhet përmes koordinatoreve të personit përgjegjës të IP Entit Special Demir Kapi”*, ndërsa nga IP Banja BANSKO theksojnë: *“Nuk kemi protokolle për paraqitjen e dhunës nga personat me aftësi të kufizuara të vendosur në Entin dhe në format e jetesës së organizuar të menaxhuara nga Enti”*. Nga Spitali Psikiatrik – Shkup theksojnë se *“[Të] drejtat dhe mbrojtja e shfrytëzuesve të shërbimeve në Spital janë në pajtim me Ligjin për mbrojtjen shëndetësore, Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve me sëmundje mentale, Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve dhe për mundësinë e ankesave dhe paraqitjeve nga personat me aftësi të kufizuara apo për personat e punësuar me aftësi të kufizuara, ato do të realizoheshin në përputhje me protokollet e përgjithshme për ankesa në Spital”*²⁰⁵.

Ky rregullim i infrastrukturës institucionale në të gjitha institucionet, veçanërisht në entet speciale, si dhe në spitalin psikiatrik, është tregues i shqetësimeve shtesë, si dhe i rritjes së mundësisë së dhunës institucionale. Kjo mund të çojë në mosndëshkimin dhe padukshmërinë e çështjes, e cila mund të rezultojë në dhunë që zgjat për një periudhë të gjatë kohore²⁰⁶. Në përputhje me detyrimet e KDPAK-së, është e domosdoshme të vendosen sa më shpejt që të jetë e mundur rregullimet procedurale përkatëse²⁰⁷ për zbulimin e situatave të dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuara, trajtimin e tyre dhe sigurimin e mekanizmave për të mbështetur viktimat.

²⁰⁵Numri arkivor 03 – 9891/2 nga 30.07.2021

²⁰⁶ A/HRC/20/5 dhelspr. 1, paragrafi 19. Në dispozicion në: <https://undocs.org/A/HRC/20/5>


²⁰⁷ Komentimi i përgjithshëm nr. 3, Komiteti i të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara, paragrafi 53. Në dispozicion në: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD/C/GC/3&Lang=en

Gatishmëria e personave që punojnë në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara apo dhunës ndaj grave dhe vajzave

Nga përgjigjet e marra në kërkesat për informacione, si dhe në pyetësorët online, vërehet se çështja e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje është mjaft e integruar në trajnimet dhe edukimin e personave që punojnë në institucionet dhe organizatat, ndërkohë që trajnimet me fokus dhunën ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara nuk vizitohen fare.


Të gjithë përfaqësuesit e NJVL-së që iu përgjigjën pyetësorit online (32) kanë njohuri për tematikën e dhunës me bazë gjinore dhe çfarë përfshin ajo. Pjesa më e madhe e tyre (28) janë të njohur plotësisht, ndërsa 4 janë të njohur pjesërisht. Pak më pak të anketuar (22 nga 32) u përgjigjën se ishin plotësisht të njohur me Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambullit), ndërsa 10 u përgjigjën se ishin pjesërisht të njohur.

A jeni të njohur për Konventën e Këshillit të Evropës për parandalim dhe luftë kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës familjare (Konventa e Stambullit)? (32 responses)



20 të anketuar (nga gjithsej 32) nga NJVL-ja kanë ndjekur së paku një trajnim për parandalimin dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore, 10 prej tyre kanë ndjekur më tepër trajnime. Sa i përket trajnimit për parandalimin dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, vetëm 6 të anketuar kanë ndjekur një ose dy trajnime, ndërsa pjesa më e madhe (26) nuk kanë ndjekur asnjë.

A keni vizituar trajnim për dhunë të bazuar gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara? (32 responses)



Edhe sipas përgjigjeve të marra nga institucionet për kërkesat për informacione me karakter publik për pyetjen: “A kanë ndjekur shërbimet në institucionet trajnime për dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje ndaj personave me aftësi të kufizuara?” mund të vërehet neglizhimi i çështjes së aftësisë së kufizuar në kontekstin e dhunës. Vetëm dy institucione theksojnë se kanë pasur trajnime për parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje ndaj personave me aftësi të kufizuara. Institucionet e tjera në përgjigjet e tyre theksojnë se kanë pasur trajnime për parandalimin dhe trajtimin e dhunës me bazë gjinore, por nuk është përfshirë edhe çështja e personave me aftësi të kufizuara. Vetëm IPQNPS Shkup nuk ka dhënë përgjigje në këtë pyetje, ndërsa IPQNPS Negotinë thekson se “*Ligji i ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje është në fuqi nga 06.05.2021 dhe deri më tani nuk janë mbajtur trajnime, të cilat janë njoftuar për tremujorin e fundit në vitin 2021*”²⁰⁸.

Për sa u përket trajnimeve dhe edukimit, përgjigjja e Spitalit Psikiatrik në Shkup është: “*Duke pasur parasysh se veprimtaria shëndetësore ka për qëllim mjekimin e sëmundjeve psikiatrike, deri më tani nuk është organizuar trajnim për dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje për punëtorët shëndetësorë dhe bashkëpunëtorët shëndetësorë, as trajnime për Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, duke qenë se bëhet fjalë për një fushë të madhe dhe serioze që kërkon angazhim serioz dhe afatgjatë për të kapërcyer dhe zbatuar dhe në të njëjtën kohë nuk kemi protokoll përkatës apo algoritëm tjetër për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara*”²⁰⁹.

Prokuroria Publike në shkresën e saj po ashtu thekson se shërbimet pranë PP-së nuk kanë ndjekur trajnime për dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Pjesa më e madhe e të anketuarve nga OC-ja (11 nga 13) që iu përgjigjën pyetësorit online janë trajnuar për të punuar në servis për viktimat e dhunës me bazë gjinore. 5 nga të anketuarit nuk kanë ndjekur asnjë trajnim për parandalimin e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, ndërsa 5 kanë ndjekur disa trajnime për këtë tematikë.

A keni vizituar ju ose dikush prej kolegëve tuaj trajnim për dhunë me bazë gjinore ndaj grave ose vajzave me aftësi të kufizuara? (13 responses)



208 Numri arkivor 21-370/2 nga 29.07.2021


209 Numri arkivor 03-891/2 nga 30.07.2021

Shumica e të anketuarve nga OC-ja (7) e njohin mirë Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, ndërsa vetëm 2 nuk e njohin fare.

Nga OC SHMJRR theksojnë se kanë ndjekur një trajnim “*si pjesë e aktivitetit të projektit se si të zhvillojnë intervista me personat që janë viktimat me aftësi të kufizuara, të cilat ndër të tjera, paraqiten si grupe të synuara në projekt*”²¹⁰. Nga OC HERA theksojnë se “[Të] punësuarit (punëtori social dhe psikologu) kanë ndjekur trajnime. Psikoterapistët që janë angazhuar si ofrues shërbimesh ende jo, disa prej tyre kanë trajnime që i kanë ndjekur për punë me personat me aftësi të kufizuara.”²¹¹.

Ashtu si në trajnimet për dhunën me bazë gjinore, ashtu edhe në trajnimet për KDPAK-në, 89% e institucioneve, përfshirë edhe MPB-në, IP Entin Special Demir Kapi, AP-në, Prokurorinë Publike, si dhe OC-në nuk kanë ndjekur trajnime për KDPAK-në.

A kanë vizituar shërbimet në institucionet trajnim për KDNJAK



Nga 14 përgjigjet nga IPQNPS-ja, vetëm nga IPQNPS Manastir theksojnë se shërbimet kanë ndjekur trajnime për Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Lidhur me këtë çështje, MPB-ja thekson se “*...[D]uam të theksojmë se zbatimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara kryhet nga Trupi Koordinues Nacional për Zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në të cilën nuk ka përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme*”²¹².

Kjo plotësohet nga përgjigjja e Spitalit Psikiatrik, e cila e pasqyron plotësisht modelin mjekësor për çështjen e aftësisë së kufizuar.

Të gjithë të anketuarit nga Trupi Koordinues për Zbatimin e KDPAK-së që iu përgjigjën pyetësorit online (7) janë të njohur me nocionin dhunë me bazë gjinore dhe çfarë mbulon ai, madje 6 janë plotësisht të njohur, ndërsa 1 pjesërisht. E njëjta situatë është edhe me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Vetëm njëri nga të anketuarit nga Trupi Koordinues nuk ka ndjekur asnjë trajnim për parandalimin dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore, ndërsa 6 të tjerët kanë ndjekur të paktën një. Nga ana tjetër, shumica e të anketuarve nuk kanë ndjekur asnjë trajnim për parandalimin dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara.


210 Përgjigjja e marrë më 27.08.2021

211 Përgjigjja e marrë më 16.08.2021

212 Aktvendimi numër 16.1.2-989/1 nga 30.07.2021

Edhe në mesin e përfaqësuesve të NJVL-së që iu përgjigjën pyetësorit online, njohuritë janë shumë më të pakta në lidhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Vetëm 10 janë përgjigjur se janë të njohur, 17 janë pjesërisht të njohur dhe 5 nuk kanë njohuri fare për këtë Konventë.

A jeni të njoftuar për Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?
(32 responses)



Nga vetë përgjigjet shihet se institucionet nuk kanë njohuri për KDPAK-në dhe është e domosdoshme ngritja e kapaciteteve të tyre për të rritur ndërgjegjësimin e institucioneve për rëndësinë e KDPAK-së dhe detyrimet e shtetit që ka marrë me ratifikimin e Konventës.

PENGESAT DHE VËSHTIRËSITË MË TË MËDHA PËR GRATË DHE VAJZAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA QË JANË VIKTIMA TË DHUNËS

Të pyetur se cilat konsiderojnë se janë pengesat më të mëdha për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara që pësojnë dhunë, të anketuarat që morën pjesë në intervista dhe grupet e fokusit fillimisht e veçuan varësinë ekonomike (“*më e rëndësishmja është situata materiale*”²¹³, “*ata që nuk punojnë janë të privuar nga e drejta në të gjitha aspektet*”²¹⁴). Më tutje, u veçuan paragjykimet ndaj personave me aftësi të kufizuara që fillojnë në familjet e tyre që kur janë fëmijë (“*shumica e prindërve i trajtojnë fëmijët e tyre sikur nuk mund të bëjnë asgjë vetë*”²¹⁵, “*që në moshë të re i mësojnë të ecin me kokën ulur në jetë*”²¹⁶), si dhe varësia e tyre nga kujdesi prindëror. Më pas ishte mungesa e informacionit, mosgatishmëria e institucioneve për t’u përgjigjur nevojave të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara (“*nëse i akomodojnë në strehim, nuk mund të komunikojnë atje, nuk mund të thonë se janë të uritura*”²¹⁷), stigma dhe turpi për të kërkuar ndihmë publikisht, njohja e pamjaftueshme e të drejtave të tyre (“*u ndalohen shumë gjëra për të cilat nuk janë as të vetëdijshme se është dhunë*”²¹⁸), si dhe mosnjohja dhe mospranimi i dhunës.

27 nga gjithsej 32 të anketuar nga NJVL-ja që iu përgjigjën pyetësorit online konsiderojnë se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë të diskriminuara në vendin tonë, 29 konsiderojnë

213 Intervistë 2 (17.08.2021)

214 Intervistë 12 (07.09.2021)

215 Grupi i fokusit 10.09.2021

216 Intervistë 6 (31.08.2021)

217 Intervistë 2 (17.08.2021)

218 Grupi i fokusit 10.09.2021

se në vendin tonë nuk ka servise të mjaftueshme të cilat janë në dispozicion për gratë dhe vajzat viktime të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. 25 konsiderojnë se të drejtat dhe mirëqenia e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara nuk mbulojnë mjaftueshëm në zgjidhjet dhe politikat tona ligjore. Pothuajse një numër i barabartë i të anketuarve konsiderojnë se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara kanë ose nuk kanë mundësi të përfshihen në jetën publike në komunitetin e tyre (15 dhe 17 në mënyrë përkatëse). Shumica e të anketuarve konsiderojnë se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara intelektuale nuk pranohen në mjedisin ku jetojnë (21 përkundër 11). Përfundimisht, 25 nga të anketuarit konsiderojnë se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara nuk mund të vendosin në mënyrë të pavarur për jetën e tyre.




Si sfidat më të mëdha me të cilat ballafaqohen vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara në lidhje me përvojën e dhunës me bazë gjinore, shumica e të anketuarve nga NJVL-ja zgjedhën frikën (27), mungesën e vetëbesimit (26), mungesën e besimit në institucionet (23), si dhe mosnjohjen me mundësitë e mbështetjes dhe serviseve të disponueshme (21).



Sipas të anketuarve nga Trupi Koordinues për Zbatimin e KDPAK-së, mosbesimi në institucionet është problemi më i madh me të cilin ballafaqohen gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara. Më tutje, problemet e mëdha janë mospasja qasje në serviset, mungesa e vetëbesimit, frika, mosnjohja e konceptit të DHBGJ-së, pranimi i dhunës dhe mosnjohja e çështjes brenda kornizës ligjore.



Të gjithë të anketuarit nga Trupi Koordinues për Zbatimin e KDPAK-së konsiderojnë se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë të diskriminuara, të gjithë konsiderojnë se nuk ka servise të mjaftueshme dhe në dispozicion për gratë dhe vajzat viktime të DHBGJ-së dhe dhunës në familje, 6 konsiderojnë se të drejtat dhe mirëqenia e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara nuk janë mjaftueshëm të mbuluara në zgjidhjet dhe politikat tona ligjore, 5 konsiderojnë se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara nuk kanë mundësi të përfshihen në jetën publike në komunitetin e tyre, të gjithë konsiderojnë se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara intelektuale nuk pranohen në mjedisin ku jetojnë dhe 4 konsiderojnë se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara nuk mund të vendosin në mënyrë të pavarur për jetën e tyre.



Sipas përfaqësuesve / përfaqësuesve të OC-së që iu përgjigjën pyetësorit online, sfidat kryesore me të cilat përballen gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara në lidhje me DHBGJ-në janë: mospasja qasje në serviset dhe mosnjohja e grave me mundësitë për ndihmë dhe serviset e disponueshme (nga 12 përgjigje). Më tutje, si pengesë e madhe njihet frika (11 përgjigje), e ndjekur nga mosbesimi në institucionet, pranimi i dhunës dhe mosbesimi në institucionet (nga 9 përgjigje). Më pak të anketuar konsiderojnë se mosnjohja e çështjes në kornizën ligjore është pengesë, dhe në mënyrë shtesë theksohen edhe varësia financiare e grave dhe mungesa e mjeteve për kuadrin e trajnuar në organizatat që ofrojnë ndihmë dhe mbështetje.

NDIKIMI I KOVID-19 NË JETËN E GRAVE DHE VAJZAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE SHFAQJA E DHUNËS

Pasoja më e madhe e krizës me Kovid-19 dhe masave të miratuara për mbrojtjen dhe parandalimin e infeksionit, sipas të anketuarave të përfshira në hulumtim, është izolimi edhe më i madh i grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në shtëpitë e tyre (“e mbyllur në shtëpi, nuk duhet të rehabilitohesh, nuk duhet të dalësh... si në arrest shtëpie”²¹⁹).


Një numër i madh i grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara nuk i marrin informacionet e nevojshme nga personat mjekësorë për rreziqet dhe efektet e vaksinimit kundër Kovid-19, ndaj masat për të kufizuar qasjen e personave të pavaksinuar kontribuojnë më tej në stigmatizimin dhe izolimin e tyre. Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara ndihen të harruara nga institucionet dhe janë lënë të përballen vetë me virusin dhe efektet e tij.

Për gratë dhe vajzat me dëmtim të dëgjimit, problemi më i madh gjatë krizës është mbajtja e maskave, të cilat, së bashku me mungesën e interpretuesve të gjuhës së shenjave, e bëjnë edhe më të vështirë komunikimin (“isha në situatë ku ndihesha një në turmë njerëzish”²²⁰). Kjo e bën edhe më të vështirë qasjen në institucione dhe shërbime të caktuara për këtë grup grash dhe vajzash me aftësi të kufizuara.

Për sa i përket pyetjes nëse gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë përfshirë në masat e marra për zbutjen e ndikimit të krizës me Kovid-19, të gjitha të anketuarat janë përgjigjur se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara nuk janë veçuar si grup më vete me asnjë masë, përkatësisht nuk u miratua asnjë masë që i drejtohej drejtpërdrejt këtij grupi. Ato konsiderojnë se edhe ato masa që i mbulojnë personat me aftësi të kufizuara në përgjithësi nuk janë të mjaftueshme dhe nuk kanë ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e gjendjes së personave me aftësi të kufizuara. E vetmja masë që synonte drejtpërdrejt personat me aftësi të kufizuara ishte leja për të lëvizur gjatë orës policore. Për këtë masë, disa të anketuara theksuan se nuk ishte menduar mirë, duke i vënë të gjithë personat me aftësi të kufizuara nën një “ombrellë”, si dhe se me këtë rindarje të personave me aftësi të kufizuara kontribuohet në stigmatizimin dhe stereotipizimin.

Pjesa më e madhe e të anketuarave nga NJVL-ja (14) konsiderojnë se situata me dhunën ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara është përkeqësuar gjatë krizës me virusin Kovid-19, 10 prej tyre konsiderojnë se është përkeqësuar dukshëm.

A konsideroni se gjendja me dhunën ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara u përkeqësua gjatë pandemisë me Kovid-19? (32 responses)




219 Grupi i fokusit 10.09.2021

220 Grupi i fokusit 24.07.2021 (2)

Te përfaqësuesit e OC-së që iu përgjigjën pyetësorit online ka mbizotëruar perceptimi se situata e dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara gjatë krizës me COVID-19 është përkeqësuar (6 nga të anketuarit janë përgjigjur se situata është përkeqësuar, 5 nuk e dinë, dhe 2 u përgjigjën se nuk ka ndryshim).

Sipas punës së Organizatës suaj, a u përkeqësua gjatë pandemisë me COVID-19 gjendja me dhunën ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara? (32 responses)



“Në përgjithësi, është përkeqësuar për të gjitha kategoritë e grave dhe vajzave që janë të ekspozuara ndaj dhunës, për shkak të mbylljes në shtëpi, punës së rëndë dhe mosfunksionimit të institucioneve, qasjes në to dhe në shërbimet e domosdoshme, përkeqësimit të situatës ekonomike etj. Këto kushte kanë ndikim edhe më të keq në sigurinë dhe shëndetin e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara”.

“Një numër i madh i vajzave dhe grave që janë viktime të dhunës u mbyllën në shtëpitë e tyre me dhunuesit, në nivel nacional pati rritje të dhunës në familje, femicideve dhe shqetësimit seksual online në nivel nacional. Mungesa e strehimoreve dhe mosveprimi dhe veprimi joadekuatë i policisë mundësuan që gratë dhe vajzat (edhe) gjatë pandemisë kontribuan në rritjen e rasteve të DHBGJ-së”.

MASAT URGJENTE PËR PËRMIRËSIMIN E SITUATËS SË GRAVE DHE VAJZAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA QË JANË VIKTIMA TË DHUNËS

Më shumë se gjysma e të anketuarave që morën pjesë në intervistat dhe grupet e fokusit (48 nga 75 ose 64%) treguan nevojën për të folur për dhunën dhe për të edukuar gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara përmes trajnimeve, evenimenteve, programeve, etj. (“nuk ka trajnime për dhunë, nuk flitet, gjithmonë ka probleme më të mëdha se dhuna”²²¹). Sipas të anketuarave, edukimi duhet të përfshijë identifikimin e dhunës, trajtimin e dhunës, reagimin, si dhe parandalimin e dhunës. Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara përmes këtyre edukimeve duhet të marrin informacionet themelore se si të identifikojnë dhunën, si të reagojnë dhe ku të drejtohen për ndihmë dhe mbështetje. Edukimi është i nevojshëm edhe për prindërit dhe është i nevojshëm të punohet edhe me meshkujt, përkatësisht të ndërgjegjësohen për ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme dhe të lumtura. Me prindërit duhet të punohet që në fillim, kur do të kenë fëmijë me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të dinë se çfarë të bëjnë dhe fëmija të zhvillohet në person të pavarur²²². Arsimi seksual është, gjithashtu, i nevojshëm urgjentisht, i cili do të përfshinte edhe prindërit për këto grupe që nuk janë të pavarura. Shoqatat dhe organizatat në të cilat janë anëtare gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara duhet të fuqizohen dhe inkurajohen për t’i zbatuar trajnimet dhe seminarat e tilla.

12 të anketuara kanë identifikuar nevojën më urgjente për sensibilizimin dhe edukimin e të punësuarve në institucionet për punën me gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, fuqizimin e përgjigjes institucionale ndaj dhunës, si dhe zbatimin e zgjidhjeve ligjore në lidhje me dhunën dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, për gratë dhe vajzat që nuk dëgjojnë, siç u theksua më lart, disponueshmëria e interpretuesit në institucionet është me rëndësi të madhe.

9 të anketuara e theksuan nevojën për fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara dhe nevojën për mbështetjen e shtetit në drejtim të stabilitetit financiar. Varësia financiare është identifikuar si një nga arsyet më të mëdha pse gratë mbeten në mjedise të dhunshme, kështu që pavarësia ekonomike do të kontribuojë në uljen e dhunës, përkatësisht lehtësimin e viktimave për t’u larguar nga mjedisi i dhunshëm.

Përfundimisht, të anketuarat konsiderojnë se është e nevojshme të punohet me gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, të aktualizohet çështja e dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara dhe t’i inkurajojë ato të flasin për përvojat dhe dëshmitë e tyre (“nuk duhet të heshtet, mos të dëgjojnë fqinjët”²²³). Duhet të punohet për të thyer stigmën dhe turpin që lidhet me dhunën (“mos t’u thuhet të heshtin dhe të durojnë, të funksionojë ndërgjegjja”²²⁴). Për këtë qëllim, disa nga të anketuarat e theksuan nevojën që psikologët të përfshihen në punën e shoqatave dhe organizatave që punojnë me gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara.

Për sa i përket asaj se çfarë duhet të sigurohet për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara të cilat janë viktime të dhunës për mbrojtjen dhe mbështetjen e tyre efikase, një numër i barabartë i të anketuarve nga NJVL-ja (21) zgjodhën “ndërgjegjësimin e të punësuarve në institucionet për njohjen e dhunës / dhunës potenciale” dhe “edukimin dhe ndërgjegjësimin

221 Intervistë 4 (24.08.2021)

222 Intervistë 3 (24.08.2021)

223 Intervistë 11 (04.09.2021)

224 Grupi i fokusit 03.09.2021 (2)

e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara për konceptin e DHBGJ-së”. Për 20 prej të anketuarve të NJVL-së më e rëndësishmja është qasja në serviset, po për të njëjtin numër (20) më e rëndësishmja është forcimi i vetëbesimit të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, për 19 “ndërgjegjësimi dhe edukimi i prindërve / partnerëve / të afërmeve të vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara për DHBGJ-në”, 18 konsiderojnë se duhet të bëhet fushatë për prezantimin e serviseve në dispozicion, ndërsa të paktën (16) konsiderojnë se mundësitë për fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara duhet të avancohen. 16 nga të anketuarit konsiderojnë se të gjitha masat e përmendura janë po aq të rëndësishme dhe të nevojshme.



Pothuajse të gjithë përfaqësuesit e Trupit Koordinues për Zbatimin e KDPK-së (6 nga gjithsej 7) janë përgjigjur se të gjitha masat e përmendura janë të rëndësishme për të mundësuar.



Pjesa më e madhe e përfaqësuesve / përfaqësueseve të OC-së që iu përgjigjën pyetësorit online (11 nga gjithsej 13) konsiderojnë se të gjitha masat e përmendura janë të rëndësishme për t'u mundësuar grave dhe vajzave të cilat janë viktime ose viktime të mundshme të dhunës për mbrojtje dhe parandalim më efikas të dhunës.



Në mënyrë plotësuese, përmenden: edukimi si obligim i detyrueshëm i të gjitha qendrave të fuqisë, futja e ableizmit si vepër penale, dënime të larta për secilin, duke i përfshirë edhe prindërit dhe bashkëshortët e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara dhe rregullativa ligjore dhe njohja e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara si grup i veçantë vulnerabil dhe zbatimi i ligjit.

KONKLuzionet

Përkundër ratifikimit të KDKPAK-së dhe KS-së, shteti ngadalë po shkon drejt harmonizimit të legjislacionit me obligimet që dalin prej tij. Sipas raporteve ndërkombëtare dhe nacionale dhe kornizave strategjike, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë ende një nga grupet më të diskriminuara në shoqëri, e cila është edhe më e cënueshme nga dhuna, maltretimi dhe keqpërdorimi.

Sipas hulumtimit, pjesa më e madhe e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara bëjnë dallimin midis dhunës dhe diskriminimit, ndërsa lloji më i njohur i dhunës është dhuna fizike. Lloje të caktuara të dhunës dhe shqetësimit, të tilla si shqetësimi seksual në vendin publik, ndjekja, shantazhi dhe të ngjashme, ende nuk njihen dhe konsiderohen si pjesë normale dhe të zakonshme të jetës së grave. Gjithashtu, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë përgjithësisht të panjohura dhe nuk njohin diskriminimin dhe ableizmin sistematik, të cilat janë gjithashtu pjesë e normalizuar e përditshmërisë së tyre që në moshë të vogël. Kujdesi prindëror i vendos vajzat me aftësi të kufizuara në situatë të mbrojtjes dhe izolimit të tepruar nga mjedisi, gjë që çon në varësinë e tyre nga kujdesi i tillë gjatë gjithë jetës dhe pamundësinë për jetë të pavarur dhe individuale. Në përgjithësi, mungojnë programet dhe aktivitetet edukative për ndërgjegjësimin e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, si dhe të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, për llojet e ndryshme të diskriminimit dhe dhunës me bazë gjinore.

Për sa u përket pikëpamjeve tradicionale dhe stereotipike për rolet gjinore në familje, vërehet një hendek brezash midis grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara të përfshira në hulumtim. Pikëpamja më e zakonshme të gratë e moshuara me aftësi të kufizuara është se në rastet e dhunës, një pjesë e madhe e fajit i takon viktimës, për shkak të mburrjes, shkaktimit të xhelozisë, veshjes apo sjelljes provokuese etj., ndërsa vajzat më të reja e kundërshtojnë këtë qëndrim dhe konsiderojnë se duhet të jenë të lira, të vishen dhe të sillen si të duan pa frikë se mund të përjetojnë dhunë apo shqetësim. Për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, stabiliteti ekonomik është faktori më i rëndësishëm për largimin nga marrëdhënia e dhunshme, përkatësisht aftësia e kufizuar nuk shihet si faktor vendimtar për të qëndruar në marrëdhënie të dhunshme. Është gjithashtu e rëndësishme të forcohet dhe të ndërtohet vetëbesimi i vajzave me aftësi të kufizuara që në moshë të vogël dhe të shmanget mbrojtja e madhe nga prindërit.

Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara përballen me një sërë barrierash që e pengojnë ose vështirësojnë pjesëmarrjen e tyre të barabartë në jetën shoqërore. Barrierat e para me të cilat përballen gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, të cilat janë indikatorë të diskriminimit sistematik dhe institucional, janë mospërputhshmëria e hapësirave publike për llojet e ndryshme të aftësisë së kufizuar dhe padisponueshmëria e institucioneve dhe serviseve. Prandaj, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara varen kryesisht nga anëtarët e afërt, përkatësisht femrat e familjes, të cilat u ofrojnë mbështetjen dhe kujdesin e nevojshëm dhe të cilat për to i lënë nevojat e tyre. Nevoja për shoqëri të vazhdueshme e pengon edhe zhvillimin e vajzave me aftësi të kufizuara në lidhje me seksualitetin. Seksualiteti dhe nevojat seksuale të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara janë tabu, ndërsa tema e arsimimit seksual dhe asistentëve seksualë shpesh shmanget.

Lloji më i zakonshëm i dhunës që përjetojnë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara është dhuna psikologjike, në formën e poshtërimit, ofendimit, kërcënimit dhe të ngjashme. Përvojat e para të dhunës i kanë në familje, më së shpeshti nga anëtarët meshkuj të familjes, përkatësisht nga babai. Një pjesë e konsiderueshme e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara e kanë kontaktin e parë me dhunën fizike në rolin e dëshmitares, dhe më pas shpesh bëhen edhe viktimat. Perceptimet dhe qëndrimet e shprehura në familje se vajzat me aftësi të kufizuara janë të paafta, kontribuojnë në izolimin e tyre dhe pengojnë pavarësinë dhe fuqizimin e tyre. Ato vajza dhe gra me aftësi të kufizuara që kanë arritur të bëhen të pavarura dhe të "qëndrojnë në këmbët e tyre" shpeshherë refuzohen nga familjet e tyre dhe nuk kanë mbështetje. Gjithashtu, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara e gjejnë shpesh veten fajtorë për dhunë, duke ndjerë se gjendja e tyre e vështirëson jetën së bashku dhe duke e parë veten si "barrë" për personat e afërt.

Për sa i përket përhapjes së dhunës, vërehet kontrast i dukshëm mes dëshmitave të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara që kanë marrë pjesë në hulumtim dhe përgjigjeve të marra nga institucionet në lidhje me rastet e evidentuara të dhunës. Arsyeja e numrit të vogël të rasteve të evidentuara të dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara është se institucionet shpesh nuk i ndajnë të dhënat për aftësinë e kufizuar, siç është rasti me PP-në që nuk i "përpunojnë në mënyrë specifike veprat penale të dhunës në familje dhe llojit tjetër të dhunës ndaj grave dhe personave me aftësi të kufizuara". Kjo është në kundërshtim me udhëzimet e KS-së që kërkon mbledhjen e të dhënave statistikore të ndara për të gjitha format e dhunës ndaj grave të mbuluara nga Konventa, duke përfshirë edhe gratë me aftësi të kufizuara. Numri i vogël i rasteve të evidentuara është për shkak të mosbesimit në institucionet, si dhe kulturës së shmangies së dhunës për shkak të turp-it dhe frikës nga stigmatizimi.

Sipas deklaratave të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara që morën pjesë në hulumtim, në institucionet, shtëpitë grupore apo familjet kujdestare, dhuna është normalizuar në masë të madhe si dukuri e përditshme, ndërsa programet për fuqizimin dhe edukimin e vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara pothuajse nuk ekzistojnë ose, nëse ekzistojnë, i përforcojnë stereotipet gjinore. Kjo është në kundërshtim edhe me përgjigjet e institucioneve për rastet që janë evidentuar dhe sipas të cilave është vepruar. Gjithashtu, mund të vërehet edhe kultura e mosndëshkimit ose dënimeve të ulëta që nuk janë në përputhje me legjislacionin.

Serviset ekzistuese për të ndihmuar dhe mbështetur viktimat e dhunës nuk janë të disponueshme për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara. Në mënyrë plotësuese, sfida është edhe mungesa e informacioneve dhe qëndrimeve diskriminuese të shoqërisë, përfshirë edhe ato të administratorëve publikë, mbrojtjes shëndetësore dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve. Paraqitja e dhunës nga gruaja ose vajza me aftësi të kufizuara shpesh nuk merret seriozisht për shkak të pikëpamjeve stereotipike dhe diskriminuese të personave të punësuar në shërbimet shtetërore se gratë me aftësi të kufizuara nuk mund ta njohin dhunën. E gjithë kjo përsëri kontribuon që gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara mos ta paraqesin dhunën, dhe në këtë mënyrë edhe mos ta marrin ndihmën dhe mbështetjen që u takon ligjërisht.

Në përgjithësi, nëse e kemi parasysh gjendjen faktike me qasjen e institucioneve dhe hapësirave publike në vend dhe nëse e krahasojmë me përgjigjet e përfaqësuesve të NJVL-së dhe anëtarëve të Trupit Koordinues për Zbatimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, mund të konkludohet se shumë prej tyre kanë njohuri të paplota se çfarë mbulon disponueshmëria sipas KDKPAK-së. Serviset për të mbështetur viktimat dhe / ose kryerësit me aftësi të kufizuara shihen ende si servise të veçanta që nuk

duhet të jenë pjesë e serviseve ekzistuese ose pjesë e serviseve të reja që do të kishin qasje ndërsektoriale. Mund të vërehet se në nivel lokal ekzistojnë programe, shërbime apo servise të caktuara që synojnë ndihmën dhe mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, si ofrimi i asistentëve personalë, mbështetja financiare e njëhershme, bursat, planet arsimore individuale, e të ngjashme. Megjithatë, shqetësues është fakti që gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara nuk janë target grup i veçantë i asnjë programi, servisi apo shërbimi.

Suksesi i përpjekjeve për aktualizimin e problemit të dhunës me bazë gjinore në vitet e fundit është reflektuar në njohjen e tematikës dhe njohjen me Konventën e Stambollit të gjithë të anketuarit. Nga përgjigjet shihet dallimi me njohuritë e të anketuarve në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, përkatësisht KDPAK-ja, të cilat janë shumë më të vogla. Për sa u përket trajnimeve të fokusuara në çështjen e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, përfaqësuesit e organizatave civile preferojnë të vizitojnë trajnime të tilla, ndërsa në sektorin publik trajnime të tilla pothuajse nuk ndiqen nga përfaqësuesit që iu përgjigjen pyetësorit.

Për sa i përket integritet të personave me aftësi të kufizuara, vërehet se shumë pak persona me aftësi të kufizuara janë të punësuar në institucionet, ndërsa në organizatat civile personat me aftësi të kufizuara janë edhe më pak të përfaqësuar. Në sektorin civil, personat me aftësi të kufizuara janë të përfshirë dhe punojnë kryesisht në tematika që kanë të bëjnë vetëm me aftësinë e kufizuar dhe në organizatat e specializuara. Personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, nuk janë të përfshirë në krijimin e politikave dhe masave që nuk janë të dedikuara posaçërisht për personat me aftësi të kufizuara, por i mbulojnë.

Organizatave civile ofrojnë përfshirje më të madhe të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në aktivitetet dhe programet e tyre, por përfshirja edhe te organizatat civile është jokonsistente dhe kryesisht për aktivitetet që kanë të bëjnë konkretisht me aftësinë e kufizuar, dhe kryesisht varet nga buxheti i planifikuar dhe në dispozicion. Organizatat civile nuk kanë praktikë të hartimit të materialeve dhe përmbajtjeve në formatin e disponueshëm që plotëson konstatimin se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë pothuajse plotësisht të panjohura me OC-të që punojnë në problematikën e dhunës me bazë gjinore dhe aktivitetet e tyre dhe shumica e tyre nuk kanë marrë kurrë dhe as nuk kanë parë asnjë material për dhunën.

Pengesat dhe vështirësitë më të mëdha për gratë me aftësi të kufizuara të cilat janë viktime të dhunës janë varësia ekonomike, paragjykimet, mungesa e informacionit, papërgatitja e institucioneve për t'u përgjigjur nevojave të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, stigma dhe turpi për të kërkuar ndihmë publikisht, njohja e pamjaftueshme për të drejtat e tyre, si dhe mosnjohja dhe mospranimi i dhunës. Sipas personave të punësuar në institucionet, sfidat dhe vështirësitë më të mëdha me të cilat ballafaqohen vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara ndodhen te vetë ata, përkatësisht frika, mungesa e vetëbesimit, mungesa e informacionit për serviset në dispozicion, si dhe mosbesimi ndaj institucioneve.

Pothuajse të gjithë të anketuarit janë dakord se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë të diskriminuara në vendin tonë, se nuk ka servise të mjaftueshme për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara të cilat janë viktime të dhunës me bazë gjinore, se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara nuk mund të vendosin vetë për jetën e tyre, si dhe se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara nuk pranohen në mjedisin ku jetojnë. Mendimet janë të ndara për përf-

shirjen e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në jetën publike në komunitetet e tyre dhe mbulimin e të drejtave të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në ligjet tona.

Te të anketuarit mbizotëron mendimi se gjatë krizës me virusin KOVID-19, situata e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në lidhje me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje është përkeqësuar. Nëse kjo çështje merret në konsideratë me çështjen e programeve, serviseve dhe shërbimeve të synuara posaçërisht për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, mund të konkludohet se ky problem është neglizhuar plotësisht pavarësisht ndërgjegjësimit të faktorëve për ekzistimin e tij.

Për sa i përket asaj që nevojitet urgjentisht për përmirësimin e situatës dhe sigurimin e mbrojtjes dhe mbështetjes për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara të cilat janë viktime të dhunës, nuk mund të veçohet asnjë masë që të anketuarit e konsiderojnë si prioritet, përkatësisht shumica e të anketuarve janë përgjigjur se të gjitha masat e propozuara janë të rëndësishme dhe të nevojshme, gjë që konfirmon neglizhencën e plotë të problemit të dhunës ndaj vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara, përkatësisht mungesën e masave përkatëse për mbrojtjen dhe mbështetjen e tyre pavarësisht ndërgjegjësimit për nevojën e masave të tilla.

REKOMANDIMET

Për sa i përket kornizës ligjore për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, nevojitet:

- Zbatimi i plotë i dispozitave të KS-së dhe KDPAK-së, me referimin e tyre reciprok, alokimet buxhetore në planet e veprimit dhe strategjike, si dhe ndjekjen e rregullt të zbatimit të tyre.
- Avancimi dhe harmonizimi i legjislacionit me qëllim të përdorimit të qasjeve ndërsektoriale dhe transformuese gjinore dhe duke marrë parasysh ndikimin e karakteristikave të ndryshme të identitetit që lidhen me aftësinë e kufizuar ndaj diskriminimit dhe dhunës.
- Harmonizimi i Kodit Penal me KS-në në lidhje me format specifike të dhunës që ndodhin ndaj personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë njohjen e ableizmit, si dhe kualifikimin e veprave penale ndaj personave me aftësi të kufizuara të kryera vetëm për shkak të disponueshmërisë së bazuar në aftësinë e kufizuar të tyre si vepra të urrejtjes.
- Njohja dhe vendosja e zgjidhjeve dhe masave ligjore dhe institucionale përkatëse për luftën kundër diskriminimit institucional dhe sistematik.
- Njohja e natyrës strukturore të dhunës ndaj grave si një nga mekanizmat kryesorë me anë të të cilit gratë mbahen në pozicion vartës në shoqëri, veçanërisht gratë me aftësi të kufizuara.
- Miratimi i masave të orientuara drejt luftës kundër seksizmit dhe normave tradicionale të shoqërisë patriarkale.
- Sigurimi i përfshirjes së garantuar të organizatave civile që i përfaqësojnë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara në krijimin, zbatimin dhe kontrollimin e ligjeve dhe politikave për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave.
- Zbatimi i dispozitave dhe rekomandimeve të KS-së për mbledhjen dhe analizën e detyrueshme të të dhënave të ndara për situatën e grave me aftësi të kufizuara nga të gjithë faktorët e përfshirë në mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhunës në familje.
- Vendosja e sistemit për përfshirjen e masave përkatëse të orientuara drejt mbrojtjes dhe mbështetjes së grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në situata krize dhe të jashtëzakonshme.

Për sa i përket fuqizimit të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, nevojitet:

- Vendosja e programeve për edukimin e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara të ndryshme për llojet e dhunës dhe diskriminimit, si dhe për shërbimet dhe serviset në dispozicion.
- Miratimi dhe zbatimi i masave për të siguruar zhvillimin, avancimin dhe fuqizimin e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara nëpërmjet përfshirjes sistematike të interesave dhe të drejtave të tyre në të gjitha planet nacionale të veprimit, strategjitë dhe politikat në lidhje me gratë, fëmijët dhe aftësinë e kufizuar, si dhe në planet sektoriale që lidhen, për shembull, me barazinë gjinore, shëndetin, dhunën, arsimin, pjesëmarrjen politike, punësimin, qasjen në drejtësi dhe mbrojtjen sociale.
- Miratimi i masave efektive për t'u dhënë grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara qasje në mbështetjen që mund të kenë nevojë për të realizuar plotësisht aftësinë e tyre afariste, për të dhënë pëlqimin e lirë dhe të informuar dhe për të miratuar vendime për jetën e tyre.

- Përforcimi i përpjekjeve për të përmirësuar qasjen në arsimin cilësor për vajzat me aftësi të kufizuara, si mjet për t'u përballur me shkaqet themelore të dhunës që lindin nga qëndrimet vartëse dhe fajësimi i viktimave dhe reduktimi i cenueshmërisë së grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara.
- Ndërmarrja e masave urgjente për të tejkaluar të gjitha barrierat që e parandalojnë ose kufizojnë pjesëmarrjen e grave me aftësi të kufizuara në krijimin, zbatimin dhe ndjekjen e të gjitha programeve që kanë ndikim në jetët e tyre.
- Sigurimi që qëndrimet dhe mendimet e grave me aftësi të kufizuara, si dhe të vajzave me aftësi të kufizuara, përfshihen në proceset, nëpërmjet organizatave të tyre përfaqësuese si dhe nëpërmjet vetë-përfaqësuesve.
- Miratimi i masave afirmative me qëllim të zhvillimit, avancimit dhe fuqizimit të grave me aftësi të kufizuara, në konsultim me organizatat e grave me aftësi të kufizuara, për të përballur pabarazitë dhe për të siguruar që gratë me aftësi të kufizuara të gëzojnë mundësi të barabarta me të tjerët. Masat e tilla duhet të merren veçanërisht në lidhje me qasjen në drejtësi, eliminimin e dhunës, respektimin e shtëpisë dhe familjes, shëndetin seksual dhe të drejtat riprodhuese, shëndetësinë, arsimin, pjesëmarrjen në jetën publike dhe politike, punësimin dhe mbrojtjen sociale.
- Informimi i grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara për shërbimet në dispozicion nëpërmjet kanaleve dhe mediave të ndryshme, me materiale të përshtatura për sa i përket disponueshmërisë, gjuhës, terminologjisë, strategjisë së komunikimit dhe porosive.
- Vendosja e programeve për edukimin dhe mbështetjen e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, me fokus të veçantë në fuqizimin e vajzave me aftësi të kufizuara.

Për sa i përket përgjigjes institucionale të dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, nevojitet:

- Sigurimi i disponueshmërisë së plotë të institucioneve dhe shërbimeve publike dhe private të përdorura nga gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, duke i marrë parasysh llojet e ndryshme të aftësisë së kufizuar.
- Avancimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërsektorial dhe ndërinstitutional në nivel nacional dhe lokal me përfshirjen aktive të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të personave me aftësi të kufizuara.
- Organizimi i trajnimeve për ofruesit e shërbimeve të DHBGJ-së me fokus të veçantë në konceptin e dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, si dhe konceptin e barazisë, mosdiskriminimit dhe aftësimin përkatës.
- Organizimi i trajnimeve për ofruesit e shërbimeve të DHBGJ-së mbi standardet e zbatueshme të të drejtave të njeriut dhe për identifikimin dhe luftën kundër normave dhe praktikave diskriminuese në mënyrë që të mund të ofrojnë vëmendjen, mbështetjen dhe ndihmën përkatëse për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara.
- Ndjekja e institucioneve dhe sigurimi i qasjes në dëmshpërblimin për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara të cilat janë të ekspozuara ndaj dhunës me bazë gjinore jashtë dhe në institucionet, në mënyrë që serviset për mbështetje të mos lënë hapësirë për keqpërdorim ose shfrytëzim të mundshëm të personave me aftësi të kufizuara ose ndonjë dhunë ndaj tyre.
- Integrimi i nevojave dhe sfidave specifike të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në të gjitha trajnimet për nëpunësit dhe nëpunëset policore se si të mbrojnë dhe mbështesin viktimat, të zbatojnë qasje të përqendruar te viktimat dhe të përmirësojnë sistemet e njoftimit. Puna bashkë me gratë dhe vajzat me

aftësi të kufizuara për të rritur ndërgjegjësimin e policisë për nevojat e tyre specifike, me qëllimin shtesë për të sfiduar dhe kundërshtuar stereotipet për këto gra.

- Vendosja e mekanizmave për të mbështetur dhe inkurajuar dhe lehtësuar paraqitjen e dhunës nga gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara.
- Forcimi i kapaciteteve të sistemit gjyqësor, nëpërmjet edukimit të vazhdueshëm të gjykatësve dhe prokurorëve publikë për DHBGJ-në dhe KS-në, si dhe shfaqjes specifike të DHBGJ-së ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara.
- Prioritizimi i mbështetjes financiare për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara të cilat janë viktime të dhunës dhe mundësimi i programeve të trajnimit dhe edukimit për (ri)integrimin në shoqëri dhe përmes masave aktive të punësimit.

Për sa i përket informimit publik dhe pikëpamjeve dhe perceptimeve në lidhje me dhunën ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, nevojitet:

- Hartimi i materialeve udhëzuese që do të shpjegojnë aftësimin përkatës si institut juridik kundër diskriminimit, si dhe mënyrat e realizimit të tij.
- Ndërmarrja e masave për të rritur ndërgjegjësimin publik dhe për të shkëmbyer dhe promovuar informacionet mbi DHBGJ-në në përgjithësi dhe në mjediset rurale në veçanti dhe në formatet e disponueshme për personat me aftësi të kufizuara.
- Rritja e ndërgjegjësimin për të drejtën për jetën private dhe familjare të personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë edhe seksualitetin e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, si dhe të drejtën për martesë dhe mëmësi.
- Fushatat publike për ndërgjegjësimin mbi problemin e diskriminimit dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara.
- Krijimi i diskursit publik mbi dhunën dhe diskriminimin ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat me qëllim të tejkalimit të stigmatizimit dhe turpërimit.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- Balshiqevska, M. dhe Avramovska Nushkova, A. (2020) Raporti i progresit për Republikën e Maqedonisë së Veriut në zbatimin e Planit Nacional të Veprimit për zbatimin e Konventës së Stambollit, Rrjeti nacional kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Në dispozicion në: <http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2021/02/NAP-finalen.pdf>
- Veliçkovski, R. (2012) Shëndeti seksual dhe riprodhues dhe personat me aftësi të kufizuara fizike - Raporti i vlerësimit të nevojave për shërbime, Hera. Në dispozicion në: http://hera.org.mk/wp-content/uploads/2014/02/izvestaj_poprecenost_rz.pdf
- CouncilofEurope(2021) Report to the Government of North Macedonia on the visit to North Macedonia carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT) from 2 to 10 December 2020. Në dispozicion në: <https://rm.coe.int/1680a359cb>
- Committee on the Elimination of Discrimination against Women (2017) General Recommendation No. 35 on gender based violence against women, updating general recommendation No. 19, U.N.Doc. C/GC/25.
- European Economic and Social Committee, The situation of women with disabilities [Exploratory opinion requested by the European Parliament], SOC/579. Në dispozicion në: <https://bit.ly/3o9S8wO>
- European Parliament (2004) Report on the situation of women from minority groups in the European Union (2003/2109(INI)). Në dispozicion në: <https://bit.ly/30WPd2S>
- European Commission, 5.3.2020, A Union of Equality: Gender Equality Strategy 2020-2025, COM(2020) 152 final. Në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020DC0152&from=EN>
- Instituti për të Drejtat e Njeriut (2020) Situata e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në dispozicion në: <https://bit.ly/3ELNrQS>
- Jovanovska, B., Petkovska, N. (2021) Ndikimi i krizës së Covid-19 te personat me aftësi të kufizuara në Maqedoninë e Veriut, Fondacioni Westminster për Demokraci, Maqedonia e Veriut.
- Jovanovska, B. (2020) Fuqizimi juridik në komunitet në procesin e deinstitutionalizimit: raport.Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.
- Kotevska, B., Ançevska, E., Kacarska, S. (2016) Arti i mbijetesës: Pabarazitë ndërseksionale në mbrojtjen sociale në Maqedoni - Rezultatet e hulumtimit empirik, EPI Shkup.
- Koçoska, E., Tërpevska, M. (2020) Udhëzuesi i aftësimin përkatës, Shkup: OSBE. Në dispozicion në: <https://www.osce.org/files/f/documents/d/6/446743.pdf>
- Koçoska, E., (2017) Dhuna ndaj personave me aftësi të kufizuara, Polio Plus - Shkup.
- Koçoska E., Jovanovska, B., Ortakovski T., Stanojkovska-Trajkovska, N., Georgievskaa, S. (2021) Analiza e situatës për çështjen e aftësisë së kufizuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, UNICEF (në versionin e punës).
- OSBE (2019) Hulumtimi i zbatuar nga OSBE-ja për dhunën ndaj grave në Maqedoninë e Veriut, Mirëqenia dhe Siguria e Grave, Maqedonia e Veriut: Raporti nga rezultatet.

- OSCE (2019) Well-being and safety of women, OSCE-led survey on violence against women – Experiences of disadvantaged women: Thematic Report. Në dispozicion në <https://bit.ly/30Xgnql>
- Komentimi i përgjithshëm nr. 3 (2016) për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, CRPD/C/GC/3, Në dispozicion në: <https://undocs.org/CRPD/C/GC/3>
- Komentimi i përgjithshëm nr. 9 (2010) për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në dispozicion në: <https://www.refworld.org/docid/461b93f72.html>
- Komentimi i përgjithshëm nr.13, Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve, CRC/C/GC/13, Në dispozicion në: <https://www.refworld.org/docid/4e6da4922.html>
- Komentimi i përgjithshëm nr. 2 i Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Në dispozicion në <https://bit.ly/2XEYYSZ>
- General Comment No. 2: Implementation of Article 2 by States Parties, 24 January 2008, CAT/C/GC/2. Në dispozicion në: <https://www.refworld.org/docid/47ac78ce2.html>
- General Comment No. 20: Prohibition of torture or other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment (article 7), Human Rights Committee, Forty-fourth Session, A/44/40, 10 March 1992. Në dispozicion në: <https://www.refworld.org/docid/453883fb0.html>
- General Comment No. 5 on living independently and being included in the community, Committee on the Rights of Persons with Disabilities, Eleventh session, CRPD/C/GC/5, 27 October 2017. Në dispozicion në: <https://digitallibrary.un.org/record/1311739?ln=en>
- Report of Paul Hunt, Special Rapporteur on the right of everyone to the enjoyment of the highest attainable standard of physical and mental health, E/CN.4/2005/51. Në dispozicion në: https://ap.ohchr.org/documents/dpage_e.aspx?si=E/cn.4/2005/51/Add.3
- Panayotova, K., Kochoska, E. (2020) Analysis: Work Assistance And Support For Employment of People With Disabilities Leaving Institutional Care.
- Petrovska, N. dhe Avramovski, D. (2021) Qasja juridike, financiare dhe fizike në drejtësi në gjykatat themelore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Koalicioni “Të gjithë për gjykim të drejtë”.
- Poposka, ZH. (2018) Interpretuesi i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara të Kombeve të Bashkuara, Polio Plus – Shkup. Në dispozicion në: https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/tolkuvac-un_konvencija.pdf
- Risteska, M. (2020) Analiza e ndikimeve të Kovid-SARS-19 mbi gjininë dhe diversitetet, OSBE. Në dispozicion në: <https://www.osce.org/files/f/documents/1/9/480413.pdf>
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM / Rec (2019) 1 “Parandalimi dhe lufta kundër seksizmit”, i miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, 27 mars 2019.
- Schulze, M. (2010) Understanding the UN Convention on the Rights of People with Disabilities, Handicap International. Në dispozicion në: https://www.internationaldisabilityalliance.org/sites/default/files/documents/hi_crpd_manual2010.pdf
- State Statistical Office and UNICEF (2020) 2018-2019 North Macedonia Multiple Indicator Cluster Survey and 2018-2019 North Macedonia Roma Settlements Multiple Indicator Cluster Survey, Survey Findings Report.
- Spasovska, S., Bornarova, S., Bogoevska, N., Ivanoski, B., Dauti, I., Georgievska, S. (2013) Doracak për zhvillimin e shërbimeve sociale për grupet vulnerable në komunitetet lokale, MPPS.
- Stamenkova-Trajkova, V., (2013) Paragjykimet ndaj personave me çrregullime psikike dhe përfshirja e tyre në tregun e punës (Disertacion doktorature), Universiteti “Shën Cirili dhe Metodi” - Shkup, Fakulteti Filozofik, Instituti për Punë Sociale dhe Politikë Sociale “Nënë Tereza”. Në dispozicion në: <https://repository.ukim.mk/bitstream/20.500.12188/2241/1/vlilievski2013.pdf>
- UN Women (2018) Public Perceptions of Gender Equality and Violence against Women, Infosheet.
- UNICEF and The European Union (2018) Inclusion of Children and Youth with Disabilities in Main stream Secondary Education.
- USAID (2012) Women with Disabilities in the Europe & Eurasia Region: Final Report. Në dispozicion në: <https://www.usaid.gov/sites/default/files/Women-with-Disabilities-EE-Region-FINAL-2012.pdf>
- Deklarata e përbashkët e Komitetit për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave dhe Komitetit të DPAK-së për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues dhe të Drejtat e Grave. Në dispozicion në: <https://bit.ly/3Ccewvw>
- PNV: Qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm, Pasqyra nacionale vullnetare, 2020, Kombet e Bashkuara. Në dispozicion në: <https://bit.ly/3b4mgUf>
- Rezoluta e Parlamentit Evropian e vitit 2018 për situatën e grave me aftësi të kufizuara (2018/2685(RSP). Në dispozicion në: https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-8-2018-0484_EN.html
- Report of the Special Rapporteur on torture and other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment, Juan E. Méndez, A/HRC/22/53. Në dispozicion në: <https://bit.ly/2ZZprek>
- Report of the Special Rapporteur on torture and other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment, Manfred Nowak A/HRC/7/3, 15 January 2008, f. 38. E Disponueshme në: <https://www.refworld.org/pdfid/47c2c5452.pdf>
-
- Interim report of the Special Rapporteur on torture and other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment, A/63/175. Në dispozicion në: <https://www.un.org/disabilities/images/A.63.175.doc>
- Raporti i raportuesit special për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara A/HRC/31/62, paragrafi 70. Në dispozicion në <https://undocs.org/en/A/HRC/31/62>
- Committee on the Rights of Persons with Disabilities (2018) Concluding observations on the initial report of the former Yugoslav Republic of Macedonia.
- Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (2020) Diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuara fizike të cilët përdorin karrocë invalidore për të hyrë në qendrat ndërkomunale për punë sociale - Testimi i situatës (në versionin e punës).
- Deklarata e përbashkët e Komitetit për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave dhe Komitetit të DPAK-së për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues dhe të Drejtat e Grave, veçanërisht grave me aftësi të kufizuara. Në dispozicion në: <https://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/CRPD/Statements/GuaranteeingSexualReproductiveHealth.DOCX>

ANEKSI 1

**PËRGJIGJET E IPQNPS-SË SE CILAT SERVISE
TË MBËSHTETJES JANË NË DISPOZICION
PËR VIKTIMAT E AFTËSISË SË KUFIZUAR,
SI DHE PËR KRYERËSIT E AFTËSISË SË
KUFIZUAR NË ASPEKTIN E PARANDALIMIT,
MBROJTJES DHE RIINTEGRIMIT**

Serviset për viktimat me aftësi të kufizuara dhe kryerësit me aftësi të kufizuara			
	Ka	Nuk ka	Kush e ofron shërbimin
IPQNPS – Berovë	Ndërhyrja psikosociale dhe puna këshillëdhënëse profesionale	Nuk ka servise për të mbështetur viktimat me aftësi të kufizuara dhe as për kryerësit me aftësi të kufizuara	Qendra për Punë Sociale
IPQNPS – Manastir	Qendra për viktimat e dhunës në familje (viktima me aftësi të kufizuara duhet të akomodohet me shoqërim), shfrytëzimi i resurseve në nivel shtetëror - akomodimi institucional dhe jashtëinstitucional, këshillimi për viktimat e dhunës në familje Me kryerësit e dhunës me aftësi të kufizuara (bashkëpunimi me institucionet mjekësore).		
IPQNPS – Veles	Në territorin e Komunës së Velesit ekziston qendër strehimore për përkujdesjen e viktimave të dhunës në familje	Nuk ka departament klasik për dhunën në familje	Në rastet e dhunës në familje punojnë kolegët punëtorët socialë, pedagogët, psikologët, juristët (si ekupe), nëse bëhet fjalë për viktima me aftësi të kufizuara mund të përfshihen edhe defektologët.
IPQNPS – Gjevgjeli		Nuk ka servise të disponueshme	
IPQNPS – Dibër		Nuk ka servise për mbështetje në nivel lokal	
IPQNPS – Kavadar		Nuk ka konkretisht për viktimat me aftësi të kufizuara	
IPQNPS – Koçani		Nuk ka	
IPQNPS – Kumanovë	Për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara, ka bashkëpunim me OJQ Inklusiva dhe Kryqi i Kuq, me të cilët punojnë në shërbimin e asistencës personale, i cili mund të sigurojë informacione për dhunën eventuale ndaj personit të caktuar me aftësi të kufizuara nëse kjo ndodh në shtëpinë e personit.		
IPQNPS – Makedonski Brod	Mbështetja psikosociale është e disponueshme për viktimat me aftësi të kufizuara dhe kryerësit e aftësisë së kufizuar në aspektin e parandalimit, mbrojtjes dhe riintegritimit.		
IPQNPS – Negotinë	Në përgjithësi, për mbështetjen e viktimave të dhunës në familje, në Kavadar ekziston Qendra Këshillimore për punë me gratë viktima të dhunës me bazë gjinore (IPQNPS - Kavadar). Me kryerësit punohet nëse duan të vijnë për trajtime këshillëdhënëse.		
IPQNPS – Radovish		Nuk ka	
IPQNPS – Shkup		Nuk ka servise të disponueshme për të mbështetur viktimat me aftësi të kufizuara dhe as për kryerësit me aftësi të kufizuara.	
IPQNPS – Tetovë		Nuk ka	

ANEKSI 2

**PËRGJIGJET LIDHUR ME DISPONUESHMËRINË
DHE PËRFSHIRJEN E PERSONAVE ME AFTËSI TË
KUFIZUARA NË INSTITUCIONET**

	A janë Qendra / institucionet të disponueshme dhe cila është shtrirja e disponueshmërisë, si në aspektin fizik, ashtu edhe në aspektin e disponueshmërisë së informacioneve, komunikimeve duke i përfshirë materialet e botuara?	A janë numrat e telefonit të paraqitjes së dhunës në formate të disponueshme?	A janë hapësirat e disponueshme për personat me gjendje të ndryshme të aftësisë së kufizuar?	Numri i të punësuarve në QPS të cilët janë persona me aftësi të kufizuara, të ndarë sipas gjendjes së aftësisë së kufizuar, gjinisë, moshës, përfaqësimit rajonal, përkatësisë etnike dhe fetare.
IPQNPS - Berovë	Hapësirat e IPQNPS Berovë ndodhen në katin e dytë, pa ashensor dhe pa mundësi shfrytëzimi të hapësirës për lëvizje me mjete ndihmëse (korridore të ngushta, dyer standarde, shkallë të pjerrëta), pa mbështetje adekuate për lëvizje në shkallë, etj.	Personat që duan të paraqesin dhunën kanë mundësinë ta bëjnë këtë në Linjën Nacionale SOS	Jo	1 femër, maqedonase, me aftësi të kufizuara fizike
IPQNPS - Manastir	Disponueshmëria fizike në katin e parë për personat me aftësi të kufizuara fizike - ku marrin shërbimin e nevojshëm. Me viktimat e dhunës në familje punon ekipi i profileve të mëposhtme: punëtori social, psikologu, pedagogu dhe juristi, marrin ndihmën e duhur psiko-sociale dhe juridike.	Viktimat e paraqesin dhunën në MPB, MPB-ja i njofton me telefon ose me shkrim ose viktimat paraqesin personalisht në QPS.	Po, disponueshmëria fizike në katin e parë për personat me aftësi të kufizuara fizike, ku e marrin shërbimin e nevojshëm.	2 persona (1 mashkull me aftësi të kufizuara fizike 50 vjeç dhe 1 mashkull me dëgjim të dëmtuar 41 vjeç)
IPQNPS - Veles	Nuk ka rampë hyrëse në objektet ku ndodhet QPS Veles dhe as teknikisht nuk është e mundur të bëhet.	Kemi telefon kujdestar që veprohet urgjentisht dhe menjëherë	Jo	Nuk ka të punësuar
IPQNPS-Gjvegjeli	Po	Po	Po	Nuk ka të punësuar
IPQNPS-Dibër	Qasje ka vetëm në katin e parë, por jo edhe në katet e tjera dhe kjo e vështirëson qasjen fizike. Informacionet janë të disponueshme përmes informimit nga plakatet, mediat, etj.	Të vetmet të disponueshme janë telefonat e institucioneve për të paraqitur si MPB-ja, QPS-ja. Linjat e tjera bien në sy përpara Qendrës dhe në vende përreth qytetit, por përdoren dobët.	Në QPS Dibër hapësirat nuk janë të disponueshme për personat me aftësi të kufizuara fizike, sepse nuk ka qasje në katin e tretë.	1 mashkull me aftësi të kufizuara fizike, 42 vjeç, shqiptar
IPQNPS - Kavadar	Qasja në triazh është e plotë, personat profesionalë zbresin nga kati sipas nevojës.	Informacionet janë plotësisht të disponueshme përmes afisheve dhe faqes së internetit.	Qasja në triazh është e plotë, personat profesionalë zbresin nga kati sipas nevojës.	1 mashkull me aftësi të kufizuara të kombinuara, maqedonas, 22 vjeç
IPQNPS-Koçani	Jo	Po	Të disponueshëm për personat me aftësi të kufizuara psikike.	Nuk ka të punësuar
IPQNPS-Kumanovë	Hapësirat në QPS Kumanovë janë pjesërisht të disponueshme për personat me kushte të ndryshme të aftësisë së kufizuar dhe nevojitet mbështetje financiare për të siguruar qasje përkatëse aty ku nuk ekziston fare ose është pjesërisht (rampë, ashensor).	Ka numër telefoni fiks të disponueshëm gjatë orarit të punës dhe telefon celular kujdestar 24 orë gjatë gjithë ditëve të javës me person profesional të disponueshëm për mbështetje.		Nuk ka të punësuar
IPQNPS - Makedonski Brod	IPQNPS Makedonski Brod është fizikisht i disponueshëm me rampë hyrëse për personat me aftësi të kufizuara.	IPQNPS Makedonski Brod ka numra telefoni për t'i paraqitur rastet e dhunës që janë në dispozicion në formatet e disponueshme.	Të gjitha hapësirat në IPQNPS Makedonski Brod janë të disponueshme për personat me gjendje të ndryshme të aftësisë së kufizuar.	Nuk ka të punësuar

IPQNPS-Negotinë	IPQNPS Negotinë nuk ka rampë për hyrje për personat në hyrjen kryesore, por ka hyrje të pasme (në oborr) e cila është në nivelin e rrugës, e cila ofron qasje për personat që nuk mund të hyjnë në hyrjen kryesore.	Numrat e telefonit shfaqen në derën e hyrjes në qendër dhe adresën zyrtare të postës elektronike.	Hyrja në hapësirat e Qendrës për Personat me Aftësi të Kufizuara (fizike) bëhet nga hyrja e pasme. Përsa u përket qasjeve të tjera (për personat e verbër) ose llojit tjetër të aftësisë së kufizuar, nuk ka shenja.	Nuk ka të punësuar
IPQNPS - Prilep	Qasja e personave me aftësi të kufizuara është në sportelin e IP-QNPS Prilep ku i marrin të gjitha informacionet, dhe nëse ka nevojë, personat profesionalë zhvillojnë bisedë.	Po, numrat e telefonit janë të disponueshëm.	Hapësirat nuk janë të disponueshme për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.	Në Qendrën Ditore për Personat me Paralizë Cerebrale janë të punësuar dy persona, nga të cilët 1 mashkull që punon 3 vite dhe merr të ardhura personale nga UNDP-ja dhe 1 femër me kontratë pune njëjtë 3 vite, të dy personat janë me paralizë cerebrale.
IPQNPS - Radovish	QPS Radovish gjendet në lokacionin që nuk është i disponueshëm për personat me aftësi të kufizuara.	Ka numra të disponueshëm të telefonit që mund të kontaktohen.		Nuk ka të punësuar
IPQNPS - Shkup	Nuk ka përgjigje	Nuk ka përgjigje	Nuk ka përgjigje	Nuk ka përgjigje

Drejtuar:

Lënda: **Kërkesë për QASJE TE INFORMATAT ME KARAKTER PUBLIK**

Të nderuar,

Në bazë të nenit 4 dhe nenit 12 të Ligjit për qasje të lirë te informatat me karakter publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 101/2019), por edhe obligimeve që shteti i ka në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, nga Pronari e kërkoj informacionin e mëposhtëm me karakter publik:

1. Numri i rasteve të dhunës ndaj grave dhe vajzave në 3 vitet e fundit (të ndarë sipas viteve).
2. Numri i rasteve të dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara nga numri i përgjithshëm i rasteve të paraqitura të dhunës në 3 vitet e fundit (të ndarë sipas viteve).
3. Të na dorëzoni evidencë për rastet e paraqitura të dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuara, të ndarë sipas gjendjes së aftësisë së kufizuar, gjinisë, moshës, përfaqësimit rajonal, përkatësisë etnike dhe fetare, si dhe orientimit seksual (nëse keni evidencë të tillë).
4. Të na dorëzoni evidencë të formave të evidentuara të dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në 3 vitet e fundit.
5. Numri i kryerësve të dhunës që janë persona me aftësi të kufizuara, të ndarë sipas gjendjes së aftësisë së kufizuar, gjinisë, moshës, përfaqësimit rajonal, përkatësisë etnike dhe fetare.
6. A keni evidentuar raste të dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuara të akomoduar në institucionet, shtëpitë grupore dhe format e tjera të jetesës së organizuar në 3 vitet e fundit?
7. Evidenca e rasteve të dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuara, të akomoduar në institucionet, shtëpitë grupore dhe format e tjera të jetesës së organizuar, të ndarë sipas gjendjes së aftësisë së kufizuar, gjinisë, përfaqësimit rajonal dhe përkatësisë etnike, si dhe format e dhunës.
8. Cilat servise janë në dispozicion për të mbështetur viktimat me aftësi të kufizuara, si dhe kryerësit e aftësisë së kufizuar në aspektin e parandalimit, mbrojtjes, riintegritimit dhe rehabilitimit?
9. A keni evidentuar raste të dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara nga prindërit / kujdestarët e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara? Evidenca e rasteve të dhunës nga prindërit / kujdestarët në 3 vitet e fundit, të ndarë sipas formës së dhunës, gjendjes së aftësisë së kufizuar, gjinisë, përfaqësimit rajonal dhe përkatësisë etnike.
10. Numri i personave me aftësi të kufizuara të punësuar në MPPS, i ndarë sipas gjendjes së aftësisë së kufizuar, gjinisë, moshës, përfaqësimit rajonal, përkatësisë etnike dhe fetare.

ANEKSI 3

KËRKESË PËR QASJE TE INFORMATAT ME KARAKTER PUBLIK

11. A keni protokolle për informimin për dhunën nga personat me aftësi të kufizuara të akomoduar në entet speciale, shtëpitë grupore, format e jetesës së organizuar, si dhe për fëmijët dhe të rriturit e akomoduar në familjet kujdestare?
12. A kanë ndjekur shërbimet e MPPS-së trajnim për dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje ndaj personave me aftësi të kufizuara?
13. A kanë ndjekur shërbimet e MPPS-së trajnimin për Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara?
14. A keni protokolle për informimin dhe referimin e viktimave me aftësi të kufizuara?
15. A keni udhëzues për zbatimin e aftësimin përkatës për viktimat me aftësi të kufizuara, si dhe për kryerësit e aftësisë së kufizuar?
16. A janë numrat e telefonit për t'i paraqitur rastet e dhunës në formate të disponueshme për personat me aftësi të kufizuara?
17. A janë hapësirat e MPPS-së të disponueshme për personat me situatë të ndryshme të aftësisë së kufizuar?

Informacionet kërkohen në kuadër të hulumtimit mbi parandalimin e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, të mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Shkup.

Ju lutemi na dërgoni përmbajtjen e informacioneve të kërkuara në formën e: **shkresës elektronike në...**

Shkup, 05/07/2021
Numri arkivor...

ANEKSI 4

PYETËSORI ONLINE PËR INSTITUCIONET
(NË SURVEYMONKEY/GOOGLEFORMS OSE NGJASHËM)

Të nderuar,

Misioni i OSBE-së në Shkup, në bashkëpunim me organizatat që punojnë në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, në kuadër të përpjekjeve të tij për luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe zbatimin e Planit Nacional të Veprimit për Zbatimin e Konventës së Stambollit 2018 -2023, kryen kërkime për parandalimin e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara. Hulumtimi përbëhet nga disa metoda kërkimore me të cilat qëllimi është të fitohet pasqyrë e plotë e situatës me dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, si dhe të përcaktojnë rekomandime konkrete për mbrojtjen dhe avancimin efikas të pozitës së grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara.

Qëllimi i këtij pyetësi është të tregojë situatën me shërbimet dhe serviset e disponueshme për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara të cilat janë viktime të dhunës, si dhe përfshirjen e çështjes së mbrojtjes dhe mbështetjes së grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në legjislacion, politikë dhe praktikë. Ju përfshijmë në hulumtim si organizatë që punon për të parandaluar dhunën ndaj grave dhe dhunën me bazë gjinore dhe do të jetë shumë me rëndësi për ne nëse ju e plotësoni këtë pyetësor. Pyetësi përbëhet nga 20 pyetje dhe do t'ju marrë rreth 15 minuta për t'u përgjigjur. Nëse keni pyetje ose sugjerime shtesë, ose nëse dëshironi të përfshiheni më tej në hulumtim, na shkruani informacionet tuaja të kontaktit në fund të pyetësorit dhe ne do t'ju kontaktojmë.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

PYETJE RRETH TË ANKETUARIT / ANKETUARËS

1. Emri dhe mbiemri: _____
2. Qyteti: _____
3. Institucioni / trupi / shërbimi: _____
Sektori (nëse është i pranueshëm) _____
4. Vendi juaj i punës: _____
5. Sa kohë punoni në institucion?
 Më pak se 1 vjet 1-3 vjet Më tepër se 3 vjet

PYETJE RRETH INSTITUCIONIT / SHËRBIMIT

6. A është institucioni në të cilin punoni i disponueshëm për personat me aftësi të kufizuara?
 Po Jo Nuk e di
7. A ka të punësuar me aftësi të kufizuara në institucionin ku punoni?
 Po Jo Nuk e di
8. A ka institucioni në të cilin punoni programe / shërbime / servise të dedikuara posaçërisht për personat me aftësi të kufizuara?
 Po Jo Nuk e di

9. A ka institucioni në të cilin punoni programe / shërbime / servise të dedikuara posaçërisht për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara?

Po Jo Nuk e di

PYETJE RRETH PËRGATITJES PROFESIONALE TË TË ANKETUARIT / ANKETUARËS

10. A jeni të njohur me nocionin dhunë me bazë gjinore dhe çfarë përfshin?
 Po Pjesërisht Jo
11. A jeni të njohur me Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)?
 Po Pjesërisht Jo
12. A jeni të njohur me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara?
 Po Pjesërisht Jo
13. A keni ndjekur trajnim për dhunën me bazë gjinore?
 Po, një ose dy Po, më shumë trajnime Jo
14. A keni ndjekur trajnim për dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara?
 Po, një ose dy Po, më shumë trajnime Jo
15. A konsideroni se trajnimet janë të dobishme për punën tuaj?
 Po Varet nga organizatorët / ligjëruesit Jo

PYETJE RRETH PERCEPTIMIT PERSONAL TË TË ANKETUARIT / ANKETUARËS

16. Ju lutemi, zgjidhni opsionin "Saktë" ose "Pasaktë" për pohimet e mëposhtme:

1) Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë të diskriminuara në vendin tonë.

SAKTË PASAKTË

2) Në vendin tonë ka mjaft servise të disponueshme për gratë dhe vajzat të cilat janë viktime të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

SAKTË PASAKTË

3) Të drejtat dhe mirëqenia e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara mbulohen mjaftueshëm në ligjet dhe politikat tona.

SAKTË PASAKTË

4) Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara kanë mundësinë të përfshihen në jetën publike në komunitetin e tyre.

SAKTË PASAKTË

5) Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara intelektuale pranohen në mjedisin ku jetojnë.

SAKTË PASAKTË

6) Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara mund të vendosin në mënyrë të pavarur për jetën e tyre.

SAKTË PASAKTË

17. Cilat konsideroni se janë sfidat kryesore me të cilat përballen vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara në lidhje me dhunën me bazë gjinore? (Mund të rrethoni më shumë përgjigje)

- Mosnjohja e çështjes në kornizën ligjore
- Padisponueshmëria e serviseve
- Mosbesimi tek institucionet
- Mosnjohja me konceptin e DHBGJ-së
- Pranimi i dhunës
- Mungesa e vetëbesimit
- Frika
- Mosnjohja me mundësitë për ndihmë / servise të disponueshme
- Tjetër: _____
- Nuk e di

18. A mendoni se situata e dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara u përkeqësua gjatë pandemisë KOVID-19?

Po, dukshëm Po Jo I don't know

19. Çfarë konsideroni se është më e rëndësishme për t'u mundësuar grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara të cilat janë viktime ose viktime të mundshme të dhunës për mbrojtje dhe parandalim efikas të dhunës? (Mund të rrethoni më shumë përgjigje)

- Qasja dhe disponueshmëria në servise
- Ndërgjegjësimi i të punësuarve në institucionet për njohjen e dhunës / dhunës së mundshme
- Edukimi dhe ndërgjegjësimi i grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara për konceptin e dhunës me bazë gjinore
- Forcimi i vetëbesimit të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara
- Avancimi i mundësive për fuqizimin ekonomik të vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara
- Fushata për t'u njohur me serviset e disponueshme
- Ndërgjegjësimi dhe edukimi i prindërve / partnerëve / të afërmeve të vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara për DHBGJ-në
- Të gjitha të mësipërmet
- Tjetër: _____

20. Nëse ka diçka që nuk ju pyetëm për të cilën dëshironi të vini në dukje në lidhje me dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, mund ta bëni këtë në vazhdim. Gjithashtu, nëse dëshironi që t'ju kontaktojmë, mund t'i lini informacionet Tuaja të kontaktit këtu:

Të nderuar,

Misioni i OSBE-së në Shkup, në bashkëpunim me organizatat që punojnë në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, në kuadër të përpjekjeve të tij për luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe zbatimin e Planit Nacional të Veprimit për Zbatimin e Konventës së Stambollit 2018 -2023, kryen kërkime për parandalimin e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara. Hulumtimi përbëhet nga disa metoda kërkimore me të cilat qëllimi është të fitohet pasqyrë e plotë e situatës me dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, si dhe të përcaktojnë rekomandime konkrete për mbrojtjen dhe avancimin efikas të pozitës së grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara.

Qëllimi i këtij pyetësi është të na tregojë situatën me shërbimet dhe serviset e disponueshme për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara të cilat janë viktima të dhunës, si dhe të na japë pasqyrë të përgjithshme të situatës me dhunën ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara. Ju përfshijmë në hulumtim si organizatë që punon për të parandaluar dhunën ndaj grave dhe dhunën me bazë gjinore dhe do të jetë shumë me rëndësi për ne nëse ju e plotësoni këtë pyetësor. Pyetësi përbëhet nga 28 pyetje dhe do t'ju marrë rreth 15 minuta për t'u përgjigjur. Nëse keni pyetje ose sugjerime shtesë, ose nëse dëshironi të përfshiheni më tej në hulumtim, na shkruani informacionet tuaja të kontaktit në fund të pyetësit dhe ne do t'ju kontaktojmë.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

PYETJET E PËRGJITHSHME RRETH ORGANIZATËS

1. Emri i organizatës: _____
2. Qyteti: _____
3. Fushëveprimi i organizatës:
 National Lokal Rajonal Rrjeti nacional
4. Sa kohë është aktive organizata?
 Më pak se 5 vjet 5-10 vjet Më shumë se 10 vjet Më shumë se 20 vjet
5. Sa persona punojnë në organizatë (me çfarëdo kontrate)?
 1-5 5-10 Më shumë se 10
6. A punojnë personat me aftësi të kufizuara në organizatën tuaj?
 Po, 1 person Po, më shumë se 1 person Jo
7. A janë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara target grup i drejtpërdrejtë i punës së organizatës?
 PO JO

ANEKSI 5

PYETËSORI ONLINE PËR OJQ-NË

(NË SURVEYMONKEY/GOOGLEFORMS OSE NGJASHËM)

PYETJE PËR TË ANKETUARIN / ANKETUARËN

8. Pozicioni juaj (personi që plotëson pyetësonin) në organizatë:

9. Sa kohë keni që punoni në organizatë?

- Më pak se 1 vjet 1-3 vjet Më shumë se 3 vjet

10. A jeni të trajnuar për të punuar në servis për viktimat e dhunës me bazë gjinore?

- Po Jo

11. A keni ndjekur ju ose ndonjë nga kolegët tuaj trajnim për dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara?

- Po, një ose dy Po, më shumë Jo

12. A jeni të njohur me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara?

- Kam dëgjuar, por detajet nuk i di
 Po, jam i / e njohur mirë
 Jo

PYETJE RRETH PUNËS SË ORGANIZATËS

13. Sa kohë organizata punon në fushën e dhunës dhe / ose diskriminimit me bazë gjinore?

- 1-5 vjet 5-10 vjet më shumë se 10 vjet

14. A ka organizata juaj servis për viktimat e dhunës?

- PO JO

15. Nëse pyetjes paraprake i jeni përgjigjur pozitivisht, cilin servis e ofron organizata juaj? (Mund të rrethoni më shumë përgjigje)

- Numri SOS për ndihmë viktimave të dhunës në familje
 Ndihma psiko-sociale
 Akomodimi për viktimat e dhunës
 Ndihma juridike për viktimat e dhunës
 Tjetër: _____

16. Nëse organizata juaj ofron servis për viktimat e dhunës, a është servisi i disponueshëm për vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara?

- PO JO

17. Nëse punoni si servis për viktimat e dhunës, sa raste të dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara keni paraqitur në vit, në 3 vitet e fundit?

18. A është puna e organizatës suaj gjithëpërfshirëse për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara?

- PO JO

19. Nëse pyetjes paraprake i jeni përgjigjur pozitivisht, ju lutemi theksoni në çfarë mënyre e realizoni gjithëpërfshirjen:

- Përgatitja e rregullt e materialeve në formate të disponueshme për personat me aftësi të kufizuara (gjuha e shenjave, titrat e videove, gjuha e thjeshtuar, Letra e Brait, materialet në formatet audio, etj.)
 Hapësirat e organizatës janë të disponueshme për personat me aftësi të kufizuara
 Në çdo eveniment që e organizojmë përpiqemi dhe shohim të ketë qasje për personat me aftësi të kufizuara
 Në organizatën punon / punojnë personi / personat me aftësi të kufizuara
 Ofrojmë mbështetje të drejtpërdrejtë për vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara
 Tjetër: _____

20. Nëse në buxhetet e organizatës parashikohen mjete për ofrimin e qasjes për të punësuarit tuaj me aftësi të kufizuara, pjesëmarrësit në eventet dhe përdoruesit e shërbimeve me aftësi të kufizuara?

- PO JO Nuk e di Tjetër: _____

21. Do you have a guide on the application of reasonable accommodations of the services provided by your organization?

- PO JO Nuk e di

22. Have you ever produced informative/educational materials for persons with impaired sight?

- PO JO Nuk e di

23. Have you ever produced informative/educational materials for persons with intellectual disabilities?

- PO JO Nuk e di

24. A angazhoni interpretues të gjuhës së shenjave për evenimentet e organizuara nga organizata juaj?

- Vetëm nëse evenimenti është i dedikuar për personat me dëgjim të dëmtuar
- Jo, zakonisht nuk kemi buxhet për këtë
- Jo, nuk ka pasur nevojë deri më tani
- Po, gjithmonë ose pothuajse gjithmonë
- Ndonjëherë, kur kemi mjete
- Nuk organizojmë evenimente

25. Sipas punës së organizatës Suaj, a është përkeqësuar situata e dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara gjatë pandemisë KOVID-19?

- PO
- JO
- Nuk e di

Nëse jeni përgjigjur "Po", ju lutemi shpjegoni se si është përkeqësuar situata sipas punës së organizatës Suaj:

PYETJE RRETH PERCEPTIMIT TË TË ANKETUARIT / ANKETUARËS

26. Cilat konsideroni se janë sfidat kryesore me të cilat përballen vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara në lidhje me dhunën me bazë gjinore? (Mund të rrethoni më shumë përgjigje)

- Mosnjohja e çështjes në kornizën ligjore
- Padisponueshmëria e serviseve
- Mosbesimi tek institucionet
- Mosnjohja me konceptin e DHBGJ-së
- Pranimi i dhunës
- Mungesa e vetëbesimit
- Frika
- Mosnjohja me mundësitë për ndihmë / servise të disponueshme
- Tjetër: _____
- Nuk e di

27. Çfarë konsideroni se është më e rëndësishme për t'u mundësuar grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara të cilat janë viktimat ose viktimat të mundshme të dhunës për mbrojtje dhe parandalim efikas të dhunës? (Mund të rrethoni më shumë përgjigje)

- Qasja dhe disponueshmëria në servise
- Ndërgjegjësimi i të punësuarve në institucionet për njohjen e dhunës / dhunës së mundshme
- Edukimi dhe ndërgjegjësimi i grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara për konceptin e DHBGJ-së

- Forcimi i vetëbesimit të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara
- Avancimi i mundësive për fuqizimin ekonomik të vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara
- Fushata për t'u njohur me serviset e disponueshme
- Ndërgjegjësimi dhe edukimi i prindërve / partnerëve / të afërmeve të vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara për DHBGJ-në
- Të gjitha të mësipërmet
- Tjetër: _____

28. Nëse ka diçka që nuk ju pyetëm dhe për të cilën dëshironi të theksoni në lidhje me dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, mund ta bëni këtë në vazhdim. Gjithashtu, nëse dëshironi që t'ju kontaktojmë, mund t'i lini informacionet Tuaja të kontaktit këtu:

ANEKSI 6

PYETËSOR PËR INTERVISTA INDIVIDUALE

Kjo intervistë zbatohet në kuadër të hulumtimit të kryer nga Misioni i OSBE-së në Shkup, në bashkëpunim me organizatat që punojnë në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Aktiviteti është pjesë e përpjekjeve për luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe zbatimin e Planit Nacional të Veprimit për zbatimin e Konventës së Stambollit 2018-2023.

Hulumtimi përbëhet nga disa metoda kërkimore me të cilat qëllimi është të fitohet pasqyra e plotë e situatës me dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, si dhe të përcaktojnë rekomandime konkrete për mbrojtjen dhe avancimin efikas të pozitës së grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara.

Me këto intervista, qëllimi ynë është të marrim pasqyrën e plotë të situatës së dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, si dhe të shërbimeve dhe serviseve në dispozicion.

Përgjigjet tuaja do të trajtohen me kujdesin dhe konfidencialitetin më të madh. Të dhënat personale dhe të ndjeshme do të jenë të disponueshme vetëm për ekipin hulumtues, ndërsa në konstatimet do të përfshihen vetëm informacionet për të cilat do të ketë miratimin tuaj.

Shënime për personin që e mban intervistën:

- *Pyetjet mund të thellohen me bashkëbiseduesen, nëse ka nevojë.*
- *Pyetjet mund të parafrazohen nëse është e nevojshme.*
- *Pyetje të caktuara mund të anashkalohen, në varësi të përgjigjeve.*

1. Emri dhe mbiemri
2. Moshë
3. Vendbanimi
4. Përkatësia etnike
5. Gjendja e aftësisë së kufizuar
6. Arsimi
7. Statusi i punës
8. Gjendja familjare
9. Me kë jetoni?
10. A keni fëmijë? Nëse po, sa dhe në çfarë moshe?
11. A ka ndonjë nga fëmijët tuaj aftësi të kufizuara?
12. (Nëse jeton me partner) A është partneri Juaj i punësuar? Çka punon?
13. A keni vështirësi në jetën e përditshme / a ndiheni të diskriminuar për shkak të aftësisë suaj të kufizuar?

14. Nëse ndonjëherë dikush...

	PO	JO
...ju ka thënë diçka të pahijshme / ofenduese?		
...ju ka kërcënuar me dhunë?		
...ju ka kërcënuar me fëmijët tuaj?		
...ju ka poshtëruar, ju ka qeshur ose ju ka kritikuar?		
...ju ka penguar të keni qasje te paratë tuaja?		
...ju ka nënvlerësuar?		
...ju ka treguar fotografi / video eksplicite?		
...ju ka dërguar porosi eksplicite seksuale?		
...ju ka ndjekur ose me këmbëngulje ju ka dërguar porosi?		
...ju ka shtyrë, ju ka tërhequr për flokë ose ju ka tundur?		
...ju ka goditur në trup?		
...ju ka goditur në kokë?		
...ju ka shkelmuar?		
...ju ka hedhur me send të fortë?		
...ka tentuar t'ju puthë pa lejen tuaj?		
...ju ka prekur në mënyrë të pahijshme?		
...ka bërë të ndiheni të pasigurt?		
...ka bërë të ndiheni të frikësuar?		
...në mënyrë të pahijshme është zhveshur para jush?		
...ka tentuar t'ju detyrojë në aktin seksual?		
...ju ka detyruar në aktin seksual?		
...ju ka imponuar vendim për kontracëpcion?		
...ju ka detyruar të abortoni?		

Nëse përgjigjet Po, ku? _____
Dhe kush? Partneri aktual Ish-partneri Tjetër _____

15. A ka ndodhur ndonjë nga këto evenimente në fëmijëri? Nëse po, si ndikoi kjo në jetën tuaj të mëvonshme?

16. Nëse në vitin e fundit dikush...

	PO	JO
...ju ka thënë diçka të pahijshme / ofenduese?		
...ju ka kërcënuar me dhunë?		
...ju ka kërcënuar me fëmijët tuaj?		
...ju ka poshtëruar, ju ka qeshur ose ju ka kritikuar?		
...ju ka penguar të keni qasje te paratë tuaja?		
...ju ka nënvlerësuar?		

	PO	JO
...ju ka treguar fotografi / video eksplicite?		
...ju ka dërguar porosi eksplicite seksuale?		
...ju ka ndjekur ose me këmbëngulje ju ka dërguar porosi?		
...ju ka shtyrë, ju ka tërhequr për flokë ose ju ka tundur?		
...ju ka goditur në trup?		
...ju ka goditur në kokë?		
...ju ka shkelmuar?		
...ju ka hedhur me send të fortë?		
...ka tentuar t'ju puthë pa lejen tuaj?		
...ju ka prekur në mënyrë të pahijshme?		
...ka bërë të ndiheni të pasigurt?		
...ka bërë të ndiheni të frikësuar?		
...në mënyrë të pahijshme është zhveshur para jush?		
...ka tentuar t'ju detyrojë në aktin seksual?		
...ju ka detyruar në aktin seksual?		
...ju ka imponuar vendim për kontracëpcion?		
...ju ka detyruar të abortoni?		

Nëse përgjigjet Po, ku? _____
Dhe kush? Partneri aktual Ish-partneri Tjetër _____

17. A keni qenë ndonjëherë dëshmitar në ndonjë nga sjelljet e mësipërme që i kanë ndodhur dikujt tjetër? Nëse po, kujt dhe ku? Si reaguat?
18. A jeni ndjerë i pasigurt / i frikësuar për shkak se dikush ju ka ndjekur / ju ka dërguar porosi? Nëse po, ku dhe kush? Na tregoni se çfarë ndodhi.
19. Nëse dëshironi / mundeni, na tregoni për incidentin më të rëndë të dhunës që keni përjetuar? Ku ndodhi? Kush mori pjesë?
20. Cilat ishin pasojat e dhunës që keni përjetuar?
 - Pasojat emotive (poshtërimi, nënvlerësimi, ndjenja e vetmisë, ngurrimi...)
 - Pasojat fizike (mavijosje, gërvishtje, lëndime të rënda...)
 - Pasojat psikologjike (ndjenja e pasigurisë, frika për të shkuar diku vetëm, tërheqja, depresioni...)
 - Tjetër:
21. A janë pasojat afatgjata?
22. A i treguat ndokujt kur e përjetuat këtë? / A do t'i tregonit dikujt nëse përjetoni ndonjë nga gjërat e theksuara më sipër? Kujt? Nëse jo, pse?
23. A e dini se ku mund të drejtoheni për ndihmë nëse përjetoni ndonjë nga gjërat e theksuara më sipër?
24. A keni marrë ndonjë material për ndihmën dhe mbështetjen për dhunën në format të disponueshëm? A konsideroni se materiale të tilla ka mjaftueshëm / janë mjaftueshëm të disponueshme për personat me aftësi të kufizuara?
25. A keni paraqitur ndonjëherë dhunë? Ku? Si e keni ditur se ku të paraqitni?

26. A kishte ndonjë rezultat nga paraqitja?
27. Cila ishte përvoja Juaj me institucionin / organizatën në të cilën keni paraqitur dhunë?
28. A konsideroni se gruaja me aftësi të kufizuara që paraqet dhunë merr mbështetje dhe mbrojtje nga institucionet dhe organizatat?
29. Nëse nuk keni paraqitur kur keni përjetuar dhunë, pse nuk e keni bërë atë?
30. A jeni dakord me pohimet e mëposhtme:

	Dakord	Nuk jam dakord
Burri është ai që duhet të jetë kryefamiljari kur merren vendimet.		
Shpesh vetë gruaja e provokon burrin për të ushtruar dhunë. / Gratë janë fajtoresh për dhunën.		
Dhuna në familje është çështje private dhe duhet të zgjidhet në familje.		
Nuk është e frikshme nëse burri godet gruan në afekt / nervozë.		
Gruaja duhet të kënaqet burrin edhe kur ajo nuk ka dëshirë për intimitet.		
Gruaja me aftësi të kufizuara ka shumë më tepër gjasa të qëndrojë me partner të dhunshëm sesa gratë e tjera.		
Gruaja duhet të durojë për hir të fëmijëve.		
Gruaja e mirë i bindet burrit të saj edhe kur ka mendim ndryshe prej tij.		
Gratë që thonë se janë dhunuar shpesh trillojnë ose ekzagjerojnë në pohimet për abuzim ose përdhunim.		

31. Sa shpesh mendoni se gratë me aftësi të kufizuara në Maqedoninë e Veriut dhunohen nga partnerët / të afërmit / të njohurit apo personat e panjohur?
- Shumë shpesh Shpesh Jo shumë shpesh Rrallë Nuk e di
32. Sa shpesh mendoni se gratë me aftësi të kufizuara në Maqedoninë e Veriut dhunohen nga persona të panjohur?
- Shumë shpesh Shpesh Jo shumë shpesh Rrallë Nuk e di
33. Cilat konsideroni se janë vështirësitë / pengesat më të mëdha për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara të cilat janë viktimat e dhunës?
34. A kishte ndikim kriza e KOVID-19 në jetën Tuaj / sigurinë Tuaj / ndjenjën Tuaj të sigurisë?
35. A konsideroni se gratë me aftësi të kufizuara ishin mjaft të përfshira në masat e miratuara nga Qeveria gjatë krizës së KOVID-19? Nëse jo, pse / çfarë mendoni se mungoi?
36. Çfarë konsideroni se nevojitet më urgjentisht për të mbështetur dhe mbrojtur gratë me aftësi të kufizuara që janë viktimat e dhunës?
37. Si mund të fuqizohen gratë me aftësi të kufizuara që mos të dhunohen / t'i përgjigjen dhunës?

ANEKSI 7

UDHËZUESI I DISKUTIMIT PËR GRUPET E FOKUSIT

Ky grup i fokusit realizohet në kuadër të hulumtimit të kryer nga Misioni i OSBE-së në Shkup, në bashkëpunim me organizatat që punojnë në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Aktiviteti është pjesë e përpjekjeve për luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe zbatimin e Planit Nacional të Veprimit për zbatimin e Konventës së Stambollit 2018-2023.

Hulumtimi përbëhet nga disa metoda kërkimore me të cilat qëllimi është të fitohet pasqyra e plotë e situatës me dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, si dhe të përcaktojnë rekomandime konkrete për mbrojtjen dhe avancimin efikas të pozitës së grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara.

Me këto grupe të fokusit, qëllimi ynë është të marrim pasqyrën e plotë të situatës së dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, si dhe të shërbimeve dhe serviseve në dispozicion.

Përgjigjet tuaja do të trajtohen me kujdesin dhe konfidencialitetin më të madh. Të dhënat personale dhe të ndjeshme do të jenë të disponueshme vetëm për ekipin hulumtues, ndërsa në konstatimet do të përfshihen vetëm informacionet për të cilat do të ketë miratimin tuaj.

Shënime për personat që i mbajnë grupet e fokusit:

- *Pyetjet mund të thellohen / plotësohen, në varësi të diskutimit.*
- *Pyetjet mund të parafrazohen / thjeshtohen, nëse është e nevojshme.*

1. Prezantimi

- **mosha**
- **gjendja e aftësisë së kufizuar**
- **vendbanimi**
- **përkatësia etnike**
- **arsimi**
- **statusi i punësimit**
- **gjendja familjare**

2. A keni vështirësi në jetën e përditshme? A jeni penguar ndonjëherë të merrni pjesë në diçka / të merrni ndonjë shërbim për shkak të paaftësisë suaj?
3. A ndiheni të lirë të thoni atë që mendoni dhe dëshironi në shtëpi? A ju kanë ndaluar ndonjëherë / nuk ju kanë lejuar të thoni diçka?
4. A ndiheni të lirë të bëni atë që mendoni dhe dëshironi në shtëpi? A ju kanë ndaluar ndonjëherë / nuk ju kanë lejuar të bëni diçka?
5. A jeni të njohur me nocionin dhunë? A e dini se çfarë është dhuna?
6. A keni pasur ndonjëherë frikë nga ndonjë i afërm? A jeni ndjerë ndonjëherë i frikësuar për shkak të sjelljes së ndonjë të afërmi?
7. A jeni ndjerë ndonjëherë i frikësuar për shkak të sjelljes së dikujt që nuk e njihni?
8. A ju ka kërcënuar ndonjëherë dikush me dhunë / ju ka kërcënuar se do t'ju bëjë diçka juve ose fëmijëve tuaj (nëse ka)? Kush? Ku?
9. A ju ka thënë ndonjëherë dikush diçka të turpshme apo ofenduese? Kush? Ku?

10. A është përpjekur dikush ndonjëherë t'ju prekë apo ju ka prekur duke mos dashur / lejuar? Kush? Ku?
11. A ka provuar dikush ndonjëherë t'ju puthë duke mos dashur?
12. A ju ka goditur dikush ndonjëherë? Ku? Kush? Si?
13. A ju ka komentuar / ekspozuar ndonjëherë dikush në mënyrë të pahijshme në vend publik? Ku? Kush? Si?
14. A ju ka ndjekur ndonjëherë dikush dhe ju ka bërë të ndiheni të pasigurt / të frikësuar? Ku? Kush? Si?
15. A ju ka dërguar ndonjëherë dikush porosi të turpshme në rrjetet sociale / SMS porosi? A ishte e shpeshtë / çdo ditë? Kush?
16. A jua ka marrë dikush ndonjëherë paratë tuaja dhe nuk ju ka dhënë t'i mbani dhe shpenzoni vetë? Kush? Si?
17. A ju ka hedhur dikush ndonjëherë ndonjë send / ka dashur t'ju godasë me ndonjë send? Kush? Si?
18. A ju ka detyruar dikush ndonjëherë në intimitet (duke mos dashur)? Kush?
19. Nëse keni përjetuar ndonjë nga gjërat e përmendura më sipër, si u ndjetë për të? A keni pasur ndonjë pasojë (fizike, psikike, emotive...)? Sa zgjatën / zgjasin ato pasoja?
20. Nëse keni përjetuar ndonjë nga gjërat e përmendura më sipër, a i keni treguar dikujt? Kujt? Si?
21. A do t'i tregonit dikujt nëse dikush sillet në mënyrë të pahijshme ndaj jush / ju prek / ju komenton, etj.? Kujt do t'i tregonit?
22. A do t'i tregonit dikujt nëse dikush ju prek / ju godet / ju zhvishet...? Kujt?
23. A do t'i tregonit dikujt nëse dikush do t'ju detyronte në intimitet? Kujt?
24. A e dini se ku të drejtoheni nëse dikush ju godet / ju prek në mënyrë të pahijshme / zhvishet në mënyrë të pahijshme / ju ndjek / ju bën të ndiheni të frikësuar...?
25. A jeni drejtuar ndonjëherë ndonjë institucioni apo organizate për ndihmë? Çfarë ndodhi?
26. Nëse keni përjetuar ndonjë lloj dhune dhe nuk e keni paraqitur, pse nuk e keni bërë atë?
27. A jeni dakord me pohimet e mëposhtme:
 - **Burri është ai që duhet të jetë kryefamiljari kur merren vendime.**
 - **Vetë gruaja shpeshherë e provokon mashkullin për të ushtruar dhunë. / Gratë janë fajtoare për dhunën.**
 - **Mosmarrëveshjet janë çështje private dhe duhet të zgjidhen në familje.**
 - **Nuk është e frikshme nëse ndonjë burrë godet gruan në afekt / nervozë.**
 - **Gruaja duhet të kënaqë burrin edhe kur ajo nuk ka dëshirë për intimitet.**
 - **Gruaja duhet të durojë për hir të fëmijëve.**
 - **Gratë shpesh shpikin për vëmendje.**
 - **Gruaja e mirë e dëgjon burrin e saj dhe nuk e kundërshton atë.**

28. Cilat mendoni se janë vështirësitë më të mëdha që hasin gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara në lidhje me dhunën dhe diskriminimin?
29. A ndiheni të mbrojtur gjatë koronës / a keni mundësi për mbrojtje dhe mbështetje nëse dikush sillet me dhunë ndaj jush?
30. A keni përjetuar ndonjë incident gjatë krizës së koronës, gjatë karantinës?
31. Çfarë do të bënit të ndiheni të sigurt? / Çfarë ju duhet për t'u ndjerë të sigurt në çdo kohë?
32. Çfarë mendoni se nevojitet më urgjentisht për të forcuar mbështetjen për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara në lidhje me dhunën dhe diskriminimin?

Publikim:

“Parandalimi i dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara - Raporti i hulumtimit” përkthyer nga “Превенција на родово базирано насилство врз жени и девојки со попреченост – истражувачки извештај”

Redaktore:

Zhaneta Poposka, OSBE Misioni në Shkup

Autor:

Natasha Dimitrovska, Elena Koçoska

Disenji:

Polyesterday

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

364.63-055.2-056.26/.36(497.7)(047.31)
316.647.82-055.2-056.26/.36(497.7)(047.31)

DIMITROVSKA, Natasha

Parandalimi i dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara [Електронски извор] : raporti i hulumtimit / Natasha Dimitrovska, Elena Koçoska. - Skopje : OSCE, 2022

Достапно и на: <https://www.osce.org/sq/mission-toskopje/513256>. - Превод на делото: Превенција на родово базирано насилство врз жени и девојки со попреченост : истражувачки извештај. - Текст во ПДФ формат, содржи 110 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 02.03.2022. - Библиографија: 77-78. - Содржи и: Anexi

ISBN 978-608-4788-76-8

1. Koçoska, Elena [автор]

а) Насилство -- Жени со попреченост -- Македонија -- Истражувања б)
Дискриминација -- Жени со попреченост -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 56548357



Misioni i OSBE-së në Shkup
Bulevardi 8 shtatori Nr. 16, 1000 Shkup

e-mail: info-MK@osce.org
website: <http://www.osce.org/mission-to-skopje>